

PËR MËSIMDHEËNËSIN/EN

duk^agjini
shtëpia botuese publishing house

Arbenita Gagica, Pajtesa Doli

**EDUKATË
QYTETARE**

Për klasën e shtatë të arsimit të mesëm të ulët

7

PËRMBAJTJA

Udhërrëfyes.....	5
Hyrje.....	7
Planifikimi vjetor.....	16
Plani dymujor: shtator—tetor.....	17
Plani dymujor: nëntor—dhjetor.....	20
Plani tremujor: janar—shkurt—mars.....	22
Plani tremujor: prill—maj—qershor.....	25
Mësimi 1: Ndërveprimet në jetën e përditshme.....	28
Mësimi 2: Sjelljet dhe shprehjet njerëzore.....	30
Mësimi 3: Kompetencat e institucioneve dhe roli i organizatave joqeveritare (OJQ).....	32
Mësimi 4: Përgjegjësitë e pushtetit lokal dhe të atij qendror.....	34
Mësimi 5: Roli shoqëror i personaliteteve të rëndësishme.....	36
Mësimi 6: Raportet shoqërore, sjelljet dhe shprehjet (Përsëritje).....	38
Mësimi 7: Natyra dhe shoqëria - aspektet gjeografike, ekonomike dhe kulturore.....	40
Mësimi 8: Raportet shoqërore, sjelljet dhe shprehjet (Projektprezantimet).....	42
Mësimi 9: Ndryshimet në natyrë dhe pasqyrimi i tyre në jetën e njeriut.....	44
Mësimi 10: Shkenca, teknologjia dhe natyra.....	46
Mësimi 11: Arti, kultura dhe natyra.....	48
Mësimi 12: Ndikimi i njeriut në natyrë.....	50
Mësimi 13: Ndikimi i njeriut në natyrë (Përsëritje).....	52
Mësimi 14: Krijimi dhe funksioni i rregullave dhe i normave.....	54
Mësimi 15: Rregullat e shkruara dhe ato të pashkruara.....	56
Mësimi 16: Rregullat, normat dhe ligjet (Përsëritje).....	58
Mësimi 17: Vlerësim me shkrim – ESE (Periudha I).....	60
Mësimi 18: Vlerat shoqërore: paqja, liria, barazia dhe demokracia.....	62
Mësimi 19: Vlerat humane dhe qytetare: humanizmi, solidariteti, tolerance.....	64
Mësimi 20: Vlerat humane: vullnetarizmi, falja dhe pajtim.....	66
Mësimi 21: Vlerat shoqërore dhe humane (Përsëritje).....	68
Mësimi 22: Dukuritë e dëmshme: paragjyqimi, diskriminimi dhe përjashtimi social.....	70
Mësimi 23: Dukuritë e dëmshme dhe të rrezikshme: ekstremizmi dhe terrorizmi.....	72
Mësimi 24: Dukuritë e dëmshme: korrupsioni.....	74
Mësimi 25: Dukuritë e dëmshme (Përsëritje).....	76
Mësimi 26: Përgjegjësitë dhe vendimmarrja (në nivelin lokal dhe atë qendror).....	78
Mësimi 27: Projekt – prezantime.....	80
Mësimi 28: Vendimmarrja në shkollë dhe për shkollën.....	82
Mësimi 29: Shoqëria civile dhe aktivizmi qytetar.....	84
Mësimi 30: Përfshirja në vendimmarrje.....	86
Mësimi 31: Përfshirja në vendimmarrje (Përsëritje).....	88
Mësimi 32: 17 objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm.....	90
Mësimi 33: Ekoqytetaria.....	92
Mësimi 34: Trajtimi human i kafshëve.....	94
Mësimi 35: Aktivitetet për shënimin e festave të mjedisit.....	96
Mësimi 36: Vlerësim me shkrim – ESE.....	98

Të dashur mësimdhënës dhe mësimdhënëse,

Në duar keni librin tuaj, i hartuar për t'ju ardhur në ndihmë në zhvillimin e mësimet, mbështetur në metodologjitë më të përparuara të sotme.

Sistemi arsimor në Kosovë ka kaluar përmes vështirësive të panumërta dhe në shkolla janë përdorur metoda tradicionale të mësimdhënies. Sot kemi mundësinë që arsimit t'i pajisë nxënësit me kompetencat që u nevojiten, për të formësuar jetën e tyre dhe për të kontribuar në shoqëri. Për të gjetur mënyrën më të mirë dhe për ta realizuar këtë synim, shtëpia botuese "Dukagjini" në vazhdim të nismës për përfshirjen e metodologjive të mësimdhënies ndërvepruese në librat e mësimdhënësve, ka për qëllim t'ju ndihmojë të gjeni përgjigje për pyetjen themelore: *Çfarë metodologjie do të përdorni për të ndërtuar e krijuar dije, shkathtësi, qëndrime dhe vlera që do t'u nevojiten nxënësve të Kosovës për formësuar të ardhmen e tyre?*

Integrimi në hapësirën arsimore të shekullit të 21-të kërkon, midis të tjerash, modernizimin e metodave ekzistuese të mësimdhënies dhe nxënies, futjen e veprimtarive bashkëkohore në mësim, që mundësojnë përgatitjen e një individi aktiv, të pavarur dhe të lirë, të pajisur me shprehje të menduarit kritik, krijues, komunikues, bashkëpunues dhe kurioz, i aftë për të përmbushur kërkesat e shoqërisë së sotme dhe të nesërme shqiptare.

Cilësia e re e të nxënit dhe mësimdhënies përbën përparësi absolute për arsimin. Ju nuk jeni vetëm burime informacioni, por kërkohet të përdorni metoda dinamike të mësimdhënies, të quajtura edhe metoda mësimore ndërvepruese, të cilat përbëjnë elementet bazë të këtij modeli, për t'i motivuar nxënësit që të angazhohen më shumë në mësim.

Modeli i këtyre librave është i pranishëm për herë të parë në Kosovë i zbatuar në vitin 2022 dhe mësimet janë hartuar nga kolegët tuaj, me përkushtim dhe përgjegjësi maksimale.

UDHËRRËFYES

për konceptimin e mësimëve model

Faqja në të majtë

- Këto janë të dhëna identifikuese, të cilat orientojnë për mësimin.
- Mësimi synon që, përmes rezultateve të të nxënës, të kontribuojë në një ose disa prej kompetencave.
- Rezultatet specifike janë në koherencë me ato të fushës.
- Të gjitha mjetet dhe materialet, e çdo lloji, që shërbejnë për konkretizim në ndihmë të të nxënës.
- Parashikimi është faza e parë e orës mësimore që siguron përqendrimin dhe aktivizimin e nxënësve në mësim.

- Paraqitja e faqes së librit të nxënësit ndihmon mësimdhënësin/en gjatë përgatitjes.
- Rezultatet e të nxënës të temës janë në koherencë me ato të orës mësimore; tema është më e gjerë.
- Rezultatet specifike të të nxënës janë ato mbi të cilat ndërtohet mësimi.
- Janë zbrërtim i rezultateve të të nxënës sipas niveleve të arritjes. Përcaktohen me nxënësit në klasë.
- Zakonisht, mësimi ka lidhje me lëndë dhe fusha të tjera, të cilat evidentoohen.

- Paraqitja e faqes së librit të nxënësit ndihmon mësimdhënësin gjatë përgatitjes.
- Vlerësimi formues në raport me rezultatet e të nxënës.
- Vetëreflektim dhe vetëvlerësim për orën mësimore në raport me arritjen e rezultateve të nxënësve.

- ### Faqja në të djathtë
- Përpunimi i përmbajtjes është faza e dytë e orës mësimore, ku bëhet përzgjedhja e materialit mësimor dhe organizimin metodologjik i tij.
 - Përforsimi është faza e tretë e orës mësimore, ku bëhet integrimi i dijeve dhe shprehive, si dhe zbatimi i tyre.

Përshkrim i rubrikave kryesore të orës së mësim

Rezultatet e të nxënës të temës janë hartuar mbi bazën e koncepteve të përgjithshme, të cilat janë pika referuese në përzgjedhjen e përmbajtjeve mësimore për lëndën dhe rezultateve të të nxënës për këtë temë. Në këtë rast, mund të merren nga tabela e krahasimit të planeve dhe programeve ekzistuese me Kurrikulën Bërthamë, por edhe mund të hartohen vetë, mund të jenë një, dy a më shumë rezultate. Një rezultat i të nxënës të lëndës mësimore mund të shërbejë për një apo më shumë njësi mësimore - kjo varet nga përshkrimi i rezultatit të të nxënës dhe nga elementet përbërëse të tij.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës. Duke filluar nga klasa e tretë e më lart, nxënësit zotërojnë operacione mendore; të menduarit e tyre është konkret, me elemente të të menduarit abstrakt. Prandaj, mësimi me këta nxënës kalon në tri faza, dhe të menduarit e tyre sipas proceseve njohëse.

Zhvillimi i kompetencave, përkatësisht në rezultatet e tyre, bëhet përmes fushës kurrikulare, e cila kontribuon në arritjen e rezultateve të kompetencave. Të gjitha kompetencat kryesore të kurrikulës zërthehen në rezultate të të nxënësve. Ato janë pjesë e Kurrikulës Bërthamë dhe parashihen të përvetësohen nga nxënësit, me rastin e përfundimit të shkallës së kurrikulës.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës. Shprehin kërkesat thelbësore të arritjes në fushën kurrikulare, drejt zotërimit të kompetencave kryesore në përfundim të shkallës. Ato përshkruajnë atë se çfarë duhet të dijë, të besojë, të vlerësojë dhe të jetë i aftë për të bërë nxënësi në fund të shkallës a nivelit dhe shprehin një varg domenesh, duke përfshirë: njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat. Vendosen rezultatet e të nxënësve të fushës kurrikulare, vetëm ato që reflektohen në temën mësimore.

Rezultatet e të nxënësve. Rezultatet specifike të të nxënësve janë ato mbi të cilat ndërtohet ora e mësimi, të cilat përbëjnë detajimin e rezultateve të të nxënësve të temës që janë në koherencë me ato të fushës së kurrikulës.

Kriteret e vlerësimit/suksesit janë zëritim i rezultateve të të nxënësve sipas niveleve të arritjes dhe sigurojnë vlerësim të drejtë për shkallën e zotërimit. Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Metodologjia dhe veprimtaritë me nxënës - fazat e zhvillimit të mësimi. Tashmë nxënësit, duke filluar nga klasa e tretë e lart, zotërojnë operacionet mendore, të cilat kanë karakter konkret, me elemente të të menduarit abstrakt. Me kalimin në klasat më të larta, marrin karakter mbizotërues, pasi të menduarit është formal. Mësimi me këta nxënës kalon në tri faza të të menduarit gjatë të nxënësve, sipas proceseve njohëse.

Çfarë simbolizon modeli me tri pamje të ndryshme të ciklit të jetës së bimës së grurit në tri fazat e mësimi?

Mbillet një farë. Pasi është bërë puna themelore e fillimit, mësimdhënësi vazhdon dhe fara e grurit lëshon rrënjë dhe bima rritet. Kalliri i grurit është pjekur dhe përmban fara për shumë bimë të tjera; po kështu, edhe mësimi mund të çojë në shumë veprimtari të tjera. Cikli i jetës së grurit, nga fara në tokë, në bimë, e prapë në farë, sugjeron, gjithashtu, ciklin e vazhdueshëm të shkollimit përmes mbështetjes në njohuritë ekzistuese, për të vazhduar më tej.



Parashikimi: Përgatitja për të nxënës

Në fazën e parashikimit mbillet një farë në një truall pjellor. Mësimi duhet të mbështetet edhe në njohuritë ekzistuese të nxënësve, ashtu si fara merr ushqim nga trualli ku është mbjellë.

Kjo është faza e parë e strukturës për zhvillimin e të menduarit dhe të të nxënësve. Në këtë fazë kryhen veprimtari të ndryshme njohëse, nxënësi është i përfshirë gjallërisht në rikujtimin e asaj çka di rreth temës së mësimi, bën lidhjen e njohurive të reja me ato që dihen. Nxënësit ndërtojnë njohuritë, konceptet, kuptimin e ri mbi dukuritë e caktuara nga bazat e njohurive të mëparshme.



Ndërtimi i njohurive: Përpunimi i përmbajtjes

Mësimi vazhdon me fazën e ndërtimit të njohurive; fara e grurit lëshon rrënjë dhe bima rritet. Kjo është faza e dytë e strukturës për zhvillimin e të menduarit të nivelit të lartë gjatë të nxënësve dhe nxënësi është i përfshirë në procesin e përfundimit të kuptimit të njohurive. Gjithashtu, ruan interesin dhe ritmin e vendosur gjatë fazës së parashikimit.



Përforcimi: Konsolidimi i të nxënësve

Mësimi përfundon me fazën e përforcimit. Kalliri i grurit është pjekur dhe përmban fara për shumë bimë të tjera; po kështu, edhe mësimi mund të çojë në shumë veprimtari të tjera. Në këtë fazë, nxënësit konsolidojnë të nxënësit e ri dhe ristrukturojnë skemën e tyre për të përshtatur konceptet e reja dhe për t'i zbatuar ato.

HYRJE

Konceptimi dhe ndërtimi i librit për mësime të ndërhënësive/en

EDUKATË QYTETARE 7

Fusha kurrikulare *Shoqëria dhe mjedisi* në nivelin e dytë, realizohet përmes mësimit lëndor. Lëndë mësimore e kësaj fushe në këtë nivel është edhe edukata qytetare. Meqenëse kjo fushë realizohet përmes mësimit lëndor, mësime të ndërhënësive duhet t'i kenë parasysh qëllimet e përbashkëta të fushës, të cilat do të realizohen përmes përmbytjeve lëndore duke synuar mësimin e integruar.

Fusha *Shoqëria dhe mjedisi* i ndihmon nxënësit për t'i njohur dhe për t'i kuptuar më mirë konceptet, proceset dhe zhvillimet historike në nivel lokal, kombëtar, rajonal dhe botëror, duke përfshirë lindjen dhe zhvillimin e qytetërimeve të ndryshme si dhe ngjarjet dhe personalitetet e rëndësishme nga kohët më të lashta deri më sot.

Kjo fushë ndihmon nxënësit për t'i thelluar njohuritë mbi vendet dhe hapësirën, sistemet fizike e humane, rajonet dhe karakteristikat e tyre. Gjithashtu, ndihmon krijimin e shprehive, vlerave dhe qëndrimeve në raport me diversitetin kulturor, identitetin social, trashëgiminë kulturore dhe natyrore, organizimin shoqëror, liritë dhe të drejtat e njeriut si dhe rolin dhe funksionimin e institucioneve demokratike.

Fusha *Shoqëria dhe mjedisi*, në shkallën e tretë kurrikulare, ka për qëllim zhvillimin e aftësive, shkathtësive, vlerave dhe qëndrimeve, për të qenë qytetar i përgjegjshëm, për të zhvilluar identitetin personal dhe për të njohur më mirë atë kolektiv (social, kombëtar, shtetëror, etnik, fetar, racor, gjinor, kulturor, regjional). Kjo fushë ndihmon zhvillimin e aftësive për të gjykuar drejt dhe për të marrë vendime të përgjegjshme në jetën e përditshme, kultivimin e shprehive dhe marrjen e nismave për ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit.

Fusha *Shoqëria dhe mjedisi* në këtë nivel ndihmon nxënësit për t'i zhvilluar e për t'i përforcuar më tej njohuritë e tyre duke siguruar një bazë fillestare për orientim akademik dhe orientim në karrierë.

Udhëzime metodologjike

Për të realizuar qëllimet e kurrikulës, përmes fushës *Shoqëria dhe mjedisi*, këshillohet përdorimi i metodave të ndryshme që plotësojnë njëra-tjetrën dhe që mundësojnë zhvillimin e të menduarit kritik e krijues te nxënësi, për zbatimin e njohurive dhe shkathtësive në situata të ndryshme.


Përzgjedhja e metodave është kompetencë e mësimitdhënësit/es të fushës. Ajo bëhet në përshtatje me nevojat dhe kërkesat e nxënësve, me natyrën e përmbajtjes tematike mësimore dhe të rezultateve të kompetencave për shkallën e tretë kurrikulare, me bazën didaktike dhe me nivelin e formimit të nxënësve, duke i dhënë secilit mundësinë të shfaqë dhe të zhvillojë maksimumin e potencialit që zotëron brenda vetes.

Mësimitdhënësi/ja është i/e lirë të përdorë metoda mësimore bashkëkohore ndërvepruese dhe gjithëpërfshirëse, teknika e forma të shumëllojta të punës dhe një kompleks të tërë procedurash. Këto metoda duhet të jenë në funksion të nxitjes së mendimit të pavarur, kritik e krijues. Metodatat dhe teknikat e punës me nxënës, kërkohen të jenë të kombinuara dhe të shumëllojta, në funksion të arritjeve të rezultateve të të nxënësve dhe të zbatimit të jetën e përditshme.

Metodologjia ndërvepruese në mësimitdhënie dhe të nxënësve

Libri që keni në duar, është hartuar për t'ju pajisur me metodologjinë ndërvepruese në ndërtimin e dijeve dhe formimit të shkathtësive. Ai trajton temat mësimore në përputhje "Kurrikula Bërthamë e Arsimit të Mesëm të Ulët të Kosovës" (e rishikuar) (2016) si edhe të gjitha dokumentet dhe udhëzimet administrative në fuqi ku është mbështetur metodologjia me të gjithë elementet përbërëse, duke filluar me kontributin në kompetencat kryesore dhe rezultatet e të nxënësve të fushës, rezultatet specifike të të nxënësve të njësisë mësimore, mjetet e punës, ecuria metodologjike e orës së mësimit e deri te vlerësimi i nxënësve. Një nga risitë e këtij libri është se përmban edhe një rubrikë: *Reflektim për rrjedhën e orës mësimore*. Qëllimi i kësaj rubrike është që t'ju ndihmojë të mbani shënime për punën tuaj në klasë, arritjet, por edhe dështimet, dhe më pas të reflektoni kur të bëni përsëritje, të kontrolloni dijet dhe të bëni vlerësimin e nxënësve, por edhe kur të zhvilloni mësimin një vit apo disa vjet më pas.

Në aspektin metodologjik të hartimit të modeleve orientuese për çdo orë mësimit, është treguar kujdes i veçantë në harmonizimin e të gjitha veprimtarive. Marrëdhëniet midis rezultateve të të nxënësve - procedurave të mësimitdhënies dhe të nxënësve - vlerësimit, përbëjnë atë që në metodologjinë e sotme quhet "trekëndësh magjik". Ky trekëndësh paraqet marrëdhëniet koherente midis rezultateve të të nxënësve, veprimtaritë e mësimitdhënies të të nxënësve dhe vlerësimit. Këta tre komponentë janë në koherencë me njëri-tjetrin, me qëllim që nxënësit të inkurajohen për të mësuar, të jenë pjesëmarrës aktivë në ndërtimin e dijeve dhe të shkathtësive.



Burimi: *Metodologji e mësimdhënies*, (faqe 102), B. Musai, 2014. Botuar në Tiranë: CDE

Zgjeroni dhe thelloni dijet
 Për më shumë lexoni në: Musai, B. (2014) *Metodologji e mësimdhënies*. Tiranë: CDE, faqe 101-128.

Metodologjia e çdo teme zhvillohet në mënyrë pamore rreth mësimit të librit të nxënësit, e cila ju ndihmon ta shikoni atë pa pasur nevojën që ta keni pranë. Përdorimi i kësaj mënyre të paraqitjes metodologjike të mësimit ka dhënë rezultate mjaft të mira.

Metodologjia ndërvepruese ka si qëllim përfshirjen aktive të nxënësve në ndërtimin e dijes dhe formimin e shprehive. Zhvillimi i nxënësve që mendojnë në mënyrë kritike e që janë krijues është në qendër të metodave të mësimdhënies, të mënyrave të të nxënit e të çdo veprimtarie tjetër, me synim zhvillimin e shprehive të të menduarit të nivelit të lartë. Por, nga ana tjetër, jemi mbështetur edhe në parimet e psikologjisë së edukimit, kryesisht të zhvillimit njohës sipas moshave, me konsideratë të veçantë Zonën e Zhvillimit Proksimal të Vigotskit, e cila është zona midis nivelit aktual të zhvillimit të fëmijës, sipas përcaktimit të aftësive për

Zgjeroni dhe thelloni dijet
 Për më shumë lexoni në: Woolfolk, A. (2011) *Psikologji edukimi*. Tiranë: CDE, faqe 47-51.

zgjidhjen e pavarur të problemeve dhe nivelit të zhvillimit që fëmija është në gjendje të arrijë, përmes orientimit të të rriturve, apo në bashkëpunim me bashkëmohatarët e tij më të aftë. Kjo është një hapësirë dinamike ku mësimdhënia mund të japë rezultate e ndodhet diku midis asaj që nxënësi di dhe asaj që nxënësi nuk është gati të mësojë. Zona e zhvillimit proksimal është hapësira e mësimit midis së mërzitshmes dhe së pamundurës. Në këtë hapësirë, mbështetja nga mësimdhënësi apo nga një bashkëmohatar mund të bëjë që mësimi të japë rezultate.



Burimi: *Psikologji edukimi*, (faqe 47), A. Woolfolk, 2011. Botuar në Tiranë: CDE



Zgjeroni dhe thelloni dijet

Për më shumë lexoni në: Woolfolk, A. (2011) *Psikologji edukimi*. Tiranë: CDE, faqe 32-36.

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës 3

Nr. Rezultatet e të nxënit për shkallën 3 dhe kompetencat kryesore	
I Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit - Komunikues efektiv	
1.	Lexon rrjedhshëm, me intonacion të duhur, një tekst të caktuar rrëfyes, përshkrues, shkencor a publicistik etj., dhe e komenton atë sipas kërkesës me gojë ose me shkrim.
2.	Dëgjon në mënyrë aktive pyetjet dhe komentet e bëra nga të tjerët për temën e prezantuar të fushës së caktuar, duke u paraqitur nëpërmjet pyetjeve, komenteve, sqarimeve dhe propozimeve.
3.	Veçon porosinë kryesore të lexuar ose të dëgjuar nga një burim, si: libër, gazetë, revistë, internet, radio, TV etj., e komenton dhe e shfrytëzon atë si referencë gjatë hartimit të një punimi/detyre me shkrim.
4.	Shpreh mendimin/gjykimin për një temë të caktuar ose prezantim artistik, me anë të të folurit ose me shkrim, si dhe në forma të tjera të komunikimit.
5.	Shpreh drejt mendimin apo kërkesën, me gojë ose me shkrim, në gjuhën joamtare ose të huaj, për një situatë të caktuar të supozuar, në rast nevoje (për shërbim, ndihmë, informim, orientim etj.), duke ndërvepruar në grup ose në klasë.

II Kompetenca e të menduarit - Mendimtar kreativ dhe kritik	
1.	Paraqet argumente për pajtueshmëri ose kundërshtim të një qëndrimi ose mendimi për një temë/ problem të caktuar gjatë një debati ose të publikuar në medie;
2.	Zgjidh një problem (aritmetik, gjeometrik, gjuhësor, shoqëror, shkencor etj.), të dhënë në formë tekstuale ose tekstuale e numerike, eksperimentale dhe arsyeton përzgjedhjen e procedurave përkatëse;
3.	Përzgjedh dhe demonstroi ecuri/strategji të ndryshme për zgjidhjen e një problemi (matematik, gjuhësor, shkencor, artistik a shoqëror), duke dëshmuar arritjen e përfundimit, gjegjësisht rezultatin e njëjtë;
4.	Interpreton rregullat e zhvillimit të një procesi natyror apo shoqëror, duke e ilustruar atë me shembuj konkretë, si: ilustrim, skicë ose me shkrim;
5.	Krahason ngjashmëritë dhe dallimet e fazave më të rëndësishme nëpër të cilat është zhvilluar një proces/dukuri shoqërore, natyrore ose artistike;
6.	Përdor krahasimin dhe kontrastin për të gjetur dallimet dhe ngjashmëritë kryesore midis dy e më shumë dukurive natyrore dhe shoqërore, krijimeve letrare apo artistike.

III Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Nxënës i suksesshëm	
1.	Kërkon dhe përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (si: libra, revista, doracakë, fjalorë, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.
2.	Shfrytëzon të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve numerike, grafike, simboleve, formulave në shkenca natyrore dhe shoqërore, në matematikë ose arte, duke i sqaruar në forma të ndryshme të të shprehurit.
3.	Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.
4.	Shfrytëzon dosjen personale për identifikimin e përparësive dhe mangësive në funksion të vetëvlerësimit të përparimit dhe përmirësimit të suksesit në fushën e caktuar.
5.	Ndërlidh temën e dhënë, që është duke e mësuar, me njohuritë dhe përvojat paraprake që tashmë i ka, duke i paraqitur ato në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafikë), sipas një radhitjeje logjike.
6.	Përdor programet softuerike adekuate për zgjidhjen e problemeve dhe kryerjen e detyrave/punimeve shkollore dhe joshkollore në fusha të ndryshme të dijës.

IV Kompetenca për jetë, punë dhe mjedis - Kontribues produktiv

1.	Zhvillon një projekt individual ose në bashkëpunim me anëtarët e grupit, për kryerjen e një aktiviteti mjedisor apo shoqëror me rëndësi për shkollën ose për komunitetin.
2.	Diskuton në grup moshatarësh për rëndësinë që ka mbrojtja e mjedisit, për pasojat që sjell dëmtimi i mjedisit për jetën e njeriut dhe propozon masat që duhet të ndërmerren për evitimin e tyre.
3.	Identifikon dhe vlerëson burimet e nevojshme (p.sh., pajisjet, materialet, burimet njerëzore, kohën etj.) për realizimin e një aktiviteti në shkollë ose në komunitet.
4.	Përdor programet kompjuterike për përgatitjen e materialeve të nevojshme (si: grafikë, ilustrime të nevojshme, disejnim të ftesave, pamfleteve, njoftimeve apo publikimeve të tjera) për nevoja të klasës dhe të shkollës.

V Kompetenca personale - Individ i shëndoshë

1.	Prezanton para nxënësve procesin e përgatitjes së një ushqimi a specialiteti shtëpiak sipas një recete për ushqim të shëndetshëm.
2.	Vlerëson përmbajtjen e vlerave pozitive dhe negative, të paktën të tri llojeve të ushqimeve, të cilat konsumohen në mjedisin e tij ose në rrethinë.
3.	Identifikon shenjat e rrezikut në prodhime apo objekte konkrete dhe u shpjegon të tjerëve porosinë apo kërkesën e tyre vizuale.
4.	Shpjegon, gjatë një debati, prezantimi, me gojë ose me shkrim, pasojat e përdorimit të duhanit, alkoolit, drogës dhe substancave të tjera të dëmshme për shëndetin dhe mirëqenien e individit.

VI Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm

1.	Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, në shkollë etj., dhe merr qëndrim aktiv ndaj personave që nuk i përfillojnë ato, duke ua shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bëjnë pjesë.
----	---

<p>Proceset shoqërore dhe natyrore</p>	<p>RNF: 2. Hulumton dukuritë dhe proceset shoqërore, historike, natyrore dhe mjedisore duke vënë në pah ndërlidhjet, ndërvarjet dhe ndërveprimet reciproke. 2.1. Përdor burime të ndryshme kur prezanton dallimet në mënyrën e jetesës së njerëzve në kohë dhe hapësirë, duke pasur parasysh lëvizjet dhe zhvillimet përgjithshme historike, shoqërore dhe natyrore. 2.2. Shpjegon orientimin në hapësirë, pozitën e Tokës në Sistemin Diellor, përbërjen e gjeosferave, veçoritë e elementeve natyrore dhe sociogjeografike të mjedisit natyror e human.</p>
	<p>Lidhjet dhe ndikimet reciproke të natyrës dhe shoqërisë</p> <ul style="list-style-type: none"> • Analizon lidhjet dhe ndikimet reciproke ndërmjet natyrës dhe shoqërisë duke pasur parasysh aspektet gjeografike, mjedisore, ekonomike dhe kulturore. • Analizon ndryshimet në shoqëri si procese të përgjithshme dhe të përhershme të shkaktuara nga natyra ose njeriu, si: tërmetet, vullkanet, vërshimet, thatësitë, shkrirja e akullnajave, lufta, epidemitë, uria, varfëria, papunësia etj., shpesh të ndërlidhura dhe të ndërvarura. • Shpjegon rëndësinë e përdorimit të teknologjisë për të hulumtuar dhe prezantuar natyrën në funksion të zhvillimit ekonomik, kulturor e turistik. • Prezanton gjetjet nga eksplorimi i natyrës në rrethinë e më gjerë, si: florën dhe faunën, lumenjtë, liqenet, parqet kombëtare, malet, fushat pjellore, monumentet natyrore dhe ndikimin njerëzor në natyrë. • Analizon dokumentarë dhe burime të ndryshme për ndikimin e njeriut në natyrë.
<p>Normat, të drejtat dhe përgjegjësitë</p>	<p>RNF: 3. Analizon dhe shqyrton në mënyrë kritike dhe zbaton normat e rregullat shoqërore për jetë të përbashkët në diversitet 3.1. Kupton dhe analizon shkaqet dhe rrethanat e ndryshimit të normave, ligjeve dhe zakoneve për rregullimin e jetës shoqërore në kohëra dhe vende të ndryshme. 3.2. Kupton dhe vlerëson llojllojshmërinë e kulturave, traditave, bashkësive të ndryshme, dhe tregon tolerancë dhe respekt për to.</p>
	<p>Rregullat, normat dhe ligjet</p> <ul style="list-style-type: none"> • Shpjegon evoluimin dhe funksionimin e rregullave, normave dhe ligjeve shoqërore dikur dhe sot. • Krahason traditat, zakonet dhe adetet e pashkruara që praktikohen ose janë praktikuar dikur në familje ose komunitet, si: besa, mikpritja, fejesa dhe martesat, lojërat tradicionale, festat popullore etj., me rregullat, normat dhe ligjet e shkruara që praktikohen në shoqëri dhe institucione publike, si: shkollë, teatër, spital, polici, organe të pushtetit, organizata shoqërore etj.
	<p>Vlerat shoqërore, humane dhe qytetare</p> <ul style="list-style-type: none"> • Shpjegon rëndësinë e respektimit të vlerave humane për funksionimin e një shoqërie të qëndrueshme, si p.sh., paqja, liria, barazia, respektimi i të drejtave të njeriut, solidariteti, toleranca, bamirësia, vullnetarizmi, falja, pajtimi, ndihma, empatia, shpëtimi etj., dhe i praktikon këto në jetën e përditshme. • Shpjegon rëndësinë e raportimit të veprimeve që janë në kundërshtim me vlerat e shoqërisë demokratike, si: paragjykimet racore ose etnike, diskriminimin gjinor, jotolerancën fetare, përjashtimin social, ekstremizmin, radikalizmin, korrupsionin etj., te personat dhe institucionet përgjegjëse. • Shpjegon rëndësinë e raportimit të veprimeve të dhunshme dhe aktiviteteve të paligjshme, si: trafikimi i lëndëve narkotike, armëve, qenieve njerëzore, detyrimit në punë të rënda, trajtimit johuman të të pambrojturve dhe viktimave të trafikimit të personat dhe institucionet përgjegjëse. • Shpjegon rëndësinë e përfitimit të shoqërisë nga trajtimi i barabartë i të gjithë qytetarëve pa dallim përkatësie gjinore, moshe, sociale, etnike, fetare, racore etj., duke u bazuar në dokumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.
<p>Vendimarrja dhe institucionet</p>	<p>RNF: 4. Jep ide dhe propozime si dhe merr vendime në mënyrë të vetëdijshme dhe të përgjegjshme 4.1. Vlerëson ndikimin e vendimarrjes individuale, grupore e institucionale në kohë dhe vende të ndryshme, krijon qëndrime personale për to dhe i përdor në jetën e tij të përditshme. 4.2. Tregon kujdes, respekt e përgjegjshmëri për vendimarrjen e drejtë në aktivitetet ku është i përfshirë (në shkollë, bashkësi dhe më gjerë).</p>

	<p>Pjesëmarrja në vendimmarrje institucionale</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Dallon rolin institucioneve lokale dhe atyre qendrore në vendimmarrje për rregullimin e jetës së qytetarëve në nivel lokal dhe shtetëror. • Shpjegon se si secili qytetar i moshës madhore mund të bëhet pjesë e institucioneve vendimmarrëse të nivelit lokal dhe qendror. • Demonstron njohuri dhe shkathtësi për pjesëmarrje në vendimmarrje në nivel klase, shkolle apo komuniteti, që kanë të bëjnë me interesat e bashkëmoshatarëve. • Analizon vendimet që merren nga grupe, organe dhe institucione të ndryshme që janë me interes për të dhe bashkëmoshatarët, p.sh., për sjelljet, vlerësimin e arritjeve, përfshirjen ose mospërfshirjen në aktivitete shkollore dhe jashtë saj etj. • Identifikon dhe respekton vendimet që dalin nga institucionet shkollore, lokale dhe qendrore, që janë me interes për të, shoqërinë dhe mjedisin (p.sh., vendimet e këshillave të ndryshme që funksionojnë në shkollë, në lagje, dhe nivel vendi). • Vlerëson rolin e shoqërisë civile, medieve dhe grupeve të ndryshme (OJQ-ve, shoqatave, forumeve, medieve të shtypura dhe elektronike, grupeve të ndryshme në rrjetet sociale etj.), në interes të përmirësimit cilësisë së jetës dhe për nxitjen e qytetarëve për të reaguar ndaj padrejtësive të ndryshme, dhe për të dhënë ide dhe propozime konkrete.
<p>Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm</p>	<p>RNF: 5. Kontribuon në ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit si dhe në zhvillimin e qëndrueshëm. 5.1. Inicion aktivitete konkrete grupore me qëllim të ngritjes së vetëdijes së bashkësisë për ruajtjen dhe zhvillimin e mjedisit jetësor. 5.2. Vlerëson dhe vepron sipas parimeve bazë të zhvillimit të qëndrueshëm.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Prezanton aktivitete që zhvillohen në shkollë, komunitet dhe më gjerë, për çështje mjedisore (p.sh., iniciativat e nxënësve, klubeve në shkollë, prindërve, qytetarëve dhe OJQ-ve që veprojnë në komunitet). • Shpjegon rëndësinë dhe demonstroi shkathtësitë e kursimit të ujit, energjisë, ruajtjes së gjelbërimit, riciklimit të mbeturinave, kultivimit të bimëve, mbrojtjes së kafshëve, në aspektin dhe funksionin e mirëqenies ekonomike, shëndetësore dhe sociale. • Identifikon dhe analizon masat mbrojtëse të organizatave dhe institucioneve përkatëse për mjedisin që veprojnë në komunë dhe në nivel vendi, si: parandalimi i ndotjes së ujit, ajrit, tokës, pastaj kufizimin e gjuetisë, keqtrajtimin e kafshëve etj. • Bashkëpunon me të tjerët, organizata apo institucione përkatëse për realizimin e aktivitete të ndryshme lidhur me shënimin e festave mjedisore, si: Dita Botërore e Mjedisit Dita e Tokës, Dita e Ujit, Dita e Biodiversitetit etj.

Planifikimi vjetor i temave mësimore për fushën e kurrikulës: Edukatë qytetare, Klasa VII

Lëndët e fushës kurrikulare	TEMAT MËSIMORE TË SHPËRNDARA GJATË MUAJVE				Rezultatet e kompetencave (Rezultatet e të nxënit për shkallë)
	Gjysmëvjetori I		Gjysmëvjetori II		
	shtator—tetor	nëntor—dhjetor	janar—shkurt—mars	prill—maj—qershor	
EDUKATË QYTETARE	<p>Raportet shoqërore, sjelljet dhe shprehitë</p> <p>Lidhjet dhe ndikimet reciproke të natyrës dhe shoqërisë</p>	<p>Lidhjet dhe ndikimet reciproke të natyrës dhe të shoqërisë</p> <p>Rregullat, normat dhe ligjet</p>	<p>Vlerat shoqërore, humane dhe qytetare</p> <p>Pjesëmarrja në vendimmarrje institucionale</p>	<p>Pjesëmarrja në vendimmarrje institucionale</p> <p>Mjedisi dhe mirëqenia</p>	<p>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit – Komunikues efektiv 1, 2, 3, 4, 6, 8</p> <p>Kompetenca e të menduarit – Mendimtar kreativ 1, 6, 8</p> <p>Kompetenca e të nxënit – Nxënës i suksesshëm 1, 3, 5</p> <p>Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis – Kontribues produktiv 1, 2, 3, 4, 7</p> <p>Kompetenca personale – Individ i shëndoshë 5, 6, 8</p> <p>Kompetenca qytetare – Qytetar i përgjegjshëm 1, 2, 4, 7</p>
	Gjithsej 9 orë	Gjithsej 9 orë	Gjithsej 10 orë	Gjithsej 9 orë	

PLANI DYMUJOR: SHTATOR—TETOR

Lënda mësimore: Edukatë qytetare

Fusha e kurrikulës: Shoqëria dhe mjedisi

Klasa: VII

Temat mësimore: Raportet shoqërore, sjelljet dhe shprehitë/Lidhjet dhe ndikimet reciproke të natyrës dhe të shoqërisë

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohet të arrihen përmes shtjellimit të temës/temave:

I.I	Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit – Komunikues efektiv I. 1, 2, 3, 4, 6, 8
I.II	Kompetenca e të menduarit – Mendimtar kreativ II. 1, 6, 8

Rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohet të arrihen përmes shtjellimit të temës/temave:

RNF: 1. Hulumton strukturën e grupeve shoqërore dhe mënyrat e pjesëmarrjes dhe përfshirjes në to.

I.1	Njeh grupet dhe institucionet shoqërore, strukturën dhe organizimin e tyre, si dhe ndërlidhjen me kontekstin kohor dhe hapësinor.
I.2	Përkufizon profilin e personaliteteve të shquara dhe kontributin e tyre për zhvillimin e përgjithshëm të shoqërisë ose të fushave të veçanta të saj.
I.3	Shpjegon hapësirën e banimit dhe të veprimt, shpërndarjen dhe lëvizje natyrore të popullsisë, migrimet, strukturën, organizimin, zhvillimin dhe transformimin e vendbanimeve dhe të ekonomisë në nivel lokal, rajonal dhe global.

RNF: 2. Hulumton dukuritë dhe proceset shoqërore, historike, natyrore dhe mjedisore duke vënë në pah ndërlidhjet, ndërvarjet dhe ndërveprimet reciproke.

II.1	Përdor burime të ndryshme kur prezanton dallimet në mënyrën e jetesës së njerëzve në kohë dhe hapësirë, duke pasur parasysh lëvizjet dhe zhvillimet përgjithshme historike, shoqërore dhe natyrore.
II.2	Shpjegon orientimin në hapësirë, pozitën e Tokës në Sistemin Diellor, përbërjen e gjeosferave, veçoritë e elementeve natyrore dhe sociogjeografike të mjedisit natyror e human.

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënëit për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e Vlerësimit	Ndërlidhja me lëndët e tjera, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet
Raportet shoqërore, sjelljet dhe shprehitë	- Dallon llojet e ndryshme të raporteve shoqërore (miqësore, bashkëpunuese, afruese, integruese, si dhe ato jomiqësore, larguese, përjashtuese, diskriminuese) dhe lidhjet e tyre me sjelljet personale dhe kolektive.	Prezantimi i planprogramit 1. Ndërveprimet në jetën e përditshme	1 orë	- Mësimdhënie dhe mësimnxënie të bazuar në qasjen e integruar	Vlerësimi për të nxënë - i vazhdueshëm	Ndërlidhja me lëndë të tjera mësimore: Histori Gjeografi	Libri i ed. qytetare (<i>Dukagjini</i> , 2020) Shemsi Krasniqi, Sheribane Ibrahimaj - Bahtiri
Lidhjet dhe ndikimet reciproke të natyrës dhe shoqërisë	- Përkrahet ndjenjën e ngrohtësisë dhe të sigurisë që e ndien në shtëpi dhe në shkollë, duke qenë i rrethuar me njerëz të afërt dhe dashamirës. - Klasifikon dhe përkrahet rolin e grupeve, të organizatave të ndryshme të shoqërisë civile, si dhe institucioneve që veprojnë në fusha të ndryshme, si: mjedisi, arsimi, kultura, shërbimet publike etj. - Përkrahet dhe krahason funksionin dhe kompetencat e institucioneve të Kosovës në nivelin lokal dhe atë qendror që u shërbejnë qytetarëve, si p.sh.: arsim, shëndetësi, mjedisi, punësim, drejtësi, infrastrukturë, kulturë, zhvillim ekonomik, siguri, mbrojtje, migrimit, trafikimit, dhunës, ngacmimit (bullying) etj. - Analizon rolin e personaliteteve të shquara historikisht në nivel kombi dhe më gjerë dhe ndikimin e tyre në themelimin e institucioneve shtetërore, ligjvënësë, ekzekutive dhe gjyqësore, organizatave, shoqatave humanitare etj.	2. Sjelljet dhe shprehitë njerëzore 3. Kompetencat e institucioneve dhe roli i organizatave joqeveritare (OJQ) 4. Përgjegjësitë e pushtetit lokal dhe të atij qendror 5. Roli i personaliteteve të rëndësishme 6. Përsëritje (Raportet shoqërore, sjelljet dhe shprehitë) 7. Natyra dhe shoqëria - aspektet gjeografike, ekonomike dhe kulturore 8. Projekt - prezantime	1 orë 1 orë 1 orë 1 orë 1 orë 1 orë 1 orë 1 orë	- Mësimdhënie dhe mësimnxënie të diferencuar - Mësimdhënie dhe mësimnxënie me nxënësin në qendër dhe gjithëpërfshirja - Mësimdhënie që nxit të menduarit kritik - Diskutimi dhe të nxënë në bashkëpunim	Vlerësimi me gojë Vlerësimi në punë grupore Vlerësimi i detyrave të shëpisë Vlerësimi me shkrim Vlerësimi i portfolios - Projektprezantime	Çështjet ndërkurrikulare: Edukimi për qytetari demokratike	Materiale nga interneti Revista Tekste nga fusha të tjera Slide/materiale të krijuara nga mësimdhënësit

PLANI DYMUJOR: NËNTOR—DHJETOR

Lënda mësimore: Edukatë qytetare

Fusha e kurrikulës: Shoqëria dhe mjedisi

Klasa: VII

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohet të arrihen përmes shtjellimit të temës/temave:

I.II	Kompetenca e të menduarit – Mendimtar kreativ II. 1, 6, 8
I.III	Kompetenca e të nxënit – Nxënës i suksesshëm III. 1, 3, 5

RNF: 2. Hulumton dukuritë dhe proceset shoqërore, historike, natyrore dhe mjedisore, duke vënë në pah ndërlidhjet, ndërvarjet dhe ndërveprimet reciproke.

II.1	Përdor burime të ndryshme kur prezanton dallimet në mënyrën e jetesës së njerëzve në kohë dhe hapësirë, duke pasur parasysh lëvizjet dhe zhvillimet e përgjithshme historike, shoqërore dhe natyrore.
II.2	Shpjegon orientimin në hapësirë, pozitën e Tokës në Sistemin Diellor, përbërjen e gjeosferave, veçoritë e elementeve natyrore dhe socio-gjeografike të mjedisit natyror e human.

RNF: 3. Analizon dhe shqyrton në mënyrë kritike dhe zbaton normat e rregullat shoqërore për jetë të përbashkët në diversitet.

III.1	Kupton dhe analizon shkaqet dhe rrethanat e ndryshimit të normave, ligjeve dhe zakoneve për rregullimin e jetës shoqërore në kohë dhe vende të ndryshme.
III.2	Kupton dhe vlerëson llojllojshmërinë e kulturave, traditave, bashkësive të ndryshme dhe tregon tolerancë dhe respekt për to.

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënit për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e Vlerësimit	Ndërlidhja me lëndët e tjera, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet
Lidhjet dhe ndikimet reciproke të natyrës dhe shoqërisë	- Analizon ndryshimet në shoqëri si procese të përgjithshme dhe të përhershme të shkaktuara nga natyra ose njeriu, si: tërmetet, vullkanet, vërshimet, thatësitë, shkrirja e akullnajave, lufta, epidemitë, uria, varfëria, papunësia etj., shpesh të ndërlidhura dhe të ndërvarura.	9. Ndryshimet në natyrë dhe pasqyrimi i tyre në jetën e njeriut	1 orë	- Mësimdhënie dhe nxënë të bazuar në qasjen e integruar	Vlerësimi për të nxënë - i vazhdueshëm	Ndërlidhja me lëndë të tjera mësimore: Histori	Libri i ed. qytetare (<i>Dukagjini</i> , 2020)
Rregullat, normat dhe ligjet	- Shpjegon rëndësinë e përdorimit të teknologjisë për të hulumtuar dhe prezantuar natyrën në funksion të zhvillimit ekonomik, kulturor e turistik.	10. Shkenca, teknologjia dhe natyra	1 orë	- Mësimdhënie dhe mësimnxënie të diferencuar	Vlerësimi i bazuar në kritere	Gjeografi	Shemsi Krasniqi, Sheribane Ibrahimaj-Bahtiri
	- Prezanton gjetjet nga eksplorimi i natyrës në rrethinë e në gjerë, si: florën dhe faunën, lumenjtë, liqenet, parqet kombëtare, malet, fushat pjellore, monumentet natyrore dhe ndikimin njerëzor në natyrë.	11. Arti, kultura dhe natyra	1 orë	- Mësimdhënie dhe mësimnxënie me nxënësin në qendër dhe gjithëpërfshirja	Vlerësimi në punë grupore	Çështjet ndërkurrikulare: Edukimi për qytetari demokratike	Materiale nga interneti
	- Analizon dokumentarë dhe burime të ndryshme për ndikimin e njeriut në natyrë.	12. Ndikimi i njeriut në natyrë	1 orë	- Mësimdhënie që nxit të menduarit kritik	Vlerësimi i detyrave të shpësisë		Revista
	- Shpjegon evoluimin dhe funksionimin e rregullave, normave dhe ligjeve shoqërore dikur dhe sot.	13. Përsëritje (Ndërlidhja reciproke ndërmjet natyrës dhe shoqërisë)	1 orë	- Diskutimi dhe të nxënë në bashkëpunim	Vlerësim me shkrim test - ese		Tekste nga fusha të tjera.
	- Krahason traditat, zakonet dhe adetet e pashkruara që praktikohen ose janë praktikuar dikur në familje ose komunitet, si: besa, miqpritja, fejesa dhe martesat, lojërat tradicionale, festat popullore etj., me rregullat, normat dhe ligjet e shkruara që praktikohen në shoqëri dhe institucione publike, si: shkollë, teatër, spital, polici, organe të pushtetit, organizata shoqërore etj.	14. Krijimi dhe funksioni i rregullave dhe normave	1 orë				Slide/materiale të krijuara nga mësimdhënësit
		15. Rregullat e shkruara dhe ato të pashkruara	1 orë				
		16. Përsëritje (Rregullat, normat dhe ligjet)	1 orë				
		17. Vlerësim me shkrim - ese (periudha I)	1 orë				
			9 orë				

PLANI TREMUJOR: JANAR—SHKURT—MARS

Lënda mësimore: Edukatë qytetare

Fusha e kurrikulës: Shoqëria dhe mjedisi

Klasa: VII

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohet të arrihen përmes shtjellimit të temës/temave:

I.IV	IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis – Kontribues produktiv IV. 1, 2, 3, 4, 7
I.V	V. Kompetenca personale – Individ i shëndoshë V. 5, 6, 8

RNF: 3. Analizon dhe shqyrton në mënyrë kritike dhe zbaton normat e rregullat shoqërore për jetë të përbashkët në diversitet

III.1	Kupton dhe analizon shkaqet dhe rrethanat e ndryshimit të normave, ligjeve dhe zakoneve për rregullimin e jetës shoqërore në kohë dhe vende të ndryshme.
III.2	Kupton dhe vlerëson llojllojshmërinë e kulturave, traditave, bashkësive të ndryshme dhe tregon tolerancë dhe respekt për to.

RNF: 4. Jep ide dhe propozime si dhe merr vendime në mënyrë të vetëdijshme dhe të përgjegjshme

IV.1	Vlerëson ndikimin e vendimmarrjes individuale, grupore e institucionale në kohë dhe vende të ndryshme, krijon qëndrime personale për to dhe i përdor në jetën e tij të përditshme.
IV.2	Tregon kujdes, respekt e përgjegjshmëri për vendimmarrjen e drejtë në aktivitetet ku është i përfshirë (në shkollë, bashkësi dhe më gjerë).

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënimit për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e Vlerësimit	Ndërlidhja me lëndët e tjera, me ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet
Vlerat shoqërore, humane dhe qytetare Pjesëmarrja në vendimmarrje institucionale	- Shpjegon rëndësinë e respektimit të vlerave humane për funksionimin e një shoqërie të qëndrueshme, si p.sh. paqja, liria, barazia, respektimi i drejtave të njeriut, solidariteti, toleranca, bëmërisia, vullnetarizimi, falja, pajtimi, ndihma, empatia, shpëtimi etj. dhe i praktikon këto në jetën e përditshme.	18. Vlerat shoqërore: paqja, liria, barazia, demokracia 19. Vlerat humane dhe qytetare: humanizmi, solidariteti, toleranca 20. Vlerat humane: vullnetarizimi, falja dhe pajtimi	1 orë 1 orë 1 orë	- Mësimdhënie dhe nxënie të bazuar në qasjen e integruar - Mësimdhënie dhe mësimnxënie me nxënësin në qendër dhe gjithpërfshirja - Mësimdhënie që nxit të menduarit kritik	Vlerësimi për të nxënë - i vazhdueshëm Vlerësimi i bazuar në kriter Vlerësimi në punë grupe Vlerësimi i detyrave të shiëpisë	Ndërlidhja me lëndë të tjera mësimore: Histori Gjeografi Çështjet ndërkurrikulare: Edukimi për qytetari demokratike Edukimi për paqe	Libri i ed. qytetare (<i>Dukagjini</i> 2020) Shemsi Krasniqi, Sheribane Ibrahimaj- Bahtiri Materiale nga interneti Revista Tekste nga fusha të tjera Slide/materiale të krijuara nga mësimdhënësit
	- Shpjegon rëndësinë e raportimit të veprimeve që janë në kundërshtim me vlerat e shoqërisë demokratike, si: paragjykimet racore ose etnike, diskriminimin gjinor, jotolerancën fetare, përjashtimin social, ekstremizmin, radikalizmin, korrupsionin etj., te personat dhe institucionet përgjegjëse.	21. Përsëritje Vlerat shoqërore dhe humane	1 orë	- Diskutimi dhe të nxënë në bashkëpunim	Vlerësimi i portfolios - Projektprezantime		
	- Shpjegon rëndësinë e raportimit të veprimeve të dhunshme dhe aktivitetëve të paligjshme, si: trafikimi i lëndëve narkotike, armëve, qenieve njerëzore, detyrimit për punë të rënda, trajtimit johuman të të pambrojturve dhe viktimave të trafikimit te personat dhe institucionet përgjegjëse.	22. Dukuritë e dëmshme: paragjykim, diskriminimi dhe përjashtimi social 23. Dukuritë e dëmshme dhe të rrezikshme: ekstremizmi dhe terrorizmi 24. Dukuritë e dëmshme: korrupsioni 25. Përsëritje (Dukuritë e dëmshme) 26. Përgjegjësitë dhe vendimmarrja (në nivelin lokal dhe atë qendror)	1 orë 1 orë 1 orë 1 orë				

	<ul style="list-style-type: none"> - Shpjegon rëndësinë e përfitimit të shoqërisë nga trajtimi i barabartë i të gjithë qytetarëve pa dallim përkatësie gjinore, moshë, sociale, etnike, fetare, racore etj., duke u bazuar në dokumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. - Dallon rolin institucioneve lokale dhe atyre qendrore në vendimmarrje për rregullimin e jetës së qytetarëve në nivel lokal dhe shtetëror 	27. Projektprezantime	1 orë				
			10 orë				

PLANI TREMUJOR: PRILL—MAJ—QERSHOR

Lënda mësimore: Edukatë qytetare

Fusha e kurrikulës: Shoqëria dhe mjedisi

Klasa: VII

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohet të arrihen përmes shtjellimit të temës/temave:

I.V	Kompetenca personale – Individ i shëndoshë V. 5, 6, 8
I.VI	Kompetenca qytetare – Qytetar i përgjegjshëm VI. 1, 2, 4, 7

Rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohet të arrihen përmes shtjellimit të temës/temave:

RNF: 4. Jep ide dhe propozime, si dhe merr vendime në mënyrë të vetëdijshme dhe të përgjegjshme.

IV.1	Vlerëson ndikimin e vendimmarrjes individuale, grupe e institucionale në kohë dhe vende të ndryshme, krijon qëndrime personale për to dhe i përdor në jetën e tij të përditshme.
IV.2	Tregon kujdes, respekt e përgjegjshmëri për vendimmarrjen e drejtë në aktivitetet ku është i përfshirë (në shkollë, bashkësi dhe më gjerë).

RNF: 5. I kontribuon ruajtjes dhe mbrojtjes së mjedisit si dhe zhvillimit të qëndrueshëm.

V.1	Inicion aktivitete konkrete grupe me qëllim të ngritjes së vetëdijes së bashkësisë për ruajtjen dhe zhvillimin e mjedisit jetësor.
V.1	Vlerëson dhe vepron sipas parimeve bazë të zhvillimit të qëndrueshëm.

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënit për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e Vlerësimit	Ndërlidhja me lëndët e tjera, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet
Pjesëmarrja në vendimmarrje institucionale	- Shpjegon se si secili qytetar i moshës madhore mund të bëhet pjesë e institucioneve vendimmarrëse të nivelit lokal dhe qendror.	28. Vendimmarrja në shkollë dhe për shkollën	1 orë	- Mësimdhënie dhe mësimnxënie të bazuar në qasjen e integruar	Vlerësimi për të nxënë - i vazhdueshëm	Ndërlidhja me lëndë të tjera mësimore: Histori	Libri i ed. qytetare (<i>Dukagjini</i> , 2020)
Mjedesi dhe mirëqenia	- Demonstron njohuri dhe shkathësi për pjesëmarrje në vendimmarrje në nivel, klase, shkollë apo komuniteti që kanë të bëjnë me interesat e bashkëmoshatarëve.	29. Shoqëria civile dhe aktivizimi qytetar	1 orë	- Mësimdhënie dhe mësimnxënie të diferencuar	Vlerësimi i bazuar në kritere	Gjeografi	Shemsi Krasniqi, Sheribane Ibrahimaj-Bahtiri
	- Analizën vendimet që merren nga grupe, organe dhe institucione të ndryshme që janë me interes për të dhe bashkëmoshatarët p.sh. për sjelljet, vlerësimin e arritjeve, përfshirjen ose mospërfshirjen në aktivitetet shkollore dhe jashtë saj etj.	30. Përfshirja në vendimmarrje	1 orë	- Mësimdhënie dhe mësimnxënie me nxënësim në qendër dhe gjithëpërfshirja	Vlerësimi në punë grupore	Çështjet ndërkurrikulare: Edukimi për qytetari demokratike	Materiale nga interneti
	- Identifikon dhe respekton vendimet që dalin nga institucionet shkollore, lokale dhe qendrore që janë me interes për të, shoqëritë dhe mjedisin (p.sh., vendimet e këshillave të ndryshëm që funksionojnë në shkollë, në lagje, dhe nivel vendi)	31. Përsëritje (Përfshirja në vendimmarrje)	1 orë	- Mësimdhënie që nxit të menduarit kritik	Vlerësimi i portfolios - Projektprezantime		Revista
	- Vlerëson rolin e shoqërisë civile, medieve dhe grupeve të ndryshme (OJQ-ve, shoqatave, forumeve, medieve të shtypura	32. Objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm	1 orë	- Diskutimi dhe të nxënë në bashkëpunim	Vlerësim me shkrim - ese		Tekste nga fusha të tjera
		33. Ekoqytetaria	1 orë				Slide/materiale të krijuara nga mësimdhënësit
		34. Trajtimi human i kafshëve	1 orë				
		35. Aktivitet për shënimin e festave mjedisore	1 orë				
		36. Vlerësim me shkrim - ese (Periudha - II)	1 orë				

	<p>dhe elektronike, grupeve të ndryshme në rrjetet sociale etj.), në interes të përmirësimit cilësorë së jetës dhe për nxitjen e qytetarëve për të reaguar ndaj padrejtësi të ndryshme dhe për të dhënë ide dhe propozime konkrete.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Prezanton aktivitetet që zhvillohen në shkollë, komunitet dhe më gjerë, për çështje mjedisore (p.sh. iniciativat e nxënësve, klubeve në shkollë, prindërve, qytetarëve dhe OJQ-ve që veprojnë në komunitet). - Shpjegon rëndësinë dhe demonstroi shkathhtësitë e kursimit të ujit, energjisë, ruajtjes së gjelbërimit, riciklimit të mbeturinave, kultivimit të bimëve, mbrojtjes së kafshëve, në aspektin dhe funksionin e mirëqenies ekonomike, shëndetësore dhe sociale. - Identifikon dhe analizon masat mbrojtëse të organizatave dhe institucioneve përkatëse për mjedisin që veprojnë në komunë dhe në nivel vendi, si: parandalimi i ndotjes së ujit, ajrit, tokës, pastaj kufizimin e gjuetisë, keqtrajtimit e kafshëve etj. - Bashkëpunon me të tjerët, organizata apo institucione përkatëse për realizimin e aktiviteteve të ndryshme lidhur me shënimin e festave mjedisore, si: Dita Botërore e Mjedisit Dita e Tokës, Dita e Ujit, Dita e Biodiversitetit etj. 				
		9 orë			

Mësimi 1

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi
Lënda: Edukatë qytetare
Shkalla e kurrikulës: 3 **Klasa:** VII
Tema: Raportet shoqërore, sjelljet dhe shprehitë

Rezultatet e të nxënit të temës:

Dallon llojet e ndryshme të raporteve shoqërore (miqësore, bashkëpunuese, afruese, integruese, si dhe ato jomiqësore, larguese, përjashtuese, diskriminuese) dhe lidhjet e tyre me sjelljet personale dhe kolektive.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3,7; IV.1, 5, 6, 7; V.3, 4, 5; VI.1, 3, 4, 5, 6.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Ndërveprimet në jetën e përditshme

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Identifikon parakushtet e lidhjeve reciproke mes njerëzve;
- Kupton rëndësinë që ka puna e përbashkët dhe ndërldhjet reciproke;
- Vlerëson sjelljet korrekte dhe kulturën e mirë të komunikimit.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fletë A4, foto.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë shqipe, Histori, Gjeografi.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:
Përgatitja për të nxënë
Stuhi mendimesh

Fillon ora me pyetje që shtrohen për diskutim:
Pse janë të rëndësishme sjelljet e mira dhe kultura e mirë e komunikimit?



RAPORTET SHOQËRORE, SJELLJET DHE SHPREHITË

NDËRVEPRIMET NË JETËN E PËRDITSHME

Mësimi 1

Fjalët kyçe: Ndërveprim, komunikim, bashkëjetesë, solidaritet, kulturë, qytetërim.

Në jetën e përditshme, njerëzit krijojnë raporte dhe lidhje të ndërsjella, ndikime dhe varësi ndaj njëri-tjetrit, varësisht prej rrethanave shoqërore dhe vendit ku jetojnë.

Nevojat dhe interesat e përbashkët jetësorë, nevoja për t'u shoqëruar me njëri-tjetrin, ndihma dhe mbështetja reciproke, dashuria, solidariteti, puna dhe argetimi, vlerat, normat dhe shprehitë e përbashkëta janë parakushtet për lidhje ndërmjet njerëzve dhe, njëherësh, ndërtojnë bashkësitë shoqërore në të cilat jetojnë. Këto bashkësi mund të jenë grupe të vogla ose të mëdha, fshatra ose qytete, shtete dhe kombe, kultura dhe qytetërimet që ndërldihen e ndërveprojnë reciprokisht në kuadër të një bashkësie edhe më të gjerë siç është njerëzimi.

Në kohën tonë, çdo ditë e më shumë po krijohet "varësi" ndaj njëri-tjetrit, si në punë, lojë, hulumtim, ekspeditë etj. Kjo do të thotë se pa ndërvepruar me të tjerët nuk mund të zhvillohet njeriu si qenie shoqërore, nuk mund të krijohen marrëdhëniet e punës, as të zhvillohet ekonomia e vendit, as të krijohen veprat e artit dhe të kulturës, sikurse as që mund të zhvillohen lojërat sportive apo të zhvillohen aktivitetet e ndryshme argëtuese. Pra, duke jetuar së bashku dhe duke ndërvepruar në jetën e përditshme, njerëzit mesojnë për kulturën e pranimit, të komunikimit

7

dhe të bashkëjetesës, si në vendin e punës, në shkollë, në fushëlojë, teatër, kinema, ekskursion, punimin e ndonjë projekti a hulumtimi etj. Shpeshherë ndodh që në këto bashkëpunime të ketë edhe mospajtime, mos-



përputhje idesh, argumentesh e pikëpamjesh përgjatë diskutimeve, që janë krejtësisht normale. Ritmi, niveli dhe natyra e zhvillimit të dinamikave në fushën e teknologjisë së komunikimit, të kulturës, të artit etj., pastaj edhe globalizimi i jetës, kanë mundësuar që njerëzit të kenë burime të shumta dijesh dhe informacionesh, por edhe dëshirash, interesash dhe përvojash të ndryshme, gjë që reflektohet në dallime dhe mospërputhje idesh e qëndrimesh. Në botën bashkëkohore zhvillohen diskutime publike dhe dialogohen dallimet në qëndrime duke i respektuar parimet dhe të drejtat e secilit individ në shprehjen e lirë të fjalës dhe të mendimeve, si dhe të drejtat e veprimit sipas interesit dhe vullnetit të vet. Prandaj, për të pasur ndërveprime e raporte të mira shoqërore mes njerëzve, janë të domosdoshme kultura e komunikimit dhe sjelljet korrekte. E si rrjedhojë shmangen përjashtimi, mospranimi, injorimi, diskriminimi dhe mosrespektimi i tjetrit. Secili, që nga fëmijëria, duhet të mësohet të jetojë në diversitet kulturash dhe përkatësish të ndryshme. Të gjithë njerëzit, pa marrë parasysh përkatësitë, janë të lidhur dhe të varur nga njëri-tjetri.



PYETJE:

1. Përzgjidh dhe analizo disa parakushte të lidhjeve reciproke mes njerëzve.
2. Vlerëso rëndësinë e jetës së përbashkët për forcimin e ndërlidhjeve reciproke.
3. Shqyrto pse janë të nevojshme sjelljet korrekte dhe kultura e mirë e komunikimit.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen përmes pyetjeve dhe diskutimit, angazhimit individual dhe në grup, informatë kthyesë.

Detyrë:

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Diskutohen mendimet e nxënësve.



Pjesa e dytë (Ndërtimi i njohurive):

Leximi i materialeve dhe parashtrimi i pyetjeve:

- Cilat janë parakushtet e lidhjes reciproke mes njerëzve?
- Çfarë rëndësie ka puna e përbashkët dhe lidhjet reciproke?
- Pse janë të nevojshme sjelljet korrekte dhe kultura e mirë e komunikimit?



Përforcimi:

Konsolidimi i të nxëniti:

Pesëvargëshi

Udhëzohen nxënësit që të shkruajnë pesëvargësh me temën “Shoqëria”.

Shoqëria
e rëndësishme e nevojshme
mëson ndihmon argëton
Shoqëria është më e rëndësishme se çdo gjë tjetër.
Besimi

Mësimi 2

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi
Lënda: Edukatë qytetare
Shkalla e kurrikulës: 3 **Klasa:** VII
Tema: Raportet shoqërore, sjelljet dhe shprehitë

Rezultatet e të nxënit të temës:
Përshkruan ndjenjën e ngrohtësisë dhe sigurisë që e ndien në shtëpi dhe në shkollë, duke qenë i rrethuar me njerëz të afërt dhe dashamirës.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: 1.3, 4, 8; IV.1, 4, 6, 7; V.3, 4; VI.1, 2, 3, 5, 6.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Sjelljet dhe shprehitë njerëzore


Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Identifikon faktorët ndikues të formimit të sjelljeve dhe shprehive të mira;
- Tregon se si formohen sjelljet dhe shprehitë e mira;
- Analizon rrethanat që ndikojnë në sjelljet e mira për krijimin e favoreve për të gjithë.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fletë A4, fotografi, burime nga interneti.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Histori, Edukimi për qytetari demokratike.



SJELLJET DHE SHPREHITË NJERËZORE

Mësimi 2.

Fjalët kyçe: Sjellje, shprehje, edukata, vlerë, media, rrethet, raporte shoqërore.

Njeriu nuk lind me shprehje të gatshme, por ato i krijon gjatë jetës. Shkenca e gjenetikës shpjegon se disa tipare fizike dhe mendore, të dukshme dhe të padukshme, mund të trashëgohen nga prindërit të fëmijët, por sjelljet dhe shprehitë krijohen nga edukata dhe përvojat jetësore. Meqenëse fëmijët pjesën më të madhe të kohës e kalojnë me prindërit ose kujdestarët e tyre, atëherë mund të themi se edukata që marrin nga ta ka ndikim domethënës në formimin e sjelljeve dhe shprehive.

Kur për dikë themi "ka edukatë familjare", nënkuptojmë se edukata familjare pasqyrohet në sjelljet e fëmijëve, rrjedhimisht, familja ka përdorime formimin e sjelljeve dhe të shprehive të mira të fëmijët. Përpjekjet e familjarëve ose kujdestarëve për edukimin e fëmijëve të tyre, nuk bëhen gjithmonë vetëm me biseda, këshilla ose "ligjerata" verbale. Veprimet e tyre, si dhe mënyra se si sillen ata vetë me të tjerët, ndikojnë në edukimin e fëmijëve. Përveç nga familja, fëmijët mësojnë dhe përvetësojnë modele të sjelljes dhe nga mjedisi shoqëror ku jetojnë, nga bashkëmoshatarët, shkolla, televizioni, interneti, mediet sociale e të tjera.

Njeriu është qenie shoqërore, prandaj ka nevojë për të tjerët. Planimi dhe bashkëpunimi ynë me rrethin shoqëror arrihet më lehtë nëse jemi të edukuar të silleni mirë, nëse tashmë kemi krijuar sjellje dhe shprehje të mira ndaj njerëzve në komunitetin ku jetojmë. Për shembull, nëse dikush i pengon të tjerët duke folur

9

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:
Përgatitja për të nxënësit
Shqyrtim i përbashkët

Ora fillon duke kërkuar nga nxënësit të tregojnë se çfarë shprehje të mira dhe jo të mira kanë. Pasi të kemi marrë të gjitha mendimet e tyre, përcaktojmë qëllimin e mësimin se sa të rëndësishme janë sjelljet dhe shprehitë e mira.

me zë të lartë; nëse dikush gjatë lojës lëndon dikë me qëllim; nëse dikush bën zhurmë në klasë dhe pengon nxënësit e tjerë etj., shpërfaq shprehitë dhe sjelljet e këqija, përkatësisht mungesën e edukatës.

Sjelljet dhe shprehitë e mira të fëmijëve ndihmojnë që ata të pajisen me vlera, me të cilat bëhen të dobishëm jo vetëm për veten, por edhe për shoqërinë. Si përfundim mund të themi që shprehjet e mira të fëmijëve formojnë themelet e një shoqërie të përkushtuar ndaj vlerave. Pra, kur ju tregoheni bashkëpunues, kur ju tregoheni tolerantë ndaj kulturave të ndryshme apo kur ju kujdeseni për kafshët dhe natyrën, atëherë ju keni krijuar një mjedis të përshtatshëm për të gjithë. Duke i edukuar fëmijet, gjegjësisht duke u ndihmuar të krijojnë shprehje të sjelljeve të mira, ne kontribuojmë në formimin e një shoqërie të zhvilluar e mirëdashëse.



PYETJE:

1. Vlerëso rolin e edukatës familjare në formimin e sjelljeve dhe shprehive të mira.
2. Përzgjidh dhe analizo disa faktorë që ndikojnë në formimin e sjelljeve dhe shprehive të mira.
3. Dëshmo rolin e sjelljeve të mira në formimin e një shoqërie të zhvilluar e mirëdashëse.

10



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes

Nxënësit udhëzohen që të lexojnë materialin.

Diskutohet për rëndësinë e sjelljeve dhe shprehive të mira.

Parashtohen pyetje për diskutim.

- Cilët janë faktorët ndikues për formimin e sjelljeve dhe shprehive të mira?
- Si formohen sjelljet dhe shprehitë e mira?
- Përse nevojiten sjelljet dhe shprehitë e mira?



Përforcimi: Konsolidim dhe zbatim i të nxënit Shkrim i lirë

Nxënësit udhëzohen të shkruajnë një shkrim të lirë për sjelljet dhe shprehitë njerëzore.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësim përmes pyetjeve dhe diskutimit, angazhimit individual dhe në grup, informatë kthyesë.

Detyrë:

Të plotësojë në fletoren e punës ushtrimet për këtë njësi.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 3

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi
Lënda: Edukatë qytetare
Shkalla e kurrikulës: 3 **Klasa:** VII
Tema: Raportet shoqërore, sjelljet dhe shprehjet

Rezultatet e të nxënit të temës:

Klasifikon dhe përshkruan rolin e grupeve, organizatave të ndryshme të shoqërisë civile, si dhe të institucioneve që veprojnë në fusha të ndryshme, si: mjedisi, arsimi, kultura, shërbimet publike etj.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3, 4, 8; IV.1, 4, 5, 7; V.3, 4; VI.1, 3, 4, 5, 7.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Kompetencat e institucioneve dhe roli i organizatave joqeveritare (OJQ)

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Dallon rolin dhe kompetencat e institucioneve qendrore;
- Identifikon disa prej llojeve të institucioneve shoqërore;
- Vlerëson rëndësinë dhe rolin e shoqërisë civile ose organizatave joqeveritare.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fletë A4, foto, burime nga interneti.


Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Histori, Gjuhë shqipe.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:
Përgatitja për të nxënësit
Stuhi mendimesh

Ora mësimore fillon duke kërkuar nga nxënësit që të plotësojnë Pemën e mendimeve.



KOMPETENCAT E INSTITUCIONEVE DHE ROLI I ORGANIZATAVE JOQEVERITARE (OJQ)

Fjalët kyçe: Kompetencë, institucioni, kuvendi, agjencia, pushtet ekzekutiv, pushtet legjislativ.

Shoqëritë njerezore nuk mund të funksionojnë pa rend, norma dhe rregulla. Terësia e tyre e përbën atë që mund të quhet **sistem shoqëror**. Prandaj, është jetike për shoqëritë njerezore që sistemet që e rregullojnë jetën e tyre të jenë sa më funksionale. Kjo nënkupton funksionimin e të gjitha institucioneve shoqërore sipas niveleve të pushtetit dhe të fushave të veprimtarisë. Institucionet e nivelit qendror ushtrojnë kompetencat për të rregulluar çështje në nivel shteti, kurse ato të nivelit komunal ushtrojnë kompetencat e nivelit lokal. Qeveria me trupat dhe organet e saj, ministrat, agjencitë e ndryshme dhe institutet, janë institucione të nivelit qendror dhe ushtrojnë kompetenca që kanë të bëjnë me rregullimin e jetës nëpër fusha të ndryshme (ekonomi, drejtësi, arsiri, kulturë, mjedis, siguri, financa, marrëdhënie me jashtë etj.).

Institucionet kryesore të shtetit - Kuvendi, Qeveria dhe institucionet e drejtësisë kanë kompetenca të ndara. Miratimi dhe aprovimi i ligjeve janë kompetenca të Kuvendit që ndryshe quhet **pushtet legjislativ**. Për zbatimin e ligjeve është përgjegjëse Qeveria ose pushteti ekzekutiv. Kuvendi mund të bëjë edhe propozime për ligje të caktuara përmes procedurës së "nismës ligjore". Me procedurë të veçantë, propozimet për ligje mund të vijnë edhe nga qytetarët dhe grupet e ndryshme të interesit. Por, rëndom, Qeveria çdo vit del me agjendë legjislativë, në të cilën janë të listuara projektligjet e propozuara për vitin përkatës kalendrik. Sa më cilësore të jenë ligjet dhe sa më shumë që zbatohen ato nga Qeveria dhe nga organet përkatëse në përgjithësi, shoqëria funksionon më mirë dhe, kështu, njerëzit jetojnë më mirë. Institucionet e drejtësisë garantojnë zbatimin e ligjit nga të gjithë: Qeveria, qytetarët dhe organet e tjera shtetërore, si dhe kujdesen që të respektohen të drejtat dhe liritë e secilit/secilës. Përveç kësaj, ato shërbejnë si arbitër institucional i zgjidhjes së mosmarrëveshjeve të ndryshme ndërmjet qytetarëve, duke garantuar barazi dhe siguri ligjore për të gjithë. Organet e drejtësisë duhet të jenë të pavarura dhe jo të ndikuar nga politikat shtetërore, interesat partiakë ose ata personale. Ato duhet të veprojnë vetëm në bazë të së vërtetës, të ligjeve në fuqi dhe të Kushtetutës, si akti më i lartë juridik i shtetit. Pra, institucionet kanë kompetencat për të ofruar shërbime sipas fushave të tyre përkatëse. Kështu, institucionet shkollore (çerdhjet, shkollat, universitetet) ofrojnë shërbime arsimore; institucionet shëndetësore (ambulancat, klinikat, spitalet) ofrojnë shërbime shëndetësore; institucionet e rendit (policia) ofrojnë shërbime

11

që kanë të bëjnë me ruajtjen e rendit publik dhe ofrimin e sigurisë për qytetarët; institucionet kulturore (bibliotekat, teatri, opera, baleti, kinematografia) ofrojnë shërbime që kanë të bëjnë me kulturën dhe artin; bankat ofrojnë shërbime financiare; mediet ofrojnë shërbime që kanë të bëjnë me informimin e qytetarëve etj.


Krahas institucioneve publike që merren me shërbime të ndryshme, në shoqërinë demokratike veprojnë edhe organizatat joqeveritare (OJQ). Në vitet e para të pasluftës në Kosovë patën vepruar qindra organizata humanitare që patën punuar për të siguruar mirëqenien e popullsisë së dalë nga lufta. Po atëherë, në Kosovë, u formuan shumë organizata joqeveritare që punojnë edhe sot për të përmirësuar demokracizimin e shoqërisë. Te gjitha klubet, shoqatat dhe organizatat joqeveritare (OJQ) përbëjnë atë që quhet **shoqëri civile**. Ato janë joprofitabile dhe qëllimi i tyre është zhvillimi i demokracisë, promovimi i vlerave të qytetarisë, luftimi i korrupsionit, ruajtja e paqes, promovimi i barazisë gjinore, respektimi i të drejtave të komunitetit, ruajtja e injedisit dhe respektimi i të drejtave të njeriut etj. Për t'i realizuar këto qëllime, ato bashkëpunojnë dhe veprojnë si rrjete apo koalicione. Rrjetëzimi i shoqërisë civile e bën atë më të fuqishme në shoqëri.



Përpos nismave vullnetare, kryesisht aktorët e shoqërisë civile, OJQ-të, institutet, shoqatat, *think-tank*-et etj., funksionojnë përmes projekteve. Ato hartojnë projekte konform misionit dhe fushëveprimtarisë së tyre të definuar me statutin e organizatës dhe më pas kërkojnë mbështetje financiare për zbatimin e tyre. Donatorët që ofrojnë këtë mbështetje mund të jenë institucionet shtetërore të vendit, organizata nderkombëtare, fondacione të ndryshme etj. Në njëfarë mënyre, shoqëria civile e ndihmon qeverisjen e vendit, sepse, përmes presionit publik, nuk e lejon qeverinë të gabojë. Për t'i arritur qëllimet e saj, ajo përdor forma të ndryshme, nga debatet publike nëpër tryeza diskutimi, seminarë, konferenca e medie, fushatat e ndryshme për vetëdijësim qytetar e deri te peticionet, protestat paqësore, grevat etj.

PYETJE
 1. Përzgjidh dhe analizo disa nga kompetencat e institucioneve qendrore.
 2. Identifiko disa lloje të institucioneve shoqërore.
 3. Vlerëso rolin e shoqërisë civile ose organizatave joqeveritare

12



**Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:
 Përpunimi i përmbajtjes
 Lexim i drejtuar**

Nxënësit udhëzohen që të lexojnë pjesën e parë të materialit.

Parashtrihen pyetje për pjesën e parë, si:

- Cilat janë kompetencat e institucioneve qendrore?
- Cilat janë llojet e institucioneve shoqërore?


Pastaj vazhdohet me leximin e pjesës së dytë.

- Çka janë organizatat joqeveritare (OJQ)?
- Cili është roli i organizatave joqeveritare?



**Përforcimi:
 Konsolidim dhe zbatimi i të nxënët
 Shkrim i shpejtë**

Udhëzohen nxënësit që në grupe ta plotësojnë Diagramin e Venit, duke shënuar të veçantat dhe të përbashkëtat e institucioneve dhe të OJQ-ve.



Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen përmes pyetjeve dhe diskutimit, angazhimit individual dhe në grup, informatë kthyesë.

Detyrë:

Të plotësojë në fletoren e punës ushtrimet për këtë njësi.

● *Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

Mësimi 4

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi
Lënda: Edukatë qytetare
Shkalla e kurrikulës: 3 **Klasa:** VII
Tema: Raportet shoqërore, sjelljet dhe shprehitë

Rezultatet e të nxënës të temës:

Përshkruan dhe krahason funksionin dhe kompetencat e institucioneve të Kosovës në nivelin lokal dhe atë qendror, që u shërbejnë qytetarëve, si p.sh.: arsim, shëndetësi, mjedis, punësim, drejtësi, infrastrukturë, kulturë, zhvillim ekonomik, siguri, mbrojtje, trafikimit, dhunës, ngacmimit etj.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkollës:

I.3, 4, 7; IV.1, 4, 6, 7; V.3, 4; VI.1, 2, 3, 4, 6, 7.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Përgjegjësitë e pushtetit lokal dhe të atij qendror

Rezultatet e të nxënës të orës mësimore:

- Dallon kompetencat dhe përgjegjësitë e nivelit lokal dhe atij qendror;
- Identifikon disa prej shërbimeve që komuna duhet t'ua plotësojë qytetarëve;
- Njeh tri llojet e pushtetit, që njëherësh konsiderohen shtylla të shtetit.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fletë A4, fotografi, burime nga interneti.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Histori, Gjuhë shqipe.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënësit

Bashkëbisedimi

Nxënësit ftohen ta lexojnë pjesën e parë të mësimin dhe të diskutojnë rreth tij. Nga ky diskutim nxirren në pah përgjegjësitë e pushtetit lokal dhe qendror.

PËRGJEGJËSITË E PUSHTETIT LOKAL DHE TË ATIJ QENDROR

Fjalët kyçe: Pushtet qendror, pushtet lokal, Kushtetuta, organe qytetare, demokraci.

Pushteti në Kosovë funksionon në dy nivele: në nivelin lokal dhe në atë qendror. Niveli lokal përfshin komunën ose qytetin e caktuar me gjithë fshatrat përreth. Komuna është njësi territoriale dhe institucioni kryesor lokal që merret me shërbime për qytetarët e saj.

Komuna, nëpërmjet drejtorive komunale, ushtron pushtetin lokal në tërë territorin e vet. Kuvendi komunal përbëhet nga këshilltarët, përkatësisht asambleistët, të cilët zgjidhen nga qytetarët përmes votimit në zgjedhjet lokale. Ata kanë përgjegjësi të angazhohen për plotësimin e kërkesave dhe përfaqësimin e interesave të qytetarëve të komunës përkatëse.



Drejtorët e drejtorive bashkëpunojnë me kryetarin e komunës dhe janë urë lidhëse midis kryetarit, këshilltarëve (asambleistëve) dhe qytetarëve. Sa më shumë transparente dhe syçele të jenë dhe sa më shumë që bashkëpunojnë me qytetarët, aq më e lehtë bëhet zgjidhja e problemeve. Prandaj, për qeverisjen komunale është me rëndësi kontakti i drejtpërdrejtë me qytetarët, në mënyrë që të kuptohen sa më mirë kërkesat e tyre dhe që të gjenden mundësitë për plotësimin e tyre.

Drejtoritë komunale, duke zbatuar ligjin për komunat, janë përgjegjëse për kryerjen e shërbimeve në këto fusha: dokumentet civile, arsimi, kultura, infrastruktura, furnizimi me ujë, dhënia e lejeve për ndërtim, menaxhimi i mbeturinave, shëndetësia, administrata publike, imbledhja e tatimeve, mirëqenia për të varfrit, shërbimet kadastrale dhe prona, inspeksionet, zhvillimi ekonomik, bujqësia dhe zhvillimi rural dhe shumë shërbime të tjera publike. Pra, çdo gjë lidhet me shërbimin ndaj qytetarëve, të cilët përmes votës kanë përzgjedhur asambleistët. Prandaj, asambleistët duhet të jenë të përgjegjshëm dhe besnikë ndaj votuesve të tyre.

Qytetarët e komunës nuk duhet të qendrojnë vetëm si spektatorë përballë problemeve me të cilat ballafaqohen. Ata duhet t'i shtojnë kërkesat e tyre, t'i debatojnë së bashku me kryetarin e komunës në takimet publike dhe, nëse nuk merren parasysh, atëherë, në shenjë pakënaqësie, mund t'i përdorin formtat e reagimit qytetar në mënyrë paqësore, të kulturuar dhe të civilizuar.



Edhe këtu ndikim të rëndësishëm mund të ketë shoqëria civile duke luajtur rolin e artikulesit të interesit qytetar dhe mobilizuesit të reagimit. Në anën tjetër, pushteti qendror, përkatësisht qeverisja qendrore, vepron në nivelin shtetëror. Kjo do të thotë se vendimet e saj vlejnë për tërë territorin e vendit, e jo vetëm për një komunë ose lokalitet të caktuar. Pushtetin qendror e përbëjnë Kuvendi ose Parlamenti, që ndryshe quhet legjislativi, Qeveria dhe ministratë e saj, që ndryshe quhet ekzekutivi, si dhe organet e drejtësisë ose gjyqësori. Pushteti legjislativ është përgjegjës për miratimin e ligjeve në pajtim me Kushtetutën, pushteti ekzekutiv është përgjegjës për zbatimin e ligjeve dhe të Kushtetutës, ndër-



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes Tryeza rrethore

Klasa ndahet në dy grupe të mëdha:
Grupi 1. Përgjegjësitë e pushtetit lokal
Grupi 2. Përgjegjësitë e pushtetit qendror

Fillimisht secilit grup u jepet kohë të njihet me informacionin e tekstit.


Më pas u kërkohet:
Grupi 1. Të evidentojë disa përgjegjësi të pushtetit lokal.
Grupi 2. Të evidentojë disa përgjegjësi të pushtetit qendror.

Përfaqësuesit e grupeve japin përgjigjet e pyetjeve dhe diskutohet rreth tyre.



Përforcimi: Konsolidim dhe zbatim i të nxënët Diagrami i Venit

Udhëzohen nxënësit që ta plotësojnë Diagramin e Venit, duke shënuar të veçantat dhe të përbashkëtat e nivelit lokal dhe të atij qendror.



Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen përmes pyetjeve dhe diskutimit, angazhimit individual dhe në grup, informatë kthjese.

Detyrë:

Të plotësojë në fletoren e punës ushtrimet për këtë njësi.

● *Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

Mësimi 5

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi
Lënda: Edukatë qytetare
Shkalla e kurrikulës: 3 **Klasa:** VII
Tema: Raportet shoqërore, sjelljet dhe shprehitë

Rezultatet e të nxënit të temës:

Analizon rolin e personaliteteve të shquara historikisht në nivel kombi dhe më gjerë dhe ndikimin e tyre në themelimin e institucioneve shtetërore, ligjvënëse, ekzekutive dhe gjyqësore, organizative, shoqatave humanitare etj.

Kontributi në rezultatet për kompetencat

kryesore të shkallës: I.3, 4, 7, 8; IV.1, 4, 6; V.3, 4; VI.1, 2, 3, 4, 5, 7.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Roli shoqëror i personaliteteve të rëndësishme

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Tregon me çka është i njohur Adem Demaçi;
- Çmon kontributin e Anton Çetës;
- Vlerëson luftën e UÇK-së.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fletë A4, fotografi, burime nga interneti.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë shqipe, Histori.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS




Parashikimi:

Përgatitja për të nxënësit

Bashkëbisedim

Fillon ora mësimore duke bashkëbiseduar me nxënësit për personalitetet e rëndësishme.

Më pas përcaktohet edhe qëllimi i mësimi "Të mësojmë për rolin shoqëror të personaliteteve të rëndësishme".



Mësimi 5. ROLI SHOQËROR I PERSONALITETEVE TË RËNDËSISHME

Fjalët kyçe: Roli shoqëror, personalitet i ngjarjeve, gjeniu, Shtetet e Bashkuara, UÇK, mobilizim.

Në çdo epokë historike, rrethanat shoqërore kanë nxjerrë personalitete të rëndësishme që, me punën e tyre, kanë ndihmuar progresin njerëzor. Disa personalitete janë të rëndësishme vetëm për vendin e vet, por disa të tjera për mbare botën. Ajshtajni me kontributin e tij në shkencë dhe Shen Tereza me ndihmën e saj për të varfrit, janë personalitete botërore.

Varësisht prej vepnitarsisë së tyre, personalitetet e rëndësishme dallohen në fusha të ndryshme, si: shkencë, politikë, humanizëm, art, letërsi, sporte etj. Edhe vendi ynë, Republika e Kosovës, ka figura të spikatura që njihen jo vetëm brenda vendit, por edhe në gjithë botën.

Gjatë gjithë shekullit XX, Kosova ka përjetuar masa të dhunshme nga regjimet e ndryshme diskriminuuese. Edhe pse në ato rrethanat ishte shumë vështirë të veprohej e të jetohej, këto personalitete kanë arritur të krijojnë histori. Ato, nëpërmjet guximit, mençurisë, sakrificës, talentit etj., shprehën dashurinë ndaj vendit.

16

dhe popullit të tyre, shprehën dëshirën dhe vizionin e tyre për liri, përpjekjen për të luftuar padrejtësitë dhe diskriminimin.

Një ndër figurat më të njohura që shquhet për rezistencën e tij kundër shtypjes dhe padrejtësisë është Adem Demaçi. Ai ka qenë i burgosur për 28 vjet në burgjet jugosllave, vetëm pse angazhohej për të drejtat e shqiptarëve për të qenë të barabartë me të tjerët. Romani i tij "Gjarpitj e gjakut" gjatë kohës së komunizmit ka qenë i ndaluar.



Atij i është dhënë çmimi "Sakharov", nga Parlamenti Evropian, për kontributin në mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe luftimin e shtypjes dhe të diskriminimit për liri e barazi, si dhe angazhimin e tij për paqe.

Figurë tjetër e njohur në Kosovë është Anton Çetta, i cili përveç që njihet si mbledhës i folklorit dhe studiues i kulturës popullore, në vitet '90, u shqua si pajtues ndërmjet familjeve të hasmëruara. Në vendin që quhet Verrat e Llukës, në vitin 1991, pati mbledhur rreth 500 mijë shqiptarë për t'i dhënë fund gjakmarrjes.

Një personalitet tjetër i njohur për rezistencën e tij paqësore të organizuar në Kosovë është Ibrahim Rugova. Ai ishte studiues i letërsisë, i cili pas rënies së komunizmit krijoi partinë e parë demokratike, Lidhjen Demokratike të Kosovës (LDK) e cila iu kundërvet shtypjes dhe diskriminimit të shqiptarëve në Kosovë nga regjimi komunist jugosllav dhe pastaj nga regjimi serb i Millosheviqit.

Në vitin 1992, ai e pati organizuar referendumin për shpalljen e Kosovës shtet të pavarur, ku u zgjodh edhe presidenti i parë i saj. Si president i Kosovës u rizgjodh edhe në vitin 2002. Ishte personalitet i cili çmohej shumë si nga populli i Kosovës, ashtu edhe nga bota perëndimore, sidomos nga ShBA-ja, me të cilën pati krijuar miqësi dhe lidhje të veçanta.

Sikurse Adem Demaçi, edhe Ibrahim Rugova ka fituar çmimin "Sakharov". Vdiq në vitin 2006, pak vjet para se të shpallej Pavarësia e Kosovës. Njihet si presidenti historik i Kosovës.

Në vitet 1998 dhe 1999, Kosova ishte në luftë, pas shumë represaljeve dhe padrejtësive

17



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:

INSERT

Përdorimi i teknikës INSERT bëhet në këtë mënyrë, në libër lexohet mësimi duke vendosur shenjat e teknikës INSERT.

Informacioni i njohur	Informacioni i ndryshuar	Informacioni i ri	Informacioni që nuk e kuptoj
√	-	+	?



Përforcimi:

Konsolidim dhe zbatimi i të nxënit

Komentim i përbashkët

Ju shfaqni dokumentarin e pajtimit të gjaqeve, në krye me Anton Çetën, por pasi dokumentari është i gjatë, udhëzohen nxënësit të vazhdojnë ta shikojnë dokumentarin në shtëpi dhe të shkruajnë rreth tij.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen përmes pyetjeve dhe diskutimit, angazhimit individual dhe në grup, informatë kthjese.

Detyrë:

Të plotësojë në fletoren e punës ushtrimet për këtë njësi.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 6

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Edukatë qytetare

Shkalla e kurrikulës: 3 **Klasa:** VII

Tema: Raportet shoqërore

Rezultatet e të nxënit të temës:

Dallon llojet e ndryshme të raporteve shoqërore. Analizon rolin e personaliteteve të shquara historikisht në nivel kombi dhe më gjerë. Klasifikon dhe përshkruan rolin e grupeve, organizatave.

Kontributi në rezultatet për kompetencat

kryesore të shkallës: I.3, 7; IV.1, 5, 6, 7; V.3, 4, 5; VI.1, 3, 4, 5, 6.

Kontributi në rezultatet e fushës së

kurrikulës: 1.1,1.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Raportet shoqërore, sjelljet dhe shprehitë (Përsëritje)

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Identifikon parakushtet e lidhjeve reciproke mes njerëzve;
- Tregon se si formohen sjelljet dhe shprehitë e mira;
- Vlerëson rëndësinë dhe rolin e shoqërisë civile ose organizatave joqeveritare;
- Vlerëson rolin e personaliteteve të rëndësishme.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fletë A4.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Gjuhë shqipe, Histori, Gjeografi.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënësit

Stuhi mendimesh

Nxiten nxënësit të përgjigjen rreth pyetjeve për tematikën 1.

- Pse janë të nevojshme sjelljet korrekte dhe kultura e mirë e komunikimit?



RAPORTET SHOQËRORE, SJELLJET DHE SHPREHITË

NDËRVEPRIMET NË JETËN E PËRDITSHME

Mësimi 1.

Fjalët kyçe: Ndërveprim, komunikim, bashkëjetesë, solidaritet, kulturë, qytetërim.

Në jetën e përditshme, njerëzit krijojnë raporte dhe lidhje të ndërsjella, ndikime dhe varësi ndaj njëri-tjetrit, varësisht prej rrethanave shoqërore dhe vendit ku jetojnë.

Nevojat dhe interesat e përbashkët jetësorë, nevoja për t'u shoqëruar me njëri-tjetrin, ndihma dhe mbështetja reciproke, dashuria, solidariteti, puna dhe argëtimi, vlerat, normat dhe shprehitë e përbashkëta janë parakushtet për lidhje ndërmjet njerëzve dhe, njëherësh, ndërtojnë bashkësitë shoqërore në të cilat jetojnë. Këto bashkësi mund të jenë grupe të vogla ose të mëdha, fshatra ose qytete, shtete dhe kombe, kultura dhe qytetërimë që ndërliken e ndërveprojnë reciprokisht në kuadër të një bashkësie edhe më të gjerë siç është njerëzimi.

Në kohën tonë, çdo ditë e më shumë po krijohet "varësi" ndaj njëri-tjetrit, si në punë, lojë, hulumtim, ekspeditë etj. Kjo do të thotë se pa ndërvepruar me të tjerët nuk mund të zhvillohet njeriu si genie shoqërore, nuk mund të krijohen marrëdhëniet e punës, as të zhvillohet ekonomia e vendit, as të krijohen veprat e artit dhe të kulturës, sikurse as që mund të zhvillohen lojërat sportive apo të zhvillohen aktivitete të ndryshme argëtuuese. Pra, duke jetuar së bashku dhe duke ndërvepruar në jetën e përditshme, njerëzit mësojnë për kulturën e pranimit, të komunikimit

7

dhe të bashkëjetesës, si në vendin e punës, në shkollë, në fushelobjë, teatër, kinema, ekskursion, punimin e ndonjë projekti a hulumtimi etj. Shpeshherë ndodh që në këto bashkëpunime të ketë edhe mospajtime, mos-



përputhje idesh, argumentesh e pikëpamjesh përgjatë diskutimeve, që janë krejtësisht normale. Ritmi, niveli dhe natyra e zhvillimit të dinamikave në fushën e teknologjisë së komunikimit, të kulturës, të artit etj., pastaj edhe globalizimi i jetës, kanë mundësuar që njerëzit të kenë burime të shumta dijesh dhe informacionesh, por edhe dëshirash, interesash dhe përvojash të ndryshme, gjë që reflektohet në dallime dhe mospërputhje idesh e qëndrimesh. Në botën bashkëkohore zhvillohen diskutime publike dhe dialogohen dallimet në qëndrime duke i respektuar parimet dhe të drejtat e secilit individ në shprehjen e lirë të fjalës dhe të mendimeve, si dhe të drejtat e veprimit sipas interesit dhe vullnetit të vet. Prandaj, për të pasur ndërveprime e raporte të mira shoqërore mes njerëzve, janë të domosdoshme kultura e komunikimit dhe sjelljet korrekte. E si rrjedhojë shmangen përjashtimi, mospranimi, injorimi, diskriminimi dhe mosrespektimi i tjetrit. Secili, që nga fëmijëria, duhet të mësohet të jetojë në diversitet kulturash dhe përkatësish të ndryshme. Të gjithë njerëzit, pa marrë parasysh përkatësitë, janë të lidhur dhe të varur nga njëri-tjetri.



PYETJE:

1. Përzgjidh dhe analizo disa parakushte të lidhjeve reciproke mes njerëzve.
2. Vlerëso rëndësinë e jetës së përbashkët për forcimin e ndërlidhjeve reciproke.
3. Shqyrto pse janë të nevojshme sjelljet korrekte dhe kultura e mirë e komunikimit.

- Cili është roli i shoqërisë civile ose i organizatave joqeveritare?
- Cilat janë shërbimet komunale?
- Si e vlerësoni rolin e sportit kosovar në promovimin ndërkombëtar të Kosovës?



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:

Pyetje-Përgjigje

Përmendi disa personalitete të njohura.	
Kur ka ndodhur pajtimi i gjaqeve?	
Cilat janë parakushtet e lidhjeve reciproke mes njerëzve?	
Cilat janë kompetencat e institucioneve?	
Cilat janë tri lloje të pushtetit?	
Çfarë rëndësie ka jeta e përbashkët dhe ndërlidhjet reciproke?	



Përforcimi:

Konsolidim dhe zbatimi i të nxënit

Komentim i përbashkët

Lexohen mendimet e nxënësve në fletore pune në mënyrë individuale. Nxënësit e tjerë mund të drejtohen me pyetje për informacionet shtesë. Gjithashtu, edhe mësimdhënësi/ja për të kuptuar më shumë mund t'i drejtohen me pyetje, duke respektuar edhe kohën që është në dispozicion.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësim përmes pyetjeve dhe diskutimit, angazhimit individual dhe në grup, informatë kthyesë.

Detyrë:

Të plotësojë në fletoren e punës ushtrimet për këtë njësi.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 7

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Edukatë qytetare

Shkalla e kurrikulës: 3 **Klasa:** VII

Tema: Lidhjet dhe ndikimet reciproke të natyrës dhe shoqërisë

Rezultatet e të nxënit të temës:

Analizon lidhjet dhe ndikimet reciproke ndërmjet natyrës dhe shoqërisë, duke pasur parasysh aspektet gjeografike, mjedisore, ekonomike dhe kulturore.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkollës: I. 1,2, 3,4, 6,8; II. 1, 6, 8.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1; 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Natyra dhe shoqëria - aspektet gjeografike, ekonomike dhe kulturore

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Identifikon njëtrajtshmërinë e natyrës dhe mënyrën si dallon ajo prej vendit në vend;
- Dallon disa prej faktorëve që ndikojnë në zhvillimin e një vendi;
- Vlerëson se si ndikon natyra në zhvillimin dhe në aspektet e tjera shoqërore.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fletë A4, fotografi, projektor.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjeografi, Histori.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënët

Mendo-diskuto

Në tabelë paraqiten disa fotografi të natyrës në botë dhe ndikimi i tyre në zhvillimin e një vendi. Fotot analizohen dhe diskutohen nga nxënësit përmes pyetjeve:

- Pse natyra nuk është e njëtrajtshme?
- A është e rëndësishme pozita gjeografike në zhvillimin ekonomik të një vendi?
- Çfarë lidhje ka kultura me natyrën?



NATYRA DHE SHOQËRIA - ASPEKTET GJEORAFIKE, EKONOMIKE DHE KULTURORE

Fjalët kyçe:
Natyra, vegetacion, flori, faunë, kulturë

Mësimi 6

Natyra dhe shoqëria janë të lidhura ngushtë ndërmjet vete. Natyra paraqet bazën jetësore dhe zhvillimore të shoqërisë njerëzore. Njerëzit u janë përshtatur kushteve të natyrës, por ata edhe e kanë ndryshuar atë për ta përshtatur sipas nevojave të tyre.

Ligjet e natyrës janë universale, por natyra vetë nuk është e njëtrajtshme çdokund. Disa vende janë të ngrohta gjatë tërë vitit e disa të tjera janë të ftohta, kurse disa janë të ngrohta gjatë një periudhe të caktuar të vitit, ndërsa gjatë pjesës tjetër të vitit janë të ftohta; disa vende janë të mbushura me vegetacion, por disa të tjera janë të zhveshura; disa vende janë fushore, e disa tjera janë malore; disa vende kanë tokë pjellore, por disa të tjera janë shkëmbore; disa vende kanë ujë të mjaftueshëm e disa të tjera nuk kanë, disa vende kanë naftë, disa kanë gaz natyror, disa kanë thengjill, disa minerale të ndryshme; disa vende kanë të reshura atmosferike në mënyrë të njëtrajtshme gjatë gjithë vitit e disa të tjera në një pjesë të vitit nuk kanë fare, kurse në pjesën tjetër kanë aq shumë, saqë shkaktohen vërshime të mëdha. Përberja e tokës, relievi, klima, flora dhe fauna, uji dhe pozita gjeografike dallojnë në gjithë globin dhe janë faktorë të rëndësishëm për zhvillimin ekonomik dhe shoqëror, për llojin e ekonomisë që zhvillohet nëpër vende të ndryshme, të punëve dhe profesioneve që i ushtrojnë njerëzit, për mënyrën se si jetojnë, por edhe për traditën kulturore që kanë krijuar popujt e ndryshëm.

19



Se pse disa vende janë zhvilluar më tepër e disa jo, kjo varet shumë edhe prej pozitës gjeografike që kanë ato vende, prej pasurive nëntokësore dhe mbitokësore, prej klimës, relievit, por gjithësesi edhe prej popullsisë, kulturës, traditës historike, sistemit politik dhe mënyrës së qeverisjes.



KULTURË

Por çfarë lidhje ka kultura me natyrën? Kultura njerëzore është mënyra se si jetojnë njerëzit, si mendojnë, si besojnë, si këndojnë, si festojnë, çfarë zakonesh kanë krijuar, çfarë vlerash kanë, çfarë simbolesh etj. Krejt këto kanë lidhje shumë me vendin ku jetojnë dhe me kushtet që i ofron natyra në atë vend. Natyra e ka imponuar mënyrën e jetesës. Popullsia që jeton në viset malore ka një stil jetese ndryshe prej asaj që jeton në vendet fushore. Popullsia që jeton në fshat, jeton ndryshe prej popullsisë që jeton në qytete. Popullsia që jeton në vise bregdetare, jeton ndryshe prej popullsisë që jeton në viset ku nuk ka det, ashtu siç popullsia që jeton në viset polare, jeton ndryshe prej popullsisë që jeton në viset ekuatoriale. Dallime nuk ka vetëm në bazë të zonave gjeografike të globit tokësor, por ka edhe ndërmjet popullatave që jetojnë në rajone të ndryshme. Dallimet kanë të bëjnë me arkitekturën dhe organizimin e hapësirës publike, stilet e ndërtimit, me mënyrën e të ushqyerit, me organizimin e familjes, me festat, muzikën, zakonet, rritualet, simbolet etj.



PYETJE

1. Krahaso dallimet në natyrë mes vendeve të ndryshme.
2. Vlerëso rolin e faktoreve natyrore në zhvillimin ekonomik të një vendi.
3. Analizo lidhjen mes natyrës dhe kulturës njerëzore.

20



Nga diskutimi vihet në përfundim që pozita gjeografike, pasuritë nëntokësore dhe mbitokësore, klima, relievi, popullsia, kultura, traditat historike, sistemi politik, mënyra e jetesës janë të lidhura ngushtë me vendin ku jetojmë dhe me kushtet që i ofron natyra në atë vend.



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:

Të lexuarit në dyshe

Nxënësit ndahen në çifte ose grupe, që nxënësit të bashkëpunojnë dhe të shkëmbejnë idetë e tyre.

Mësimi është i ndarë në tri pjesë dhe nxënësit do të analizojnë tekstin.

Grupi parë: Natyra dhe shoqëria janë të lidhura ndërmjet vete. Natyra paraqet bazën jetësore dhe zhvillimore të shoqërisë njerëzore.

Grupi dytë: Secili vend dallon për nga zhvillimi, sepse disa janë më të zhvilluara disa jo, kjo varet nga pozita gjeografike, klima, relievi, traditat etj.

Grupi tretë: flet për kulturën dhe natyrën.

Nxënësi i parë shpjegon pjesën e parë, ndërsa nxënësi i dytë parashtron pyetje dhe anasjelltas.



Përforcimi:

Konsolidim dhe zbatimi i të nxënësve

Shkrim i lirë

Nxënësit shkruajnë një ese të shkurtër:

Përshkruani natyrën në vendin tuaj në aspektin gjeografik, ekonomik dhe kulturor

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësim përmes pyetjeve dhe diskutimit, angazhimit individual dhe në grup, informatë kthyesë.

Detyrë:

Të plotësojë në fletoren e punës ushtrimet për këtë njësi.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 8

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi
Lënda: Edukatë qytetare
Shkalla e kurrikulës: 3 **Klasa:** VII
Tema: Raportet shoqërore, sjelljet dhe shprehitë

Rezultatet e të nxënit të temës:

Dallon llojet e ndryshme të raporteve shoqërore (miqësore, bashkëpunuese, afruese, integruese, si dhe ato jomiqësore, larguese, përjashtuese, diskriminuese) dhe lidhjet e tyre me sjelljet personale dhe kolektive.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3, 4, 5, 7, 8; IV.1, 4, 5, 6, 7; VI.1, 2, 3, 4, 5, 6, 7.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1.2.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Raportet shoqërore, sjelljet dhe shprehitë (Projektprezantimet)

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Liston faktorët ndikues në formimin e sjelljeve dhe shprehive të mira;
- Analizon rrethanat që ndikojnë në sjelljet e mira për krijimin e favoreve për të gjithë;
- Vlerëson sjelljet korrekte dhe kulturën e mirë të komunikimit.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fletë A4, fotografi, burime nga interneti.


Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjeografi, Histori.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:
Përgatitja për të nxënësit

Nxënësit janë të ndarë në 3 grupe dhe secili grup fillon me prezantimin e projektit.





Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:

Të lexuarit në dyshe

Nxënësit, pasi dëgjuan prezantimin e projekteve, udhëzohen t'i parashtrajnë pyetje njëri-tjetrit.

- Sa ndikojnë sjelljet e mira në jetë?
- Cilat janë rrethanat që ndikojnë në sjelljet e mira për krijimin e favoreve për të gjithë?
- Çfarë rëndësie ka puna e përbashkët?



Përforcimi:

Konsolidim dhe zbatim i të nxënit

Nxënësit në fund shkruajnë një përmbledhje të shkurtër.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësim përmes pyetjeve dhe diskutimit, angazhimit individual dhe në grup, informatë kthyese

Detyrë:

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Edukatë qytetare

Shkalla e kurrikulës: 3 **Klasa:** VII

Tema: Lidhjet dhe ndikimet reciproke të natyrës dhe shoqërisë

Rezultatet e të nxënit të temës:

Analizon ndryshimet në shoqëri si procese të përgjithshme dhe të përhershme, të shkaktuara nga natyra ose njeriu, si: tërmetet, vullkanet, vërshimet, thatësitë, shkrirja e akullnajave, lufta, epidemitë, uria, varfëria, papunësia etj., shpesh të ndërlydhura dhe të ndërvarura.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkollës: II. 1, 6, 8; III. 1, 3, 5.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1, 2.2 .

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Ndryshimet në natyrë dhe pasqyrimi i tyre në jetën e njeriut

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Identifiko disa dukuri natyrore që janë të rrezikshme për jetën e njeriut;
- Dallon disa ndryshime natyrore që i ka shkaktuar puna njerëzore;
- Vlerëson ndryshimet natyrore dhe ndikimet e tyre në jetën e njeriut.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Projektori, fletë A4.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjeografi.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënësit

Rendit, Kërko, Shëno dhe Mëso

Në tabelë shënojmë fjalë apo koncepte që nxësin nxënësit të përgjigjen.

P.sh., tema *Ndryshimet në natyrë*. Më pas pyesim nxënësit se çfarë informacione kanë rreth temës.

NDRYSHIMET NË NATYRË DHE PASQYRIMI I TYRE NË JETËN E NJERIUT

Mësimi 7

Fjalë kyçe: Dükuri natyrore, pasqyra, ekosistemi, biodiversiteti, rreziku i tyre.

Jeta e njeriut varet shumë nga kushtet natyrore. Dükurit natyrore, jo vetëm që ndikojnë në jetën njerëzore, në ekonomi dhe në kulturë, por ndikojnë edhe në shëndetin fizik dhe gjendjen tonë emocionale. Ndikimet e natyrës në jetën e njeriut janë të shumta. Disa dükuri natyrore paraqesin rrezik të drejtpërdrejtë për jetën e njeriut e disa të tjera jo, madje edhe e favorizojnë mirëqenien e njeriut.

Tërmetet, vullkanet, cunamet, ciklonet, stuhitë, të reshurat e mëdha atmosferike, erërat e forta, thatësitë, vërshimet, zjarret, shembjet e dheut, ortelet, temperaturat ekstreme - janë dükuri natyrore që ndikojnë drejtpërdrejt në rrezikimin e jetës dhe të mirëqenies së njeriut.

Disa dükuri të tjera, si për shembull ndërrimi ditë-natë, ndërrimi i stinëve, levizjet e reve, të reshurat mesatare, erërat e lehta, temperaturat e përshtatshme dhe



shumë dükuri të tjera, nuk paraqesin kurrfarë rreziku, por kushtëzojnë ndryshimin e aktiviteteve të njerëzve, p.sh. mënyrën se si vishemi, si ushqehemi, si punojmë, si festojmë, si udhëtojmë, si argetohemi etj.

Problemi nuk është gjithmonë te dükurit natyrore, sepse njerëzit në masë të madhe u janë përshtatur atyre, por problemi është te ndryshimet që kanë ndodhur në natyrë si rezultat i veprimeve të njeriut. Kështu, ka ndodhur që njerëzit, për nevojat e tyre, e kanë ndryshuar pjesërisht ose krejtësisht peizazhin e vendit, duke ndikuar kështu në ekosistemin dhe biodiversitetin, rrjedhën e ujërave, cilësinë e ajrit,

florën dhe faunën. Ata kanë ndërtuar liqene akumulative, kanë ndërtuar hidrocentrale, kanë bërë iriniera e zona industriale etj., dhe si rrjedhojë janë zvogëluar hapësirat e gjelbëruara e janë zgjeruar ato të betonuara e të asfaltuara, është pakësuar toka pjellore, janë tharë kënetat, janë shpyllëzuar sipërfaqe të mëdha toke etj. Të gjitha këto ndryshime që kanë bërë njerëzit në natyrë ndikojnë edhe në shen-



detin dhe mirëqenien e njeriut. Disa ndryshime ndikojnë negativisht, prej ndotjes së ajrit shkaktohen sëmundje të ndryshme, si: sëmundjet e frymëmarrjes, hipertensioni etj.

Disa ndryshime ndikojnë në atë që quhet ngrohje globale. Trafiku i dendur, imbeturinat, bujqësia moderne, industria e naftës dhe e thëngjillit dhe minierat etj., ndikojnë në lirinë e gazeve të serrës, rrjedhinisht edhe në ngrohjen globale. Ngruhja globale pastaj ndikon në shëndetin dhe mirëqenien e njeriut. Ndryshimi i shpejtë i temperaturave, thatësitë, zjarret, vërshimet - shkaktojnë dëme të mëdha jo vetëm në ekonomi por edhe në shëndetin e njeriut. Përveç lirinë të gazeve të serrës, disa ndryshime ndikojnë edhe në pakësimin e biodiversitetit. Prejta e pyjeve, gjuetia e egër, monokultura, ndryshimi i rrjedhës së lumenjve, tharja e kënetave ndikojnë drejtpërdrejt në pakësimin e biodiversitetit.



PYETJE:

1. Përzgjidh dhe analizo disa dukuri natyrore që janë të rrezikshme për jetën njerëzore
2. Interpretë rolin e punës njerëzore në ndryshimet natyrore
3. Trego me shembuj se si reflektohen ndryshimet natyrore në jetën njerëzore
4. Punë në grupe: hulumtoni në internet për ndikimet e dënsime që njeriu ka pasur në natyrë. Prezantojni në klasë dhe diskutoni për to.

22

Nga nxënësit kërkohet që të bëjnë më shumë pyetje dhe përgjigje të shpejta me qëllim që të zbulojmë temën.

Peizazhet	
Dukuritë e dëmshme	Reshjet atmosferike
Ngrohja globale	Ndryshimi i temperaturave
NDRYSHIMET NË NATYRË	
Ekosistemi	Ndryshimi i temperaturave
Biodiversiteti	Tharja e kënetave



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:

Lexim i avancuar

Nxënësit ndahen në grupe nga 1, 2, 3, 4 dhe lexohet teksti, duke ndarë përgjegjësitë për secilin grup.

- Grupi i parë: *Identifiko disa dukuri natyrore të rrezikshme për jetën e njerëzve.*
- Grupi i dytë: *Trego disa dukuri natyrore të cilat nuk janë të rrezikshme për jetën e njerëzve.*
- Grupi i tretë: *Shkruani për ndryshimet natyrore që i ka shkaktuar puna e njeriut.*
- Grupi i katërt: *Tregoni pasojat e ngrohjes globale.*

Pyetjet shënohen në tabelë nga mësimdhënësi/ja dhe nxënësit udhëzohen të gjejnë të dhënat që lidhen me detyrën e dhënë.



Përforcimi:

Konsolidim dhe zbatim i të nxënit

Punë kërkimore - Reflektim në grupe

Grupet prezantojnë para klasës punimet/detyrat (3 min), nxënësit e tjerë mund të drejtojnë pyetje për informacione shtesë nëpërmjet udhëheqësit të grupit.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen si grup dhe si punë individuale, gjithnjë duke i respektuar kriteret e parashtruara.

Detyrë:

Të hulumtojë përmes internetit për ndikimet e dëmshme që njeriu ka pasur në natyrë.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi
Lënda: Edukatë qytetare
Shkalla e kurrikulës: 3 **Klasa:** VII
Tema: Lidhjet dhe ndikimet reciproke ndërmjet natyrës dhe shoqërisë

Rezultatet e të nxënës të temës:
 Shpjegon rëndësinë e përdorimit të teknologjisë për të hulumtuar dhe prezantuar natyrën në funksion të zhvillimit ekonomik, kulturor e turistik.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkollës: II. 1, 6, 8; III. 1, 3, 5.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1, 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Shkenca, teknologjia dhe natyra

- Rezultatet e të nxënës të orës mësimore:**
- Pasqyron se si kanë shpjeguar njerëzit dukuritë në të kaluarën e lashtë;
 - Dallon forma të ndryshme që ofron teknologjia bashkëkohore;
 - Vlerëson arritjet që ofron shkenca e gjenetikës në ditët e sotme.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fletë A4.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Histori, Gjeografi.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:
Përgatitja për të nxënës
Stuhi mendimesh

Në fillim të orës mësimore paraqiten në tabelë ose projektor disa fotografi të shkencës, të teknologjisë dhe të natyrës që nga kohët e lashta deri në ditët e sotme.

SHKENCA, TEKNOLOGJIA DHE NATYRA

Fjalët kyçe: Fenomeni natyror, cilat natyrore, teknologji, gjenetikë, ADN.

Njohuritë e njeriut për natyrën kanë evoluuar në vazhdimësi e, po ashtu, edhe shkathhtësitë manipuluese të tij në raport me të. Në kohëra të lashta, për shumë fenomene natyrore, njerëzit nuk kanë pasur shpjegime shkencore. Shpjegimet e tyre për natyrën kanë qenë të bazuara në besime të ndryshme, në mite e legjenda etj. Por kjo nuk do të thotë se në kohët e lashta njerëzit nuk i kanë kuptuar fenomenet dhe ciklet natyrore, në aspektin praktik të shfrytëzimit të natyrës për nevojat e tyre. Për shembull, ata kanë ditur ta shfrytëzojnë ujin për të lundruar ose për të bartur gjëra të ndryshme prej një vendi në vendin tjetër; kanë ditur ta shfrytëzojnë erën për të ndërtuar mullinj; kanë ditur t'i shfrytëzojnë drurin, metalin, argjilën, gurin dhe shumë elemente të tjera të natyrës për të bërë vegla, stoli ose gjëra të tjera; kanë ditur t'i shfrytëzojnë zjarrin, ujin, dritën, tokën, pastaj kafshët, bimët dhe shumëçka tjetër për nevojat e tyre. Ata kanë krijuar vegla teknike prej gurit, drurit, metaleve, lekures së kafshëve, brirëve etj.

Veglat për përpunimin e tokës, për ndërtim, udhëtim, lundrim, gjueti, peshkim, për punimin e veshjeve, përgatitjen e ushqimit, për arëtimin, komunikimin me njerëzit, pastaj përdorimi i sinboleve për ruajtjen dhe transmetimin e dijes dhe të kujtesës prej një brezi të brezi tjetër, mjetet e ndryshme për orientim në natyrë, për natjet e kohës, armët për të luftuar - kanë ardhur duke u zhvilluar dhe duke u përsosur përgjatë historisë së njerëzimit.

Njeriu bashkëkohor posedon dije dhe njohuri më të avancuara dhe më të sakta për natyrën e, po ashtu, edhe shkathhtësi manipuluese më të sofistikuar në raport me të. Në botën moderne janë shpikur makina, aparate dhe pajisje të tjera





që më një fjalë quhen teknologji e të cilat bëjnë të mundur veprimet që më parë as që janë imagjinuar. Teknologjia bashkëkohore mundëson edhe udhëtimet në kozmos, observimet dhe fotografime të planetëve, yjeve dhe yjësive shumë të largëta. Shkenca dhe teknologjia janë zhvilluar aq shumë, sa që po bëhen përgatitje që pas disa vjetesh të shkohen edhe në Mars, densa prej shkuarjes së njeriut në Hënë tashmë kanë kaluar më shumë se katër dekada.

Njerëzit, me shpikjet e tyre, e kanë lehtësuar shumë udhëtimin e tyre prej një vendi në vendin tjetër. Aq më tepër, njeriu ka shpikur pajisje me të cilat rri i lidhur dhe në kontakt (online) ose komunikon me njerëz të tjerë në vende të ndryshme të botës. Kjo realizohet përmes internetit dhe rrjeteve sociale, të cilat mundësojnë krijimin e një komuniteti virtual me përmasa globale. Teknologjia e komunikimit dhe e informacionit, po ashtu, është zhvilluar shumë; sot mund të bartim fotografi, tekst, pamje etj. në kohë reale. Këtë e ka mundësuar shpikja e internetit. Shkenca dhe teknologjia janë zhvilluar në shumë aspekte të tjera, në fizikë, astronomi, komunikime, transport, inxhinieri etj. Në fushën e mjekësisë, të biologjisë, të gjenetikës, po ashtu, janë bërë studime dhe zbulime të jashtëzakonshme. Falë këtyre zhvillimeve, sot është gjetur kura për shumë sëmundje që dikur kanë qenë të pashërueshme.

Studimet në fushën e biologjisë kanë pasuruar dijen njerëzore për speciet e gjalla dhe për mënyrën se si funksionon organizmi biologjik dhe qelizat e tij. Njohuritë në fushën e gjenetikës dhe ADN-së mundësojnë parashikimin e sëmundjeve

24



Në këtë aktivitet, nxënësit shprehin mendimet e tyre në formë të fjalive të shkurtra dhe pyetjeve nëse kanë diçka të paqartë.




Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:

Organizues grafik

Nxënësit udhëzohen të lexojnë njësinë mësimore që do të zhvillohet. Pasi të lexohet, në tabelë formohet organizuesi grafik, dhe në tabelë shënohet titulli *Shkenca, teknologjia dhe natyra*, ku nxënësit formojnë degët me anën e informacioneve që kuptojnë nga leximi i pjesës.

Informacionet e marra përshkruhen në tabelë dhe në fletoren e klasës.



Përforcimi: Konsolidim dhe zbatimi i të nxënit *Plotëso në fletore pune*

Në mënyrë individuale, plotëso fletoren e punës, duke mos u bazuar në tekstin bazë. (*Shkenca, teknologjia dhe natyra*)

Vlerësimi i nxënësve:

Gjatë kohës që nxënësit punojnë, vlerësohet puna individuale dhe grupore. Nxënësit vlerësohen sipas listës së kontrollit, gjithmonë duke pasur parasysh kriteret (nivel i lartë, i mesëm dhe i ulët).

Detyrë:

Të hulumtojë në internet për zhvillimin e shkencës dhe teknologjisë ndër vite.

Reflektim për rojedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Edukatë qytetare

Shkalla e kurrikulës: 3 **Klasa:** VII

Tema: Lidhjet dhe ndikimet reciproke ndërmjet natyrës dhe shoqërisë

Rezultatet e të nxënit të temës:

Prezanton gjetjet nga eksplorimi i natyrës në rrethinë e më gjerë, si: florën dhe faunën, lumenjtë, liqenet, parqet kombëtare, malet, fushat pjellore, monumentet natyrore dhe ndikimin njerëzor në natyrë.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: II. 1, 6, 8; III. 1, 3, 5.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1, 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Arti, kultura dhe natyra

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Analizon kur ka filluar paraqitja artistike e natyrës;
- Vlerëson punën e një eko-artisti, duke i dhënë rëndësi veçanërisht natyrës;
- Vlerëson qëndrimet dhe vizitat në natyrë.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fletë A4.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjeografi, Histori.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënësit

Di

Në tabelë paraqiten kolonat me teknikën *Di - Dua të di - Mësova*, pastaj ftohen disa nga nxënësit t'i lexojnë disa informacione që ata kanë për njësinë e re mësimore *Arti, kultura dhe natyra*, duke plotësuar kolonën e parë *DI*.

Mësimi 9

ARTI, KULTURA DHE NATYRA

Fjalët kyçe: Arti, kultura, natyra, romantizmi, impresionizmi, lloket natyrore.

Natyra bashkë me bukurinë, fuqinë, llojshmërinë dhe përhershshmërinë e saj, ka qenë jo vetëm burim jetese, por edhe burim frymëzimi për njerëzit. Shkrimtarë, piktorë e këngëtarë të shumtë janë frymëzuar prej natyrës, prej bukurisë së peizazheve, prej maleve madhështore, valëve të detit, ujërave të lumenjve, stineve të vitit, gjallesave të tokës e edhe yjeve.

Edhe në kohërat më të lashta, njerëzit i kanë pasqyruar dukuritë natyrore nëpërmjet krijimeve të tyre artistike. Njerëzit e kanë imituar natyrën me vizatimet e tyre, me zërin, veshjen, dekorimet, arkitekturën, simbolet, ritualet dhe festat e tyre. Në të gjitha kontinentet e botës, sot ka trashëgimi kulturore që ka mbetur prej kohërave të lashta ku shihen figura të kafshëve, të bimëve dhe të objekteve të ndryshme natyrore të pikturuara nëpër shpella ose edhe të punuara në gur, dru, argjilë, metal etj. Vizatimet e shumta nëpër shpella dhe shkëmbinj na tregojnë për mënyrën se si kanë jetuar njerëzit atëkohë, si dhe për lidhjen që kanë pasur ata me natyrën.

Edhe në kohët e mëvonshme, frymëzimi nga natyra ka vazhduar të shprehet përmes krijimesh artistike, figurative, muzikore, letrare etj. Poemat e shkruara qysh nga antika e këndej, pastaj trymat letrare dhe artistike në shekullin e 19-të, si romantizmi dhe impresionizmi, kanë dhënë pamje dhe përshkrimet e shumta për bukuritë e natyrës. Në kohën tonë, tematika e natyrës shprehet në të gjitha llojet e arteve dhe pasqyrohet artistikisht i natyrës është bërë fushë e veçantë profesionale. Ekoarti sot është një profesion i veçantë. Përdorimi i natyrës dhe i objekteve të saj për të krijuar art është injaft i shpeshtë. Gurët e ndryshëm me ngjyrat dhe format e tyre paraqesin objekte të rëndësishme për të bërë art. Disa prej tyre janë unika për nga pamja dhe për ta janë krijuar mite, legjenda ose gojëdhëna. Durrat, me format e ndryshme të trunjeve a rrënjëve të tyre, po ashtu, paraqesin elemente të rëndësishme për artin.



Sot, nëpër vende të ndryshme me peizazhe karakteristike, organizohen aktivitete ose koloni artistike, ku piktorë dhe artistë të tjerë mbledhen dhe punojnë veprat e tyre. Nëpër vende të caktuara, të njohura për bukuritë e tyre natyrore, ekzistojnë qendra ku rrinë poetët dhe piktorët, me qëllim që të inspirohen për të shkruar poezi ose për të bërë piktura ku pasqyrohen bukuritë e natyrës. Shumë vende të tjera në natyrë, ku bëhen vizita ose ekskursione shkollore, janë pika të rëndësishme turistike që vizitohen nga njerëz prej vendeve shumë të largëta. Kështu, ato bëhen pjesë e trashëgimisë kulturore dhe natyrore me rëndësi për vendin dhe gjithë njerëzimin.

Përveç artit, ka shumë rituale ose festa që lidhen me natyrën ose me ciklet e saj. Ringjallja e natyrës në pranverë, jo vetëm që i ka gëzuar bujqit dhe blegtorët, por edhe i ka aktivizuar në punët sezonale, si të mbjellat, qëndrimi sezonal në bjeshkë me bagëti etj. Shumë prej këtyre punëve sezonale janë përcjelle me rituale ose veprime të ndryshme simbolike dhe me festa të ndryshme. Festa dhe rituale janë bërë edhe gjatë verës, vjeshtës dhe dimrit. Viti i Ri është njëra prej festave që lidhet me ciklet e natyrës dhe festohet në inbarë botën, por që dallon në aspektin kalendarik varesisht prej traditave dhe kulturave të vendeve përkatëse.



PYETJE:

1. Interpretjo disa mënyra të imitimit të natyrës përmes artit.
2. Vlerëso rolin e eksoartit në vetëdijësimin e qytetarëve për mbrojtjen e mjedisit.
3. Pse janë të nevojshme qëndrimet dhe vizitat në natyrë?

Nxënësit tregojnë në kolonën *Di* se në kohët e lashta njerëzit nuk i kanë pasur mundësitë për të krijuar vepra artistike si në ditët e sotme; vizatimet janë bërë kryesisht në shpella dhe shkëmbinj duke përshkruar natyrën dhe kulturën e një vendi.



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:

Dua të di

Udhëzohen nxënësit ta lexojnë njësinë e re mësimore dhe të mbajnë shënime që gjatë leximit nëse kanë diçka të paqartë t'i shkruajnë në formë të pyetjes, në kolonën *Dua të di*.



Përforcimi:

Konsolidim dhe zbatim i të nxënit

Mësova

Në kolonën e tretë *Mësova*, nxënësit plotësojnë njohuritë e reja të fituara.

DI	DUA TË DI	MËSOVA
Në kohët e lashta vizatimet janë bërë në shpella dhe shkëmbinj.	Nga e kanë marrë frymëzimin piktorët, artistët dhe shkrimtarët?	Frymëzimi i tyre ka ardhur nga natyra, peizazhet, malet madhështore, valët e detit, stinët e vitit, yjet etj.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për përgjigjet dhe për prezantim të detyrës në saktësi.

Detyrë:

Të shkruajë për temën *Pse janë të nevojshme qëndrimet dhe vizitat në natyrë?*

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 12

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi
Lënda: Edukatë qytetare
Shkalla e kurrikulës: 3 **Klasa:** VII
Tema: Lidhjet dhe ndikimet reciproke ndërmjet natyrës dhe shoqërisë

Rezultatet e të nxënit të temës:
Analizon dokumentarë dhe burime të ndryshme për ndikimin e njeriut në natyrë

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkollës: II. 1, 6, 8; III. 1, 3, 5.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1, 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Ndikimi i njeriut në natyrë

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Analizon ndikimet e njeriut në natyrë dhe ndryshimet e saj;
- Identifikon ndikimet pozitive të njeriut në natyrë;
- Gjykon ndikimet negative të njeriut në natyrë.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fletë A4.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjeografi, Histori.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë

Parashikimi me terma paraprakë

Paraqiten në tabelë fjalët kyçe.

Nga nxënësit kërkohet që të formulojnë fjali duke i përdorur fjalët kyçe dhe të japin një fakt apo informacion lidhur me temën.

Fjalët kyçe:


Zbutja e kafshëve, kultivimi i bimëve, punimi i tokës, prerja e pyjeve, ndryshime klimatike.

Mësimi 10.

NDIKIMI I NJERIUT NË NATYRË

Fjalët kyçe: Zbutja e kafshëve, kultivimi i bimëve, punimi i tokës, prerja e pyjeve, ndryshimi klimatik.

Njeriu është i lidhur me natyrën. Ai në masë të madhe i është përshtatur natyrës sepse është i varur prej saj, por, po ashtu, ai edhe e ka përshtatur natyrën varesisht prej nevojave të tij. Kjo përshtatje ka filluar qysh heret. Zbutja e kafshëve, kultivimi i bimëve, punimi i tokës, ndërtimi i kanaleve të ujitjes, tharja e kënetave, prerja e pyjeve dhe hapja ose zgjerimi i tokave të punueshme, ndërtimi i vendbanimeve të reja, zgjerimi i qyteteve dhe shndërrimi i tyre në metropole ku jetojnë miliona banorë, ndërtimi i rrugëve, autostradave, aeroporteve, fabrikave, minierave, termocentraleve, hidrocentraleve, zonave industriale, plantacioneve bujqësore, komplekseve turistike etj., kanë ndikuar shumë në ndryshimin e pamjes së sipërfaqes së tokës; në ndryshimin e peizazheve dhe pjesërisht edhe të relievit tokësor. Ndikimi i njeriut në natyrë është jashtëzakonisht i madh. Asnjë qenie tjetër nuk




ka dhe nuk ka pasur ndikim më të madh në natyrë sesa njeriu. Ai, pra, ka ndikuar në mënyrën e jetesës së kafshëve dhe të bimëve, në ndryshimin e ekosistemit, në ndryshimin e biodiversitetit, të klimës, të temperaturës globale, në rrjedhën, por edhe në cilësinë e ujerave, në cilësinë e ajrit dhe të tokës. Gjithashtu, njeriu ka ndikuar edhe në hapësirat kozmike, sepse inxhëra satelitore sot gjenden në orbiten e Tokës dhe shumë sonda futurojnë rreth planetëve, ineteorëve ose asteroidëve të ndryshëm. Ndërsa, në vitin 2021, është lëshuar edhe roveri Perseverance, i cili, veç të tjerash, është i pajisur edhe me një helikopter që bën fotografi të terrenit. Pra, disa ndikime të njeriut janë pozitive, disa të tjera janë negative.

Cilat janë ndikimet pozitive?

Njerëzit kanë ndikuar që të kultivojnë bimët të ndryshme dhe të përmirësojnë cilësinë e tyre. Duke kultivuar bimët, kanë krijuar plantacione të ndryshme, si dhe kanë pëllëzuar sipërfaqe të zhveshura, duke krijuar kështu hapësira të gjelbëruara.

28



Po ashtu, njerëzit kanë ndërtuar kanale për ujtitje dhe kanë shndërruar shumë toka të thata në sipërfaqe të pëlleshme. Njerëzit kanë nxjerrë ligje për t'i mbrojtur kafshët e egra, sidomos ato që janë në rrezik për t'u zhdukur, kanë shpallur zona të mbrojtura dhe parqe ku zhvillohet jeta në mënyrë krejt natyrale. Ata kanë bërë rregulla, ligje dhe konventa ndërkombëtare që rregullojnë çështjet e ndryshme që kanë të bëjnë me mjedisin, biodiversitetin, jetën dhe natyrën.

Cilat janë ndikimet negative?

Ndikimet negative të njeriut në natyrë ose në mjedisin jetësor janë të mëdha. Ndikimi kryesor negativ ka të bëjë me degradimin e mjedisit, e sidomos me ndryshimet klimatike. Për shkak të dëmtimit të shtresës së ozonit, ka filluar të rritet temperatura globale. Si pasojë e kësaj, po shkrimen akullnajat e kjo shkakton rritjen e nivelit të ujit të deteve dhe oqeanëve, pastaj vërshimet, thatësitë, zjarret etj. Veç kësaj, shkatërimi i pyjeve, gjuetia e eger, ndotja e ajrit, ndotja e ujit, madje edhe e oqeanëve, hedhja e mbeturinave, sidomos e plastikës në lumenj, përdorimi i pesticidëve në bujqësi, modifikimi gjenetik i organizmave (MGJO) dhe shumë veprimet të tjera kanë ndikuar për keq në mjedisin jetësor dhe në natyrë në përgjithësi.



PYETJE

1. Analizo rolin e njeriut në natyrë.
2. Vlerëso ndikimet pozitive të njeriut në natyrë dhe në mjedisin jetësor.
3. Vlerëso ndikimet negative të njeriut në natyrë dhe në mjedisin jetësor.

Gjatë diskutimit nxënësit tregojnë se zbutja e kafshëve, kultivimi i bimëve, punimi i tokës, prerja e pyjeve, ndryshimet klimatike kanë ndikuar në sipërfaqen e tokës, në ndryshimin e peizazheve dhe relievit të tokës, ku dhe ndikimin i njeriut ka qenë jashtëzakonisht i madh.



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:

Lexim i drejtuar

Lexohet teksti me ndalesa, ku pas çdo ndalesë të nxënësit drejtohen pyetje rreth përmbajtjes.

- *A është i lidhur njeriu me natyrën?*
- *Tregoni kontributin e njeriut në sipërfaqen e tokës dhe në hapësirë.*
- *Cilat janë ndikimet pozitive dhe negative të njeriut në natyrë?*

Sqarohen pyetjet dhe mbajmë shënime në tabelë për informacionet shtesë të cilat do t'i ndihmojnë nxënësvë. Njeriu është i lidhur ngushtë me natyrën, duke iu përshtatur natyrës, si:

- në kultivimin e bimëve;
- në punimin e tokës;
- në ndërtimin e kanaleve të ujitjes;
- në ndërtimin e vendbanimeve;
- në zgjerimin e qyteteve etj.



Përforcimi:

Konsolidim dhe zbatimi i të nxënit

Ditari dypjesësh

Kërkohet nga nxënësit që t'i identifikojnë dhe t'i shpjegojnë ndikimet pozitive dhe negative në natyrë. Puna ndahet në grupe të mëdha ose dyshe dhe vlerësohet.

Ndikimet pozitive të njeriut në natyrë	Ndikimet negative të njeriut në natyrë
- Krijimi i hapësirave të gjelbra	- Degradimi i mjedisit
- Kultivimi i bimëve	- Ngrohja globale
- Pyllëzimi i sipërfaqeve të zhveshura	- Shkatërrimi i pyjeve

Vlerësimi i nxënësvë:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e përgjigjeve bazuar në pyetje

Detyrë:

Të vlerësojë ndikimin pozitiv dhe negativ të njeriut në natyrë në vendin e tij/saj.

Reflektim për veprimet e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi
Lënda: Edukatë qytetare
Shkalla e kurrikulës: 3 **Klasa:** VII
Tema: Lidhjet dhe ndikimet reciproke ndërmjet natyrës dhe shoqërisë

Rezultatet e të nxënit të temës:
 Analizon lidhjet dhe ndikimet reciproke ndërmjet natyrës dhe shoqërisë duke pasur parasysh aspektet gjeografike, mjedisore, ekonomike dhe kulturore. Shpjegon rëndësinë e përdorimit të teknologjisë për të hulumtuar dhe prezantuar natyrën në funksion të zhvillimit ekonomik, kulturor e turistik.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: II. 1, 6, 8; III. 1, 3, 5.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 3.1, 3.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Ndikimi i njeriut në natyrë (Përsëritje)

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Analizon burimet e ndryshme të ndikimit të njeriut në natyrë;
- Shpjegon rëndësinë e teknologjisë në zhvillimin ekonomik dhe kulturor;
- Hulumton gjetjet e natyrës në zhvillimin ekonomik, kulturor dhe turistik.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fletë A4, fletore pune, flipçart.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjeografi, Histori.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:
Përgatitja për të nxënë
Stuhi mendimesh

- Nxiten nxënësit të përgjigjen rreth pyetjeve kërkimore.
- Tregon rolin e njeriut në ndryshimet natyrore.
 - Cilat dukuri natyrore janë të rrezikshme për jetën njerëzore?

Mësimi 10.

NDIKIMI I NJERIUT NË NATYRE


Fjalët kyçe: Zbota e kafshëve, kultivimi i bimëve, punimi i tokës, ndërtimi i kanaleve të ujitjes, tharja e kënetave, prerja e pyjeve dhe hapja ose zgjerimi i tokave të punueshme, ndërtimi i vendbanimeve të reja, zgjerimi i qyteteve dhe shndërrimi i tyre në metropole ku jetojnë miliona banorë, ndërtimi i rrugëve, autostradave, aeroporteve, fabrikave, minierave, termocentraleve, hidrocentraleve, zonave industriale, plantacioneve bujqësore, komplekseve turistike etj., kanë ndikuar shumë në ndryshimin e pamjes së sipërfaqes së tokës; në ndryshimin e peizazheve dhe pjesërisht edhe të relievit tokësor. Ndikimi i njeriut në natyrë është jashtëzakonisht i madh. Asnjë qenie tjetër nuk

Njeriu është i lidhur me natyrën. Ai në masë të madhe i është përshtatur natyrës sepse është i varur prej saj, por, po ashtu, ai edhe e ka përshtatur natyrën varesisht prej nevojave të tij. Kjo përshtatje ka filluar qysh heret. Zbulja e kafshëve, kultivimi i bimëve, punimi i tokës, ndërtimi i kanaleve të ujitjes, tharja e kënetave, prerja e pyjeve dhe hapja ose zgjerimi i tokave të punueshme, ndërtimi i vendbanimeve të reja, zgjerimi i qyteteve dhe shndërrimi i tyre në metropole ku jetojnë miliona banorë, ndërtimi i rrugëve, autostradave, aeroporteve, fabrikave, minierave, termocentraleve, hidrocentraleve, zonave industriale, plantacioneve bujqësore, komplekseve turistike etj., kanë ndikuar shumë në ndryshimin e pamjes së sipërfaqes së tokës; në ndryshimin e peizazheve dhe pjesërisht edhe të relievit tokësor. Ndikimi i njeriut në natyrë është jashtëzakonisht i madh. Asnjë qenie tjetër nuk



ka dhe nuk ka pasur ndikim në të madh në natyrë sesa njeriu. Ai, pra, ka ndikuar në mënyrën e jetesës së kafshëve dhe të bimëve, në ndryshimin e ekosistemit, në ndryshimin e biodiversitetit, të klimës, të temperaturës globale, në rrjedhën, por edhe në cilësinë e ujerave, në cilësinë e ajrit dhe të tokës. Gjithashtu, njeriu ka ndikuar edhe në hapësirat kozmike, sepse mijëra satelite sot gjenden në orbiten e Tokës dhe shumë sonda fluturojnë rreth planetëve, meteorëve ose asteroidëve të ndryshëm. Ndërsa, në vitin 2021, është lëshuar edhe roveri Perseverance, i cili, veç të tjerash, është i pajisur edhe me një helikopter që bën fotografi të terrenit. Pra, disa ndikime të njeriut janë pozitive, disa të tjera janë negative.

Cilat janë ndikimet pozitive?
 Njerëzit kanë ndikuar që të kultivojnë bimë të ndryshme dhe të përmirësojnë cilësinë e tyre. Duke kultivuar bimët, kanë krijuar plantacione të ndryshme, si dhe kanë pyllëzuar sipërfaqe të zhveshura, duke krijuar kështu hapësira të gjelbëruara.



Po ashtu, njerëzit kanë ndërtuar kanale për ujtitje dhe kanë shndërruar shumë toka të thata në sipërfaqe të pëlleshme. Njerëzit kanë nxjerrë ligje për t'i mbrojtur kafshët e egra, sidomos ato që janë në rrezik për t'u zhdukur, kanë shpallur zona të mbrojtura dhe parqe ku zhvillohet jeta në mënyrë krejt natyrale. Ata kanë bërë rregulla, ligje dhe konventa ndërkombëtare që rregullojnë çështjet e ndryshme që kanë të bëjnë me mjedisin, biodiversitetin, jetën dhe natyrën.

Cilat janë ndikimet negative?

Ndikimet negative të njeriut në natyrë ose në mjedisin jetësor janë të mëdha. Ndikimi kryesor negativ ka të bëjë me degradimin e mjedisit, e sidomos me ndryshimet klimatike. Për shkak të dëmtimit të shtresës së ozonit, ka filluar të rritet temperatura globale. Si pasojë e kësaj, po shkohet akullnajat e kjo shkakton rritjen e nivelit të ujit të deteve dhe oqeanëve, pastaj vërshimet, thatësitë, zjarret etj. Veç kësaj, shkalërimi i pyjeve, gjuetia e eger, ndotja e ajrit, ndotja e ujit, madje edhe e oqeanëve, hedhja e mbeturinave, sidomos e plastikës në lumenj, përdorimi i pesticidëve në bujqësi, modifikimi gjenetik i organizmave (MGJO) dhe shumë veprimet të tjera kanë ndikuar për keq në mjedisin jetësor dhe në natyrë në përgjithësi.



PYETJE

1. Analizo rolin e njeriut në natyrë.
2. Vlerëso ndikimet pozitive të njeriut në natyrë dhe në mjedisin jetësor.
3. Vlerëso ndikimet negative të njeriut në natyrë dhe në mjedisin jetësor.

Mendimet e nxënësve diskutohen dhe ndërlidhen me punën e pavarur e cila do të zhvillohet në fletore pune, në tematikën e dytë - *Ndërlidhja reciproke ndërmjet natyrës dhe shoqërisë.*



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:
Punë e pavarur

Nxënësit plotësojnë në fletore pune, tema dytë - *Ndikimet ndërmjet natyrës dhe shoqërisë.*

FLETORE PUNE	
PYETJE	PËRGJIGJE
A është natyra e njëtrajtshme dhe si dallon ajo prej vendit në vend?	
Vlerëso rolin e faktorëve natyrorë në zhvillimin ekonomik të një vendi.	
Analizo lidhjen mes natyrës dhe kulturës njerëzore.	
Interpreto rolin e punës njerëzore në ndryshimet natyrore.	
Krahaso njohuritë e dikurshme mbi dukuritë natyrore me ato të sotme.	
Vlerëso rolin e teknologjisë bashkëkohore.	
Pse janë të nevojshme qëndrimet dhe vizitat në natyrë?	
Analizo ndikimet pozitive dhe negative të njeriut në natyrë dhe në mjedis jetësor.	

Në mënyrë individuale plotësojnë fletoret e punës. Nëse gjatë plotësimit kanë diçka të paqartë, nxënësit janë të lirë të parashtrajnë pyetje.



Përforcimi:
Konsolidim dhe zbatimi i të nxënësve
Reflektim për punë individuale

Lexohen mendimet e nxënësve në fletore pune në mënyrë individuale. Nxënësit e tjerë mund të drejtohen me pyetje për informacione shtesë. Gjithashtu edhe mësimdhënësi/ja për të kuptuar më shumë mund t'i drejtohet me pyetje, duke respektuar edhe kohën që është në dispozicion.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e përgjigjeve bazuar në pyetje.

Detyrë:

Të plotësojë aktivitetet me fotografi në fletoren e punës.

Reflektim për veprimet e orës mësimore:

Mësimi 14

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Edukatë qytetare

Shkalla e kurrikulës: 3 **Klasa:** VII

Tema: Rregullat, normat dhe ligjet

Rezultatet e të nxënit të temës:

Shpjegon evoluimin dhe funksionimin e rregullave, normave dhe ligjeve shoqërore dikur dhe sot.

Kontributi në rezultatet për kompetencat

kryesore të shkallës: I. 3, 4, 7, 8; IV. 1, 4, 5, 6, 7; V. 3,4; VI. 1, 2, 3, 4, 6, 7.

Kontributi në rezultatet e fushës së

kurrikulës: 3.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Krijimi dhe funksioni i rregullave dhe i normave

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Përshkruan si kanë qenë rregullat dhe normat në të kaluarën;
- Dallon disa parakushte që paraprijnë arritjen e suksesit të nxënësve;
- Zbaton rregullat, sepse qytetari ndihet i dinjitetshëm dhe më rehat.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fleta A4, fotografi, burime nga interneti.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Gjuhë shqipe, Histori.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë

Stuhi mendimesh

Ora mësimore fillon me pyetje dhe sjelljen e shembujve nga jeta e përditshme.

- Çka kuptoni ju me rregullat?
- Çfarë janë normat?
- Sillni shembuj të rregullave dhe normave nga jeta juaj e përditshme.



RREGULLAT, NORMAT DHE LIGJET

Mësimi II

KRIJIMI DHE FUNKSIONI I RREGULLAVE DHE I NORMAVE

Fjalët kyçe: Rregull, normë shoqërore, kaos, ligj, ligjvajtës, vendimnesh, liria, dinjitet, shprehje.

Krijimi i rregullave dhe i normave shoqërore është bërë për të mundësuar realizimin e duhur të nevojave bazike njerëzore, pa të cilat njerëzit nuk mund të jetojnë me dinjitet. Këto janë nevojat për ushqimin, për banin, për shoqërinë me të tjerët, për të pasur mbrojtje dhe siguri gjatë jetës etj. Rregullat dhe normat kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë të domosdoshme edhe sot dhe do të jenë të nevojshme pëtherë. Ndonëse mund të ndryshojnë varësisht prej rrethanave dhe nevojave njerëzore. A mund ta paramendoni një grup shoqëror ku nuk ka kurrfarë rregullash? A mund ta paramendoni një shkollë ku nuk respektohet asnjë rregull? A mund të paramendohet një shoqëri ku nuk zbatohet asnjë ligj? Në këto raste, nuk do të kishte kurrfarë rendi, kurrfarë sistemi, por do të krijohet kaos; pra, një gjendje joorganizimi që vjen si rezultat i mungesës së rregullave, të normave, të ligjeve e të vlerave. Në një gjendje të tillë jeta shoqërore do të ishte e pamundshme. Shoqëria njerëzore funksionon sipas rregullave, normave dhe ligjeve. Në mungesë të tyre, jeta do të karakterizohet me pasiguri, paparashikueshmëri, konflikte të vazhdueshme, mungesë të drejtësisë etj. Në një situatë të tillë, nuk do të diheshin detyra dhe roli individual i askujt, si dhe të drejtat e njerëzve do të cenoheshin vazhdimisht.

30

Prandaj themi se, duke ruajtur dinjitetin, duke i dhënë kuptim jetës sonë, ne duhet të vendosim rregulla të mirëfillta në çdo vend, si në shtëpi, shkollë, shoqatë, punë, rrugë dhe kudo që jemi.

Vendosja e rregullave dhe e normave vlen për të gjithë njerëzit, të gjitha vendet dhe të gjitha kohët. Në të kaluarën mund të themi se rregullat dhe normat i kanë vendosur vetëm personat e pushtetshëm dhe ato kanë qenë të imponuara. Kjo do të thotë se dikush i ka vendosur rregullat dhe normat për ty, pa të pyetur, pa i interesuar vullneti dhe interesi yt. Si të tilla, ato rregulla kanë mundur të jenë shtypëse, por detyrnishisht është dashur që të zbatohen. Në të kundërtën, njerëzit të cilët nuk u janë bindur, janë ndëshkuar.

Sot, shumica e vendeve të botës janë shoqëri demokratike, që do të thotë se respektohen të drejtat dhe liritë njerëzore, përfshirë të drejtën për identitet, mbrojtje dhe siguri, liri të shprehjes dhe të lëvizjes, shprehje të vullnetit personal, të pakënaqësive etj. Në këto rrethana, secili është përgjegjës t'i respektojë rregullat dhe normat që na ndihmojnë dhe udhëzojnë për të siguruar zhvillimin tonë, si në aspektin fizik, ashtu edhe atë mendor. Dinjiteti njerëzor rrethohet me shumë, sepse të drejtat e njeriut e mundesojnë atë dhe kushtet për pjesëmarrje në qeverisje dhe në rregullim të vendit janë më të mëdha.

Kjo përbën dallimin kryesor mes së kaluarës dhe së sotmes. Nëse në të kaluarën caktimin e rregullave e ka bërë vetëm një person ose një grup i ngushtë i tyre, sot të gjithë qytetarët mund të përfshihen në hartimin ose shkrimin e rregullave. Për shembull, në hartimin e rregullave në shkollë, përveç të tjerash, duhet të marrin pjesë edhe përfaqësuesit nga ana e nxënësve që do t'i miratonin në parlamentin ose këshillin e nxënësve. Sigurisht se këto rregulla do jenë të njëjta për secilin, sepse duhen përfshirë çështjet që kanë të bëjnë me barazinë gjinore, sociale, etnike, moshore të të gjithë aktorëve (nxënësve, personelit arsimor dhe punëtorëve teknikë). Në këto rrethana, sigurisht se të gjithë do të ishin të kënaqur, sepse vetë i kanë caktuar rregullat dhe normat e sjelljes.

Gjithëpërfshirja dhe barazia në vendimmarrje janë parakushte për një jetë ku respektohen dinjiteti dhe integriteti njerëzor. Këto çojnë drejt suksesit dhe arritjeve në sfera të ndryshme.




PYETJE:

1. Krahaso disa nga rregullat dhe normat e së kaluarës me ato të sotnet.
2. Përcakto procedurën se si do duhej të krijoheshin rregullat për sjellje brenda shkolles.
3. Shqyrto faktorët që kanë ndikuar në arritjet dhe suksesin tend.



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:
Diagrami i Venit



Rregullat më të rëndësishme të shkruara në dokumente të veçanta quhen ligje.

Evidentohen anët e përbashkëta dhe dallimet e ligjit, rregullave dhe zakoneve me Diagramin e Venit.

Rregullat që bazohen te tradita quhen zakone.

Rregullat e shkruara dhe të pashkruara quhen kanune. (Një situatë në lidhje me gjakmarrjen)




Përforcimi:
Konsolidim dhe zbatimi i të nxënit
Shkrimi dhe rrjeti i diskutimit

Punohet me situatat në tekst ose nga jeta e tyre.

Pyetje për diskutim. Nxënësit japin mendimet e tyre *pro* dhe *kundër* duke i argumentuar.

- A janë gjithmonë të drejta rregullat dhe zakonet?



Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen përmes pyetjeve dhe diskutimit, angazhimit individual dhe në grup, informatë kthyesë.

Detyrë:

Të plotësojë në fletoren e punës ushtrimet për këtë njësi.

Reflektim për rojedhën e orës mësimore:

Mësimi 15

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Edukatë qytetare

Shkalla e kurrikulës: 3 **Klasa:** VII

Tema: Rregullat, normat dhe ligjet

Rezultatet e të nxënit të temës:

Krahason traditat, zakonet dhe adetet e pashkruara që praktikohen ose janë praktikuar dikur në familje ose komunitet, si: besa, mikpritja, fejesa dhe martesat, lojërat tradicionale, festat popullore etj., me rregullat, normat dhe ligjet e shkruara, që praktikohen në shoqëri dhe institucione publike, si: shkollë, teatër, spital, polici, organe të pushtetit, organizata shoqërore etj.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkollës: II. 1, 6, 8; III. 1, 3, 5.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 3.1, 3.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Rregullat e shkruara dhe ato të pashkruara

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Përshkruan funksionimin e shtetit në kohët bashkëkohore dhe tradicionale;
- Shpjegon rëndësinë e respektimit të kushtetutës dhe ligjeve;
- Identifikon zakonet shqiptare sipas Kanunit të Lekë Dukagjinit.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Projektor, fletë A4, fotografi.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Histori.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënësit

Stuhi mendimesh

Në tabelë vendosen disa fotografi ose një prezantim me PowerPoint, ku nxënësit shpalosin njohuritë e tyre paraprake në formë diskutimi. Për kohën sa është duke u zhvilluar diskutimi, synohet që të ndërlihdemi me njësinë e re përmes pyetjeve orientuese; flasim për *Rregullat e shkruara dhe ato të pashkruara*.

Mësimi 12.

RREGULLAT E SHKRUARA DHE ATO TË PASHKRUARA

Fjalët kyçe: Ligj, zakon, shqet, bashkëkohore, traditë, tradicionale, kod zakonisht, kushtetutë, baraz ligjor.

Çka i ka bërë të mundshëm ekzistimin dhe funksionimin për një kohë të gjatë të bashkësive njerëzore? Prej kur është krijuar shteti e këndej, në të gjitha epokat dhe sistemet shoqërore, si në shoqëritë tradicionale, ashtu edhe në ato bashkëkohore, kanë ekzistuar rregullat e shkruara (ligjet) dhe ato të pashkruara (zakonet). Rregullat e shkruara ose ligjet kanë të bëjnë me rregullimin e jetës brenda shtetit ose territorit të kontrolluar nga shteti. Me ligje rregullohen çështjet që kanë të bëjnë me të drejtat, detyrat, përgjegjësitë dhe obligimet që i kanë qytetarët ndaj shtetit dhe anasjelltas. Me ligje rregullohen sjelljet njerëzore, ruhet rendi dhe mbrohen të drejtat e liritë njerëzore.



Krahason rregullave të shkruara ose ligjeve, në bashkësinë njerëzore ka edhe rregulla të pashkruara, që janë krijuar në rrethanat kur nuk ka funksionuar shteti dhe kanë mbetur si një trashëgimi prej atyre kohërave. Në kulturën tradicionale shqiptare, që nga mesjeta kanë mbetur disa rregulla të cilat janë batur brez pas brezi dhe të cilat e paraqesin atë që quhet kod zakonor ose kanun. Secila trevë ka pasur traditën e vet e që ka dalluar varësisht nga specifikat e atij rajoni, por me kalimin e kohës këto zakone janë përmbledhur në një libër që quhet "Kanuni i Lekë Dukagjinit". Janë të njohura edhe kanune të tjera, si ai i Skënderbeut, i Labërisë, i Dibrës etj. Këtë përmbledhje të zakoneve shqiptare dhe botimin e tyre në një libër e ka bërë Shtjefën Gjeçovi. Në traditën shqiptare është i njohur fenomeni i gjakmarrjes që ka dëmtuar shumë familjen dhe shoqërinë shqiptare, si në humbje jetësh, ashtu edhe në izolimin e familjeve, pamundësinë e shkollimit të fëmijëve, migrimin dhe probleme të tjera sociale dhe ekonomike.

32





Zakonet dhe traditat

Percaktimi i rregullave në shoqërinë tradicionale ka qenë gojor, pra jo i shkruar. Kujtesa kolektive e ka munduruar ruajtjen e këtyre zakoneve, të cilat kanë qenë obligative për njerëzit e asaj kohe dhe janë konsideruar si rregullatore të jetës së atehershme. Zakonet kanë qenë diskriminuese, sidomos në baza gjinore. Në atë kohë edhe punët kanë qenë të ndara në baza gjinore: disa punë kanë qenë vetëm për burrat e disa të tjera vetëm për gratë.

Për shembull, shitblerja e tokës ose e pronës ka qenë punë e burrit, kurse përgatitja e ushqimit, përkujdesi për fëmijët kanë qenë punë të gruas. Në shoqërinë bashkëkohore kanë ndryshuar rregullat dhe normat, kështu që ndarja e punëve në baza gjinore është në tejkalim e sipër. Gratë dhe burrat duhet të kenë të drejta të njëjta dhe të plota në vendimmarrje, si në aspekte të jetës familjare, ashtu edhe në ato publike.

Shoqëria bashkëkohore udhëhiqet nga institucione shtetërore, të cilat miratojnë dhe zbatojnë ligje e jo zakone tradicionale. Kemi thënë më herët në mësimet para-prake se përgjegjës për miratimin e tyre është Kuvendi. Tanimë populli përfaqësohet nga deputetët, të cilët janë zgjedhur në baza të votës së lirë. Të drejtë propozimi të ligjeve kanë: qytetarët, shoqëria civile, deputetët, qeveria dhe presidenti. Me shumicën e votave në parlament miratohet ligji nga deputetët dhe pas miratimit vendoset në Fletoren Zyrtare dhe nënskruhet ose dekretohet nga presidenti i vendit. Pas dekretimit, fillon zbatimi i tij.



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:

Diagrami i Venit

Mësimdhënësi/ja bën një përmbledhje të shkurtër rreth asaj që u diskutua me nxënësit, dhe flet për temën që do të shtjellohet në vazhdim.

- Shpjegon funksionimin e shtetit në kohët bashkëkohore dhe tradicionale.
- Tregon rëndësinë e respektimit të kushtetutës dhe ligjeve.
- Përshkruan zakonet shqiptare sipas Kanunit të Lekë Dukagjinit.
- Veçon dy koncepte si rregulla të shkruara dhe të pashkruara.

Përmes Diagramit të Venit nxënësit paraqesin të përbashkëta dhe të veçantat e rregullave të shkruara dhe të pashkruara. Nxënësit ndahen në grupe, njëri lexon dhe nxjerr të veçantat e rregullave të shkruara, tjetri të rregullave të pashkruara, ndërsa i treti dhe i katërti nxjerrin të përbashkëtat.

Të veçanta
Rregullat e shkruara-ligjet
Me ligje rregullohen sjelljet njerëzore, ruhet rendi dhe mbrohen të drejtat e liritë e njerëzve

Të përbashkëta
Rregullojnë jetën e njerëzve brenda shtetit

Të veçanta
Rregullat e pashkruara-zakonet
Janë krijuar në rrethana kur nuk ka ekzistuar ligji. Andaj zakonet janë përmbledhur në një libër (Kanuni i Lekë Dukagjinit)



Përforcimi: Konsolidim dhe zbatimi i të nxënësve Prezantimi i Diagramit të Venit

Grupi që ka kryer pjesën e parë më së shpejti e prezantojnë para nxënësve në tabelë. Ndërsa grupet e tjera plotësojnë ato që ndonjëri nga grupet ka harruar ose nuk i ka shkruar në mënyrën e duhur. Pasi të bëhet prezantimi i grupeve, nxënësit kanë të drejtë të bëjnë pyetje rreth asaj që është prezantuar nga grupi 1, 2, 3, 4 me pyetje të shkurtra ose alternativa.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen përmes pyetjeve dhe diskutimit, angazhimit individual dhe në grup, informatë kthyesë.

Detyrë:

Të plotësojë në fletoren e punës ushtrimet për këtë njësi.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 16

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi
Lënda: Edukatë qytetare
Shkalla e kurrikulës: 3 **Klasa:** VII
Tema: Rregullat, normat dhe ligjet

Rezultatet e të nxënit të temës:
 Shpjegon evoluimin dhe funksionimin e rregullave, normave dhe ligjeve shoqërore dikur dhe sot.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 3, 4, 7, 8; IV. 1, 4, 5, 6, 7; V. 3, 4; VI. 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 3.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Rregullat, normat dhe ligjet (Përsëritje)

- Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Përshkruan si kanë qenë rregullat dhe normat në të kaluarën;
 - Dallon zakonet nga ligjet dhe kategorizon fuqinë vepruese të tyre në mjedise të caktuara;
 - Vlerëson respektimin e këtyre rregullave dhe të ligjeve sepse qytetari i konsideron si 'rregullator' të jetës sociale.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fletë A4.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
 Gjuhë shqipe, Histori, Gjeografi.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:
Përgatitja për të nxënë
Ditari dypjesësh

Dikur	Sot



Mësimi II. KRIJIMI DHE FUNKSIONI I RREGULLAVE DHE I NORMAVE

Fjalët kyçe: Rregull, normë shoqërore, kaos, ligj, ligjvajtës, vendimtarë, liria, detyrues, shprehje.

Krijimi i rregullave dhe i normave shoqërore është bërë për të mundësuar realizimin e duhur të nevojave bazike njerëzore, pa të cilat njerëzit nuk mund të jetojnë me dinjitet. Këto janë nevojat për ushqimin, për banin, për shoqërinë me të tjerët, për të pasur mbrojtje dhe siguri gjatë jetës etj. Rregullat dhe normat kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë të domosdoshme edhe sot dhe do të jenë të nevojshme pëtherë. Ndonëse mund të ndryshojnë varësisht prej rrethanave dhe nevojave njerëzore. A mund ta paramendoni një grup shoqëror ku nuk ka kurrfarë rregullash? A mund ta paramendoni një shkollë ku nuk respektohet asnjë rregull? A mund të paramendohet një shoqëri ku nuk zbatohet asnjë ligj? Në këto raste, nuk do të kishte kurrfarë rendi, kurrfarë sistemi, por do të krijohet kaos; pra, një gjendje joorganizimi që vjen si rezultat i mungesës së rregullave, të normave, të ligjeve e të vlerave. Në një gjendje të tillë jeta shoqërore do të ishte e pamundshme. Shoqëria njerëzore funksionon sipas rregullave, normave dhe ligjeve. Në mungesë të tyre, jeta do të karakterizohet me pasiguri, paparashikueshmëri, konflikte të vazhdueshme, mungesë të drejtësisë etj. Në një situatë të tillë, nuk do të dihehin detyra dhe roli individual i askujt, si dhe të drejtat e njerëzve do të cenoheshin vazhdimisht.

Prandaj themi se, duke ruajtur dinjitetin, duke i dhënë kuptim jetës sonë, ne duhet të vendosim rregulla të mirëfillta në çdo vend, si në shtëpi, shkollë, shoqatë, punë, rrugë dhe kudo që jemi.

Vendosja e rregullave dhe e normave vlen për të gjithë njerëzit, të gjitha vendet dhe të gjitha kohët. Në të kaluarën mund të themi se rregullat dhe normat i kanë vendosur vetëm personat e pushtetshëm dhe ato kanë qenë të imponuara. Kjo do të thotë se dikush i ka vendosur rregullat dhe normat për ty, pa të pyetur, pa i interesuar vullneti dhe interesi yt. Si të tilla, ato rregulla kanë mundur të jenë shtypëse, por detyrnishisht është dashur që të zbatohen. Në të kundërtën, njerëzit të cilët nuk u janë bindur, janë ndëshkuar.

Sot, shumica e vendeve të botës janë shoqëri demokratike, që do të thotë se respektohen të drejtat dhe liritë njerëzore, përfshirë të drejtën për identitet, mbrojtje dhe siguri, liri të shprehjes dhe të lëvizjes, shprehje të vullnetit personal, të pakënaqësive etj. Në këto rrethana, secili është përgjegjës t'i respektojë rregullat dhe normat që na ndihmojnë dhe udhëzojnë për të siguruar zhvillimin tonë, si në aspektin fizik, ashtu edhe atë mendor. Dinjiteti njerëzor mbrohet më shumë, sepse të drejtat e njeriut e mundësojnë atë dhe kushtet për pjesëmarrje në qeverisje dhe në rregullim të vendit janë më të mëdha.

Kjo përbën dallimin kryesor mes së kaluarës dhe së sotmes. Nëse në të kaluarën caktimin e rregullave e ka bërë vetëm një person ose një grup i ngushtë i tyre, sot të gjithë qytetarët mund të përfshihen në hartimin ose shkrimin e rregullave. Për shembull, në hartimin e rregullave në shkollë, përveç të tjerash, duhet të marrin pjesë edhe përfaqësuesit nga ana e nxënësve që do t'i miratonin në parlamentin ose këshillin e nxënësve. Sigurisht se këto rregulla do jenë të njëjta për secilin, sepse duhen përfshirë çështjet që kanë të bëjnë me barazinë gjinore, sociale, etnike, moshore të të gjithë aktorëve (nxënësve, personelit arsimor dhe punëtorëve teknikë). Në këto rrethana, sigurisht se të gjithë do të ishin të kënaqur, sepse vetë i kanë caktuar rregullat dhe normat e sjelljes.

Gjithëpërfshirja dhe barazia në vendimmarrje janë parakushte për një jetë ku respektohen dinjiteti dhe integriteti njerëzor. Këto çojnë drejt suksesit dhe arritjeve në sfera të ndryshme.



PYETJE:

1. Krahaso disa nga rregullat dhe normat e së kaluarës me ato të sotmet.
2. Përcakto procedurën se si do duhej të krijoheshin rregullat për sjellje brenda shkolles.
3. Shpyrto faktorët që kanë ndikuar në arritjet dhe suksesin tend.

31



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:

Puna në grupe

Nxënësit ndahen në dy grupe.

Grupi I - Flet për rregullat, zakonet, normat.

Grupi II - Flet për ligjet.



Përforcimi:

Konsolidim dhe zbatimi i të nxënit

Rrjeti i diskutimit

Nxënësve u kërkohet përgjigje për këto pyetje:

1. Si ishin rregullat në të kaluarën dhe kush i bënte ato?
2. A është më e dinjitetshme nëse ju do t'i respektoni rregullat dhe a e konsideroni si arritje nëse jeni respektues të rregullave kudo që jeni?
3. Çfarë ndodh kur dikush nuk e respekton kushtetutën?

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen përmes pyetjeve dhe diskutimit, angazhimit individual dhe në grup, informatë kthyesë.

Detyrë:

Të plotësojë në fletoren e punës ushtrimet për këtë njësi.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 17

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi
Lënda: Edukatë qytetare
Shkalla e kurrikulës: 3 **Klasa:** VII
Tema: Raportet shoqërore, sjelljet dhe shprehitë

Rezultatet e të nxënit të temës:
Përshkruan ndjenjën e ngrohtësisë dhe sigurisë që e ndien në shtëpi dhe në shkollë, duke qenë i rrethuar me njerëz të afërt dhe dashamirës.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkollës: I. 1,2, 3,4, 6, 8; II. 1, 6, 8.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Vlerësim me shkrim – ESE (Periudha I)

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Përshkruan hapat e shkrimit të esesë;
- Shkruan një ese me temën *Roli i edukatës familjare në formimin e sjelljeve dhe shprehive të mira*;
- Zbaton hapat e shkrimit të esesë sipas fazave;
- Shpjegon ndjenjën e ngrohtësisë dhe sigurisë mes njerëzve në formimin e sjelljeve të mira

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fletë A4.


Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Histori, Edukimi për qytetari demokratike.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:
Përgatitja për të nxënë
Ditari dypjesësh

Paraqitet në tabelë tema *Roli i edukatës familjare në formimin e sjelljeve dhe shprehive të mira*. Nxënësve u shpërndahen fletë A4 dhe puna zhvillohet në mënyrë individuale; udhëzohen nxënësit të shkruajnë një ese vlerësuese.





Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:
Shkrim i organizuar

Nxënësit udhëzohen që t'i përmbahen rregullave të shkrimit të esesë me temën *Roli i edukatës familjare në formimin e sjelljeve dhe shprehive të mira*.

Në fazën e shkrimit, nxënësit zbatojnë udhëzimet sipas kriterëve:

- hyrje;
- zhvillimi;
- përfundimi.



ESE
EMRI DHE MBIEMRI: KLASA:
TITULLI: Roli i edukatës familjare në formimin e sjelljeve dhe shprehive të mira



Përforcimi:
Konsolidim dhe zbatimi i të nxënit
Përmbledhje e detyrës

Nxënësit përmbledhin dhe kontrollojnë detyrën për pak minuta nëse kanë pasur gabime dhe e dorëzojnë esenë. Shkrimet lexohen dhe vlerësohen nga mësimdhënësi.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen përmes pyetjeve dhe diskutimit, angazhimit individual dhe në grup, informatë kthjese.

Detyrë:

Të plotësojë në fletoren e punës ushtrimet për këtë njësi.

Reflektim përvojën e orës mësimore:

Mësimi 18

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi
Lënda: Edukatë qytetare
Shkalla e kurrikulës: 3 **Klasa:** VII
Tema: Vlerat shoqërore, humane dhe qytetare

Rezultatet e të nxënës të temës:

Shpjegon rëndësinë e respektimit të vlerave humane për funksionimin e një shoqërie të qëndrueshme, si p.sh., paqja, liria, barazia, respektimi i të drejtave të njeriut, solidariteti, toleranca, bamirësia, vullnetarizmi, falja, pajtimi, ndihma, empatia, shpëtimi etj., dhe i praktikon këto në jetën e përditshme.

Kontributi në rezultatet për kompetencat

kryesore të shkallës: I. 3, 4, 7, 8; IV.1, 4, 5, 6, 7; V. 3, 4; VI. 1, 2, 4, 5, 6, 7.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 3.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Vlerat shoqërore: paqja, liria, barazia dhe demokracia

Rezultatet e të nxënës të orës mësimore:

- Numëron disa vlera të demokracisë;
- Shpjegon pse liria është kusht i jetës njerëzore dhe krijimit të të gjitha mundësive për jetë më të mirë;
- Vlerëson rëndësinë e paqes mes popujve dhe shteteve.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fletë A4, fotografi, burime nga internet.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë shqipe, Histori, Gjeografi.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënësit

Shkrim i shkurtër

Nxënësit individualisht bëjnë një shkrim të shkurtër për paqen, lirinë, barazinë.



VLERAT SHOQËRORE, HUMANE DHE QYTETARE

VLERAT SHOQËRORE: PAQJA, LIRIA, BARAZIA, DEMOKRACIA

Mësimi 13.

Fjalë kyçe: Paqja, liria, barazi, demokraci, liri e shprehjes, liri e shprehjes, pluralizëm politik.

Paqja është koha e qetësisë, lirisë, sigurisë dhe mundësisë së zhvillimit dhe bashkëpunimit mes njerëzve, grupeve të ndryshme shoqërore, popujve dhe shteteve. Nganjëherë ajo pason historit të ndryshme luftërash, konfliktesh, trazirash dhe grindjesh për të rezultuar me pajtim mes palëve armiqësore, duke krijuar mjedis shoqëror pa armiqësi, frikë dhe urrejtje ndaj njeri-tjetrit. Paqja është gjendja që karakterizohet me respekt, bashkëpunim dhe mirëbesim të ndersjelle mes grupeve të ndryshme shoqërore. Ajo synohet nga të gjithë dhe ruajtja e saj është detyrë e secilit. Kur ndodhin luftera ose konflikte mes grupeve shoqërore, paqja është periudha që vjen si përfundim i luftës ose konfliktit, si një marrëveshje mes palëve, por edhe si një mundësi e re e zhvillimit dhe e bashkëpunimit. Ruajtja e paqes është obligim dhe përgjegjësi e secilit. Simboli i paqes është pëllumbi i bardhë dhe dega e ullirit.

Liria nënkupton lëvizjen dhe shprehjen e lirë të secilit/ës, të drejtën për të ushtruar në mënyrë të lirë pikëpamjet, perceptimet dhe ideologjitë individuale, profesionin, besimet etj. Liria është gjendja ku njerëzit ndihen të sigurt nga frika dhe tregiku ose kërcënimin për humbjen e jetës ose burgosjen e padrejtë. Liria është e drejtë njerëzore dhe është kusht themelor për zhvillimin e jetës njerëzore, për zhvillimin e personalitetit, për shfaqjen e identitetit dhe përkatësisë etj. ★

35

Barazia në rend të parë nënkupton barazinë ligjore, pra të qenët i trajtuar njëjtë me të tjerët para ligjit. Barazi ligjore do të thotë trajtim i njëjtit ligjor, pa marrë parasysh përkatësinë. Prandaj, barazia ligjore nënkupton edhe drejtësinë, kur ligji është i njëjtë për të gjithë, pa marrë parasysh përkatësinë ose pozitën sociale që ka individit. Barazia dhe trajtimi i barabartë i secilit/ës është njohje dhe respekt për dinjitetin njerëzor, prandaj, sikurse liria, edhe barazia është pjesë e rëndësishme e të drejtave të njeriut. Simboli i barazisë ligjore ose i drejtësisë është peshorja.



Demokracia është rregullin shoqëror ose sistemin i qeverisjes që nënkupton sundimin e shumicës. Fjala *democrat*, fjalëperfrashëm e ka kuptimin e sundimit të popullit, por në demokracinë bashkohore populli nuk sundon në mënyrë të drejtpërdrejtë, por përmes zgjedhjeve të lira, ku zgjedh përfaqësuesit parlamentarë nëpërmjet votimit. Demokracia nënkupton respektimin e të drejtave të njeriut, barazinë ligjore, lirinë e shprehjes dhe lirinë e lëvizjes së dhe, po ashtu, pluralizmin politik, që do të thotë se qytetarët kanë të drejtë të organizohen nëpër parti të ndryshme dhe grupe të tjera për t'u angazhuar në realizimin e të drejtave dhe interesave të tyre. Demokracia nënkupton ndarjen e pushtetit në legjislativ (kuvendi ose parlamenti), ekzekutiv (qeveria) dhe gjyqësor (gjykatat). Të tria këto lloje pushtetesh janë të pavarura nga njëri-tjetri dhe e krijojnë një kontroll dhe baraspeshë të përgjithshme në strukturën e pushtetit. Kështu, demokracia e bën të pamundshëm krijimin e autoritarizmit ose diktaturës ku sundon vetëm një person ose vetëm një grup i ngushtë. Demokracia është vlerë, por edhe sistem që mundëson realizimin e të gjitha vlerave qytetare.



PYETJE

1. Vlerëso rëndësinë që ka paqja mes popujve dhe shteteve.
2. Pse liria është kushit i domosdoshëm i jetës njerëzore?
3. Analizo kuptimin e konceptit "barazi ligjore".
4. Listo disa tipare të demokracisë dhe trego ndonjë shembull konkret.

Pastaj të dhënat bazë i shkruajnë në anën e majtë të tabelës, duke hulumtuar në internet. Më vonë i vendosin elementet e tjera në anën e djathtë.



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:

Lexim i avancuar

Lexohet teksti me pjesë pasi të jenë formuar grupet.

Grupi	Pjesa
Grupi 1	Paqja
Grupi 2	Liria
Grupi 3	Barazia
Grupi 4	Demokracia



Përforcimi:

Konsolidim dhe zbatimi i të nxënit

Diskutim

Kërkohet nga nxënësit që t'i mbyllin librat dhe të fillojnë diskutimin për njësinë mësimore, duke shfrytëzuar vetëm fletët e punës. Të gjitha grupet kanë mundësi t'i prezantojnë mendimet e tyre. Prezantimin e bën përfaqësuesi i grupit dhe të tjerët e ndihmojnë atë nëse ka nevojë.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen përmes pyetjeve dhe diskutimit, angazhimit individual dhe në grup, informatë kthyesë.

Detyrë:

Të plotësojë në fletoren e punës ushtrimet për këtë njësi.

Reflektim përvojën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi
Lënda: Edukatë qytetare
Shkalla e kurrikulës: 3 **Klasa:** VII
Tema: Vlerat shoqërore, humane dhe qytetare

Rezultatet e të nxënit të temës:
 Shpjegon rëndësinë e respektimit të vlerave humane për funksionimin e një shoqërie të qëndrueshme, si p.sh., paqja, liria, barazia, respektimi i të drejtave të njeriut, solidariteti, toleranca, bamirësia, vullnetarizmi, falja, pajtimi, ndihma, empatia, shpëtimi etj., dhe i praktikon këto në jetën e përditshme.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 3, 4, 7, 8; IV. 1, 4, 5, 6, 7; V. 3, 4; VI. 1, 2, 3, 4, 5, 7.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 3.1, 3.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Vlerat humane dhe qytetare: humanizmi, solidariteti, toleranca

- Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Tregon rëndësinë e humanizmit dhe të solidaritetit;
 - Analizon vlerën e tolerancës dhe mungesën e saj të disa persona;
 - Identifikon disa veprime që kanë të bëjnë me humanizmin.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fletë A4, fotografi, burime nga interneti.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë shqipe, Histori, Gjeografi.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi:
Përgatitja për të nxënë
Bashkëbisedim

Duke pasur parasysh se nxënësit kanë dëgjuar për fjalët si tolerancë, humanizëm, solidaritet, atëherë, fillimisht zhvillohet një bisedë me nxënësit përmes formulimit të disa pyetjeve, si:

- Çfarë rëndësie kanë vlerat në jetën njerëzore?

VLERAT HUMANE DHE QYTETARE:
 HUMANIZMI, SOLIDARITETI, TOLERANCA

Fjalët kyçe: Vlerat, humanizmi, solidaritet, toleranca; "Kryqi i Kuq", "Gjysmëhëna e Kuqe", krizat shoqërore, bashkëjetesa.

Vlerat janë ide, parime, standarde dhe referenca që na drejtojnë në jetë, që na udhëzojnë për veprimet tona të mira, të cilat duhet t'i bëjmë ndaj të tjerëve, por që i rregullojnë edhe veprimet e të tjerëve në raport me ne. Vlerat kanë të bëjnë jo vetëm me njëri-tjetrin, por edhe me bashkësinë shoqërore dhe mjedisin ku jetojmë. Vlerat e mbushin me kuptim jetën njerëzore.

Humanizmi është njëra prej vlerave më të rëndësishme njerëzore. Kjo vlerë ka të bëjë me angazhimin në bamirësi, solidaritetin dhe mbështetjen për ata që janë në gjendje të vështirë materiale, shëndetësore ose në rrezik për jetë. Ai shprehet si në veprimet e thjeshta dhe të përditshme, ashtu edhe në projektet e mëdha që shtrihen deri në përmasa kombëtare dhe ndërkombëtare. Ka shumë njerëz që punojnë në mënyrë vullnetare për të mbledhur fonde dhe për t'u ndihmuar atyre që kanë nevojë, por ka edhe shumë organizata humanitare ndërkombëtare që u ofrojnë ndihmë personave, familjeve dhe popullatave të prekura nga krizat dhe fatkeqësitë e ndryshme (tërmetet, vërshimet, thatësitë, zjarret,

varfëria ekstreme, përleshjet e armatosura, lufta, epidemitë etj.). "Kryqi i Kuq" dhe "Gjysmëhëna e Kuqe" janë dy organizata ndërkombëtare të njohura kudo në botë për ndihmën që u japin popullatave të prekura nga fatkeqësitë, sidomos atyre të përfshira në lufte ose atyre të dëbuarat dhunshëm nga vendi i tyre, sic janë refugjatët e luftës. Këto dy organizata të njohura i kanë degët e veta pothuajse në çdo vend të botës.

Solidariteti është lidhur ngushtë me humanizmin, sepse ka të bëjë me përkrahjen shpirtërore dhe materiale të atyre që janë në gjendje të vështirë. Solidariteti është ndjenjë dhe bashkëjetesë, dashuri dhe identifikimi me tjetrin, por edhe përkrahje për të, qoftë ai individ i cili vuan pa fajin e vet, qoftë ndonjë grup shoqëror i lenë anash ose i keqtrajtuar, qoftë popullatë e cila vuan nga stypja dhe padrejtësitë. Solidariteti është lidhje shoqërore, ndjenjë afërsie, dashamirësie, simpatie dhe gatishmërie për t'u ndihmuar atyre që kanë nevojë.

Toleranca është pranimi i tjetrit përkundër dallimeve të theksuara në bindje, qëndrime, sjellje dhe mënyrë të jetesës, vizione për të ardhmen, besime fetare, politike, ideologjike etj. Tolerancë do të thotë pranimi i asaj që është ndryshe prej teje. Ajo mundëson bashkëjetesën në një vend të grupeve që kanë dallime etnike, racore, kulturore, fetare apo çfarëdo tjetër. Toleranca nuk nënkupton vetëm pranimin e tjetrit, por edhe bashkëveprimin aktiv, bashkëjetesën, ndihmën reciproke, solidaritetin, përkrahjen, respektimin e dokeve, zakoneve, besimeve, simboleve etj. Toleranca ndaj dallimeve ose pranimin i diversitetit është njëra ndër shtyllat kryesore të demokracisë. Njerëzit, edhe kur i takojnë të njëjtit grup shoqëror, kanë dallime në mendime, shprehje stil jetese, shije etj., prandaj, për të funksionuar mirë grupi, nevojitet

edhe një tolerancë ndërmjet atyre që mendojnë ose sillen ndryshe. Kufijtë e tolerancës janë të ngjashëm me kufijtë e lirisë: ata fillojnë aty ku ruhet dinjteti dhe e drejta jote individuale dhe shtrihen deri aty ku ruhet dinjteti dhe e drejta e tjetrit.



PYETJE

1. Përzgjidh dhe analizo disa vlera të rëndësishme në jetën njerëzore.
2. Analizo kuptimin e humanizmit
3. Analizo kuptimin e solidaritetit
4. Argumento pse është e rëndësishme toleranca mes njerëzve.

38

- Çfarë kuptoni me fjalën tolerancë?
- A ekziston ndonjë rast që ju keni qenë tolerantë ndaj dikujt?
- Në cilat raste nuk do të ishit tolerantë?



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:

Insert

Udhëzohen nxënësit të lexojnë njësinë mësimore, duke i njoftuar me kuptimin e simboleve dhe vendosjen e tyre gjatë leximit të mësimt.

Informacioni i njohur	Informacioni i ndryshuar	Informacioni i ri	Informacioni që nuk e kuptoj
√	-	+	?

Pasi të përfundojë leximi i njësisë mësimore, nxënësit reflektojnë dhe debatojnë rreth asaj që kanë lexuar. Ndër pyetjet që do t'ua parashtrijmë nxënësve janë:

- Cilat informacione që më herët i kishit të njohura, tani janë vërtetuar gjatë leximit?
- Çfarë informacione të reja nxorët gjatë leximit?
- Çfarë dëshironi të dini më shumë rreth paqartësive tuaja?



Përforcimi:

Konsolidim dhe zbatimi i të nxënit

Debat

Nxitni nxënësit të shprehin përvojat vetanake ose të familjarëve të tyre, apo njerëzve të njohur, duke i veçuar veprimet humane, solidarë, tolerante, veprimet e familjes dhe të pajtimit. Ajo që duhet të arrihet është mbajtja e qëndrimit, shprehja e emocioneve dhe ndjenjave, si dhe të kuptuarit e problemit.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen përmes pyetjeve dhe diskutimit, angazhimit individual dhe në grup, informatë kthyesë.

Detyrë:

Të plotësojë në fletoren e punës ushtrimet për këtë njësi.

● *Reflektim përvojën e orës mësimore:*

● _____

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi
Lënda: Edukatë qytetare
Shkalla e kurrikulës: 3 **Klasa:** VII
Tema: Vlerat shoqërore, humane dhe qytetare

Rezultatet e të nxënit të temës:

Shpjegon rëndësinë e respektimit të vlerave humane për funksionimin e një shoqërie të qëndrueshme, si p.sh., paqja, liria, barazia, respektimi i të drejtave të njeriut, solidariteti, toleranca, bamirësia, vullnetarizmi, falja, pajtimi, ndihma, empatia, shpëtimi etj., dhe i praktikon këto në jetën e përditshme.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: IV. 1, 2, 3, 4, 7; V. 5, 6, 8.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 3.1, 3.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Vlerat humane: vullnetarizmi, falja dhe pajtimi

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Shpjegon rolin e vullnetarizmit si vlerë humane në zhvillimin e një vendi;
- Përshkruan rolin e Anton Çetës në pajtim e gjaqeve në vitet e 90-ta;
- Arsyeton ndikimin e faljes dhe pajtimit ndër gjenerata.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Kompjuteri, projektori, fletë A4, <https://youtu.be/PisrndwQPy4?si=IWM667NDpua3inM3> (pajtimi i gjaqeve në Kosovë 1990).

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Histori.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë

Di - Dua të di - Mësova

Di

Njësia e re mësimore fillon me një video që është dokumentar për pajtimin e gjaqeve në Kosovë, në vitet e 90-ta nga Anton Çeta <https://youtu.be/PisrndwQPy4?si=IWM667NDpua3inM3>, ku mësimdhënësi/ja hap diskutimin duke paraqitur në tabelë kolonat, pastaj fton nxënësit t'i lexojnë disa nga informacionet të cilat ata kanë lidhur




VLERAT HUMANE: VULLNETARIZMI, FALJA DHE PAJTIMI

Fjalë kyçe: Vullnetarizmi, bamirësia, veprimtari vullnetar, rekreacion, falja, aktivizim

Vullnetarizmi është njëra prej vlerave kryesore humane dhe qytetare. Ai nënkupton angazhimin dhe kontributin e njerëzve për të mirën e komunitetit a shoqërisë, pa u kompensuar. Se sa është e shprehur kjo vlerë, shihet nga veprimtaritë vullnetare që ndërmerrin për qëllime të ndryshme. Disa qytetare bëjnë punë fizike për të kontribuar në pastrimin e rrjedisit ose për të mbjellë fidanë nëpër sipërfaqet e zhveshura, disa të tjerë mbledhin ndihra për t'iu ndihnuar familjeve të varfra ose personave të sëmurë, disa ndërtojnë çezina në vende të ndryshme për të ofruar ujë të pijshëm, disa bëjnë punë vullnetare për të organizuar ngjarje të rëndësishme kulturore ose artistike, tubime ose konferenca shkencore, gara sportive etj., disa janë vullnetare për dhënie e gjakut dhe shpëtimin e jeteve, disa persona bëjnë punë vullnetare për t'i ushqyer kafshët e egra, sidomos gjatë periudhës së dimrit etj.



Të gjitha këto janë disa nga rastet kur kryhet punë vullnetare. Siç e shihni, puna vullnetare përmirëson inënyrën e jetesës. Ajo gjithashtu ndikon në nderludhjen e brezave të ndryshëm mes vete, sepse puna që kanë bërë brezat e mëparshëm, sot mund të jetë shumë e dobishme për brezat aktuale, por edhe të ardhshmit. Sot në Kosovë ka shumë sipërfaqe të mbjella me pisha, të cilat tashmë, përveç që janë të dobishme për oksigjen, janë peizazhe të mrekullueshme dhe vende të përshtatshme për rekreacion, për ecje, për vrapim, për shtigje biçikletash dhe për vendpeshime të ndryshme.



Në Kosovë, vullnetarizimi ka një traditë. Në vitet '90 të shekullit të kaluar, kur të drejtat e shqiptarëve qenë shkelur nga regjimi serb i Millosheviqit, mijëra arsimtarë shqiptarë patën vendosur të punonin vullnetarisht, vetëm për të mos u ndërprerë mësimi shqip nëpër shkollat e Kosovës. Përveç kësaj, gjindra vullnetarë kanë punuar edhe në mbledhjen e ndihmave për familjet e varfra atëkohë. Shogata "Nënë Tereza" dhe shogata të tjera humanitare të asaj kohe, me ndihmën e vullnetarëve, kanë furnizuar me barna, ushqime, veshmbathje shumë persona dhe familje në nevojë.

Në po në të njëjtën kohë, ishte organizuar një tubim i madh me qëllim të pajtimit të familjeve të hasmëruara. Mijëra aktivistë, studentë, profesorë, shkrintarë, intelektualë, gazetarë dhe personalitete të tjera në krye me profesorin e njohur Anton Çetta, kanë marrë pjesë vullnetarisht në aksionin e njohur për pajtimin e gjaqeve, ku mijëra familje i zgjidhën ngatërresat mes vete, i falën gjaqet dhe u pajtuan me njera-tjetren. Ky aksion vullnetar, humanitar dhe gjithëpopullor është njëri prej aksioneve më të famshme në historinë e re të Kosovës. Aty kanë ardhur në shprehje falja, pajtimi, mirësia, humanizmi, toleranca, dashuria për një-tjetrin, kultura dhe civilizimi.



Përforcimi: Konsolidim dhe zbatimi i të nxënës *Mësova*

Ftohen disa nxënës në mënyrë individual ose grupore t'i prezantojnë punimet e tyre.

DI	DUA TË DI	MËSOVA
<ul style="list-style-type: none"> - Vullnetarizimi kryen punë vullnetare. - Falja dhe pajtimi janë të rëndësishme për pajtimin e familjeve të hasmëruara. 	<ul style="list-style-type: none"> - Çfarë vlera janë vullnetarizmi, falja dhe pajtimi? 	<ul style="list-style-type: none"> - Vullnetarizmi, falja dhe pajtimi janë vlera humane që merren me kontributin dhe angazhimin e njerëzve për të mirën e komunitetit dhe shoqërisë.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për prezantimin e ideve dhe për shkathtësitë në bashkëpunim.

Detyrë:

Të hulumtojnë përmes internetit fakte rreth vullnetarizmit, faljes dhe pajtimit të gjaqeve në vitet 1990-1991 në Kosovë.

Reflektim për veprimet e orës mësimore:

me njësinë e re mësimore.

- Vullnetarët kryejnë punë vullnetare: pastrimin e ambientit, gara sportive, dhënie e gjakut etj.
- Falja dhe pajtimi janë të rëndësishme për pajtimin e familjeve të hasmëruara duke shprehur tolerancë, falje, pajtim, mirësi, kulturë dhe civilizim.



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: *Dua të di*

Në kolonën e dytë *Dua të di*, nxënësit kanë mundësi të bëjnë pyetje rreth temës duke krahasuar informacionet të cilat i dinë me informacionin e ri.

Mësimdhënësi/ja udhëzon nxënësit ta lexojnë njësinë mësimore, që nëse kanë diçka të paqartë ta shkruajnë në formë të pyetjeve.

- Cili ishte qëllimi i tubimit të organizuar nga vullnetarët?
- Sa janë të rëndësishme veprimtaritë vullnetare?
- Tregoni kontributin e Anton Çetës.
- Arsyeto ndikimin e faljes dhe pajtimit ndër gjenerata.
- Çfarë vlera janë vullnetarizmi, falja dhe pajtimi?

Nxënësit plotësojnë njohuritë e reja të fituara në kolonën *Di - Dua të Di - Mësova*.

Mësimi 21

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi
Lënda: Edukatë qytetare
Shkalla e kurrikulës: 3 **Klasa:** VII
Tema: Vlerat shoqërore, humane dhe qytetare

Rezultatet e të nxënit të temës:

Shpjegon rëndësinë e respektimit të vlerave humane për funksionimin e një shoqërie të qëndrueshme, si p.sh., paqja, liria, barazia, respektimi i të drejtave të njeriut, solidariteti, toleranca, bamirësia, vullnetarizmi, falja, pajtimi, ndihma, empatia, shpëtimi etj., dhe i praktikon këto në jetën e përditshme.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: IV. 1, 2, 3, 4, 7; V. 5, 6, 8.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 3.1, 3.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Vlerat shoqërore dhe humane (Përsëritje)

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Shpjegon rëndësinë e vlerave humane në një shoqëri të qëndrueshme;
- Identifikon disa veprime që kanë të bëjnë me humanizmin, solidaritetin dhe tolerancën;
- Analizon pse duhet të kultivohet paqja dhe harmonia mes njerëzve.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fletë A4, projektor.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Histori.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënësit
Stuhi mendimesh

Nxiten nxënësit të përgjigjen rreth pyetjeve:

- Shpjegoni pse janë të rëndësishme vlerat shoqërore dhe humane.
- Kush bënë pjesë në vlerat shoqërore?
- Listo vlerat humane dhe qytetare.



VLERAT SHOQËRORE, HUMANE DHE QYTETARE

VLERAT SHOQËRORE: PAQJA, LIRIA, BARAZIA, DEMOKRACIA

Mësimi 13

Fjalë kyçe: Paqja, liria, barazi, demokraci, liri e shprehjes, liri e fjalës, pluralizëm politik.

Paqja është koha e qetësisë, lirisë, sigurisë dhe mundësisë së zhvillimit dhe bashkëpunimit mes njerëzve, grupeve të ndryshme shoqërore, popujve dhe shteteve. Nganjëherë ajo pason historitë të ndryshme luftërash, konfliktesh, trazirash dhe grindjesh për të rezultuar me pajtim mes palëve armiqësore, duke krijuar mjedis shoqëror pa armiqësi, frike dhe urrejtje ndaj njeri-tjetrit. Paqja është gjendja që karakterizohet me respekt, bashkëpunim dhe mirëbesim të ndersjelle mes grupeve të ndryshme shoqërore. Ajo synohet nga të gjithë dhe ruajtja e saj është detyrë e secilit. Kur ndodhin luftera ose konflikte mes grupeve shoqërore, paqja është periudha që vjen si përfundim i luftës ose konfliktit, si një marrëveshje mes palëve, por edhe si një mundësi e re e zhvillimit dhe e bashkëpunimit. Ruajtja e paqes është obligim dhe përgjegjësi e secilit. Simboli i paqes është pëllumbi i bardhë dhe dega e ullirit.

Liria nënkupton lëvizjen dhe shprehjen e lirë të secilit/ës, të drejtën për të ushtruar në mënyrë të lirë pikëpamjet, perceptimet dhe ideologjitë individuale, profesionin, besimet etj. Liria është gjendja ku njerëzit ndihen të sigurt nga frika dhe tregjku ose kërcënimin për humbjen e jetës ose burgosjen e padrejtë. Liria është e drejtë njerëzore dhe është kusht themelor për zhvillimin e jetës njerëzore, për zhvillimin e personalitetit, për shfaqjen e identitetit dhe përkatësisë etj. ★

35

Barazia në rend të parë nënkupton barazinë ligjore, pra të qenët i trajtuar njëjtë me të tjerët para ligjit. Barazi ligjore do të thotë trajtim i njëjtte ligjor, pa marrë parasysh përkatësinë. Prandaj, barazia ligjore nënkupton edhe drejtësinë, kur ligji është i njëjtë për të gjithë, pa marrë parasysh përkatësinë ose pozitën sociale që ka individit. Barazia dhe trajtimi i barabartë i secilit/ës është njohje dhe respekt për dinjitetin njerëzor, prandaj, sikurse liria, edhe barazia është pjesë e rëndësishme e të drejtave të njeriut. Simboli i barazisë ligjore ose i drejtësisë është peshorja.



Demokracia është rregullin shoqëror ose sistemin i qeverisjes që nënkupton sundimin e shumicës. Fjala *demokraci*, fjalëpergjithësim e ka kuptimin e sundimit të popullit, por në demokracinë bashkohore populli nuk sundon në mënyrë të drejtëpërdrejtë, por përmes zgjedhjeve të lira, ku zgjedh përfaqësuesit parlamentarë nëpërmjet votimit. Demokracia nënkupton respektimin e të drejtave të njeriut, barazinë ligjore, lirinë e shprehjes dhe lirinë e lëvizjes së dhe, po ashtu, pluralizimin politik, që do të thotë se qytetarët kanë të drejtë të organizohen nëpër parti të ndryshme dhe grupe të tjera për t'u angazhuar në realizimin e të drejtave dhe interesave të tyre. Demokracia nënkupton ndarjen e pushtetit në legjislativ (kuvendi ose parlamenti), ekzekutiv (qeveria) dhe gjyqësor (gjykatat). Të tria këto lloje pushtetesh janë të pavarura nga njëri-tjetri dhe e krijojnë një kontroll dhe baraspeshë të përgjithshme në strukturën e pushtetit. Kështu, demokracia e bën të pamundurshëm krijimin e autoritarizmit ose diktaturës ku sundon vetëm një person ose vetëm një grup i ngushtë. Demokracia është vlerë, por edhe sistem që mundëson realizimin e të gjitha vlerave qytetare.



PYETJE

1. Vlerëso rëndësinë që ka paqja mes popujve dhe shteteve.
2. Pse liria është kusht i domosdoshëm i jetës njerëzore?
3. Analizo kuptimin e konceptit "barazi ligjore".
4. Listo disa tipare të demokracisë dhe trego ndonjë shembull konkret.

Mendimet e nxënësve diskutohen dhe ndërlidhen me punën e pavarur e cila do të zhvillohet përmes fletore pune, në tematikën e katërt - *Vlerat shoqërore dhe humane*.



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:

Punë e pavarur

Nxënësit plotësojnë në fletore pune, tema dytë – *Vlerat shoqërore dhe humane*.

PYETJE	PËRGJIGJE
Vlerëso rëndësinë që ka paqja mes popujve dhe shteteve.	
Pse liria është kusht i domosdoshëm i jetës njerëzore?	
Përzgjidh dhe analizo disa vlera të rëndësishme në jetën njerëzore.	
Trego disa raste ku është shprehur solidaritet.	
Argumento pse është e rëndësishme toleranca mes njerëzve.	
Analizo rëndësinë e vullnetarizmit për ndërlidhjen mes gjeneratave.	
Analizo rëndësinë e aksionit për faljen e gjaqeve në vitet '90.	
Analizo rëndësinë e ruajtjes së paqes dhe harmonisë mes popujve.	

Në mënyrë individuale plotësojnë fletoret e punës, dhe nëse kanë diçka të paqartë nxënësit janë të lirë të parashtrojnë pyetje.



Përforcimi:

Konsolidim dhe zbatimi i të nxënësve

Reflektim për punë individuale

Në mënyrë individuale, nxënësit lexojnë përgjigjet rreth pyetjeve në fletore pune. Nxënësit e tjerë mund të drejtohen me pyetje për informacione shtesë. Gjithashtu, mësimdhënësi/ja për të kuptuar më shumë mund t'i drejtohet me pyetje, duke respektuar edhe kohën që është në dispozicion.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për punën individuale, gjithnjë duke i respektuar kriteret e parashtruara.

Detyrë:

Të analizojë kuptimin e konceptit "barazi ligjore".

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 22

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi
Lënda: Edukatë qytetare
Shkalla e kurrikulës: 3 **Klasa:** VII
Tema: Vlerat shoqërore, humane dhe qytetare

Rezultatet e të nxënit të temës:

Shpjegon rëndësinë e raportimit të veprimeve që janë në kundërshtim me vlerat e shoqërisë demokratike, si: paragjykimet racore ose etnike, diskriminimi gjinor, jotoleranca fetare, përjashtimi social, ekstremizmi, radikalizmi, korrupsioni etj., të personat dhe institucionet përgjegjëse.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: IV. 1, 2, 3, 4, 7; V. 5, 6, 8.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 3.1, 3.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Dukuritë e dëmshme: paragjykim, diskriminimi dhe përjashtimi social

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Tregon llojet e paragjykimeve;
- Krahason diskriminimin dhe përjashtimin social në baza gjinore, fetare dhe sociale, etnike.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fletë A4.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Histori.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënësit
Stuhi mendimesh

Fillon ora mësimore me një prezantim në PowerPoint me temën *Dukuritë e dëmshme*, nëse klasa posedon projektor, nëse nuk ka atëherë në tabelë shënohen konceptet bazë për dukuritë e dëmshme:



Mësimi 16

DUKURITË E DËMSHME: PARAGJYKIMI, DISKRIMINIMI DHE PËRJASHTIMI SOCIAL

Fjalët kyçe: Dukuritë e dëmshme, stereotip, antivlera.

Krahas vlerave dhe normave, në jetën shoqërore ka edhe antivlera. Paragjykimet për të tjerët, diskriminimi, përjashtimi social, racizmi, ekstremizmi dhe terrorizmi janë në kundërshtim me vlerat humane. Të gjitha këto e pengojnë zhvillimin e njeriut dhe të shoqësisë, zhvillimin e lirisë, demokracisë, paqes dhe mirëqenies njerëzore. Këto e pamundësojnë zhvillimin dhe progresin njerëzor, prandaj, me një fjalë, të gjitha këtyre u themi antivlera, sepse janë në kundërshtim me vlerat humane.

Paragjykim është i gabuar, sepse nuk bazohet në gjykim të arsyeshëm dhe njerëzit vlerësohen në bazë të tipareve, të cilat u mvishen grupeve që ata u takojnë. Paragjykimet më së shpeshti janë të drejtuara ndaj grupeve të ndryshme racore, etnike, fetare, por edhe ndaj përkatësisë gjinore. Po ashtu, paragjykimet mund të jenë të drejtuara edhe ndaj personave që vijnë prej rajoneve të caktuara, pastaj ndaj ushtruesve të profesioneve të ndryshme, por edhe ndaj shtresave të caktuara shoqërore. Me një fjalë, paragjykimet janë të dëmshme për individin dhe grupin, sepse nuk bazohen në njohjen reale, por në stereotipat e krijuar nga të tjerët, në ndjenjat negative ose antipatitë për të tjerët. Raportet e bazuara në paragjykimet nuk mund të jenë të qëndrueshme dhe të frytshme. Lirimi nga paragjykimet e mundëson njohjen më të mirë dhe më të lehtë ndërrinjet njerëzve, por edhe krijimin e raporteve më të qëndrueshme, më humane dhe më të frytshme.

Diskriminim do të thotë trajtim i padrejtë i një personi ose grupi tjetër, në bazë të etnisë, fesë, racës, gjinisë, moshës dhe çfarëdo përkatësie tjetër.

42



Njerëzit kanë pozita dhe role të ndryshme në shoqëri. Disa njerëz mbajnë pozita më të larta në shoqëri dhe ndodh që t'i diskriminojnë ata me pozita më të ulëta. Diskriminimi mund të ndodhë në situata të ndryshme. P.sh., në punë, diskriminimi mund të ndodhë ashtu që për punën e njëjtte dikush të paguhet më pak e dikush tjetër më shumë. Në disa vende diskriminohen minoritetet e në disa të tjera ndodh edhe diskriminimi racor. Në kohën kur Kosova ishte pjesë e Republikës Federale Socialiste të Jugosllavisë, shqiptarët diskriminoheshin vetëm për faktin se i takonin një kornbi, përkatësisht një etnie tjetër prej përkatësive të tjera që e përbënin Jugosllavinë. Pas suprimimit të Autonomisë së vitit 1974 në 1989, ky diskriminim u rrit dukshëm me çrast shqiptarët u përjashtuan tërësisht nga sistemi. Si rrjedhojë, ata u detyruan të ndërtojnë dhe të jetojnë në sistem paralel për të siguruar mbijetesën historike.

Një formë tjetër e diskriminimit, madje nga më të përhapurat në ditët e sotme, është diskriminimi gjinor. Gati në të gjitha vendet e botës pjesëmarrja e grave në vendimmarrje është më e ulët sesa e burrave. Shkalla e arsimimit dhe e punësimit të grave në krahasim me burrat po ashtu është më e ulët. Fatkeqësisht, në vende të ndryshme në botë ka ende raste kur në familje ushtrohet dhunë fizike ndaj gruas, i kufizohet liria e lëvizjes, e fjalës dhe e vendimmarrjes. Lëvizjet dhe organizatat e ndryshme për të drejtat e grave kanë luajtur dhe vazhdojnë të luajnë rol thelbësor për avancimin e pozitës së gruas në shoqëri, ndërgjegjësimin e njerëzve dhe luftimin e shkeljeve të të drejtave të grave në familje dhe në shoqëri. Po ashtu, Kuvendi i Republikës së Kosovës ka miratuar Ligjin mbi Barazimin Gjinor. Qëllimi i këtij ligji është ndërprerja e praktikave diskriminuese ndaj gruas në familje dhe në shoqëri dhe krijimi i barazisë ndërmjet dy gjinive. Përveç diskriminimit të grave, është i njohur edhe diskriminimi ndaj fëmijëve. Puna e rëndë për fëmijët, edhe pse është e ndaluar me ligj, ajo është ende akoma prezente si dukuri. Po ashtu, ende janë të pranishme format e ndryshme të diskriminimit të pleqve ose personave me nevoja të veçanta.

43

Paragjykimet Përjashtimi social Diskriminimi

Nga nxënësit kërkohet fillimisht të mendojnë për njohuritë e tyre lidhur me temën e dhënë. Pastaj ftohen disa nga ta të diskutojnë dhe të shpalosin mendimet e tyre për paragjykimet, diskriminimin dhe përjashtimin social, duke mos i pohuar apo mohuar mendimet e tyre.



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:
DRTA

Nxënësit ndahen në grupe dhe udhëzohen t'i hapin librat në faqen e njësisë së re mësimore.

Grupi parë lexon paragrafin e parë – *paragjykimet*.

Grupi dytë lexon paragrafin e dytë – *diskriminimin*.

Grupi tretë lexon paragrafin e tretë – *përjashtimin social* dhe pasi t'i lexojnë në heshtje i komentojnë ato me gojë ose me shkrim.

Nxënësit fillojnë diskutimin e drejtuar me pyetje për çka bëhet fjalë në paragrafin e parë.

Grupi i parë: Nxënësit gjatë diskutimit tregojnë se paragjykimet janë të dëmshme sepse nuk bazohen në njohje reale.

DUKURITË E DËMSHME
Pjesë e rëndësishme
<ul style="list-style-type: none"> - <i>Paragjykimet janë të dëmshme për individ dhe grup.</i> - <i>Diskriminimi është trajtimi i padrejtë e paragjykes i njerëzve ose grupeve.</i> - <i>Përjashtimi social është përjashtim nga vendimmarrja.</i>
<i>Këto dukuri të dëmshme ndodhin duke u bazar në faktorët, si gjinia, përkatësia etnike, raca, feja, kombësia etj</i>



Përforcimi:
Konsolidim dhe zbatimi i të nxënësve
Plotëso fletore pune

Në mënyrë individuale plotësojnë në fletoren e punës, duke mos e përdorur tekstin bazë.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për mendimet e dhëna dhe për gjykimet e arsyeshme, për komentimin dhe analizimin e ngjarjeve përmes listës së kontrollit.

Detyrë:

Të ilustrojë me fotografi ose video ndonjë rast të përjashtimit social.

• *Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Edukatë qytetare

Shkalla e kurrikulës: 3 **Klasa:** VII

Tema: Vlerat shoqërore, humane dhe qytetare

Rezultatet e të nxënit të temës:

Shpjegon rëndësinë e raportimit të veprimeve që janë në kundërshtim me vlerat e shoqërisë demokratike, si: paragjykimet racore ose etnike, diskriminimi gjinor, jotoleranca fetare, përjashtimi social, ekstremizmi, radikalizmi, korrupsioni etj., të personat dhe institucionet përgjegjëse.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: IV. 1, 2, 3, 4, 7; V. 5, 6, 8.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 3.1, 3.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Dukuritë e dëmshme dhe të rrezikshme: ekstremizmi dhe terrorizmi

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Shpjegon çka është ekstremizmi;
- Analizon të përbashkëtat e ekstremizmit dhe terrorizmit dhe dëmet që sjellin ato në shoqërinë njerëzore.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen së bashku me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fletë A4.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Histori.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë

Imaginatë e drejtuar

Shtrohet pyetja:

- *Çka është terrorizmi dhe ekstremizmi?*

Nxënësit përshkruajnë terrorizmin dhe ekstremizmin duke iu referuar fotografive, të cilat mësimdhënësi/ja i ka shfaqur në projektor ose fotografitë e printuara e të vendosura në tabelë.

DUKURITË E DËMSHME DHE TË RREZIKSHME: EKSTREMIZMI DHE TERRORIZMI

Mësimi 17

Fjalët kyçe: Ekstremizmi, ideologji, grup ekstremist, dominim, masë sigurie, parimi i letërs.

Ekstremizmi dhe terrorizmi janë dukuri shumë të dëmshme dhe të rrezikshme e, për fat të keq, janë ende të pranishme në disa vende të botës. Fjala *ekstremizmi* ka të bëjë me njerëzit që kanë bindje, botëkuptime ose qëndrime ideologjike krejtësisht të skajshme, d.m.th. ekstreme, të papajtueshme dhe të papranueshme për pjesën dërrmuese të shoqërisë. Ekstremizmi fillon e bëhet problematik dhe i rrezikshëm atëherë kur shëndërrohet në bazë të veprimit publik për të ndryshuar rendin shoqëror e politik. Për t'i realizuar në praktikë ideologjitë e tyre, grupet ekstremiste përdorin metodat më të rrezikshme, më të dhunshme, metoda të dëmshme dhe të palejueshme.

Ekstremizmi si ideologji shfaqet në fusha të ndryshme, por më së shumti në fushën e politikës dhe të religjionit. Grupet ekstremiste janë grupe të organizuara të cilat luftojnë të tjerët me injete të dhunshme, me gjuhë të urrejtjes, me metoda të dominimit dhe të përjashtimit, me pikëpamje dhe botëkuptime ekstremiste të ndërtuara mbi bindje ekskluzive se e drejta dhe e vërteta janë vetëm në anën e tyre. Me fjalë të tjera, ekstremizmi është ideologji e mbështetur në idenë se e vërteta e vetme është ajo që e menden dhe e ndjek grupi ekstremist. Kjo do të thotë se grupet ekstremiste janë grupe që i përdorin të gjitha injetet për realizimin e idesë së tyre. Kjo është mënyrë krejtësisht e gabueshme e mendimit dhe e veprimit, sepse e vërteta është relative dhe ajo nuk i takon vetëm një grupi ose komuniteti, qoftë ai fetar, etnik, racor, kulturor, gjuhësor etj. Prandaj, shumësia e të vërtetave, sikurse edhe e kulturave, etnive, racave, feve etj., është realiteti i



vërtetë në shoqërinë bashkëkohore. Bashkëjetesa dhe paqja mes kombeve, feve, kulturave dhe qytetërimeve janë rruga e vetme e cila duhet të ndiqet. Ekstremizmi nuk e promovon as bashkëjetesën dhe as paqen, por dominimin e një grupi mbi tjetrin.

Dukuri tjetër e dërnshme dhe shumë e rrezikshme është **terrorizmi**. Kjo dukuri definohet si aksion i dhunshëm dhe zakonisht i planifikuar dhe i organizuar që shkakton vdekjen e ndonjë personi ose grupi të njerëzve, por edhe shkatërrim të pronës, shkaktim të pasigurisë së përgjithshme në vend dhe rrezik të përherëshëm. Aktet terroriste i shkaktojnë ekstremistët ose terroristët dhe me këtë duan të bëjnë presion në shoqëri me synim të realizimit të qëllimeve të tyre. Terrorizmi është përhapur në shumë vende të botes dhe tashmë është problem global. Në anën tjetër, qeveritë e vendeve demokratike, organizatat e ndryshme për sigurinë dhe luftimin e terrorizmit, organizojnë aktivitete të ndryshme për t'i parandaluar veprimet terroriste. Si rezultat i kësaj, viteve të fundit janë shtuar shumë masat e sigurisë nëpër aeroporte dhe vendtubime publike.

Mirëpo, për luftimin e dukurive të tilla si ekstremizmi dhe terrorizmi, natyrisht, nuk mjaftojnë masat e sigurisë, por nevojitet një edukim i mirëfilltë e cilësor dhe vetëdijësinë i shoqërisë. Të gjithë njerezit duhet të kuptojnë që janë të barabartë dhe të lirë në mendime dhe shtjete, si dhe që duhet të jenë pranues dhe tolerantë në raport me njerezit që kanë mendime të ndryshme. Diversiteti, bashkëjetesa dhe pranimi i njerëzve ndryshe janë karakteristika të një shoqërie me vlera bashkëkohore. Nëse ne vërejmë raste të ekstremizmit, diskriminimit e të tjera, është e rëndësishme të bashkëpunojmë me institucionet e drejtësisë.



PYETJE:


1. Analizo dukurinë e ekstremizmit dhe trego se pse është e dërnshme dhe e gabuar.
2. Çka është terrorizmi dhe si parandalohet ai?
3. Identifiko disa masa të duhura për luftimin e ekstremizmit dhe të terrorizmit.



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:

Harta e koncepteve

Nxënësit do të mësojnë njohuri të reja duke lexuar dhe analizuar tekstin, dhe duke krijuar skemën apo hartën e koncepteve sipas tekstit.



Përforcimi:

Konsolidim dhe zbatimi i të nxënit

Rrjeti diskutimi

Nxënësit, me ndihmën e mësimitdhënësit, bëjnë një përfundim përmbledhës të temës *Dukuritë e dëmshme dhe të rrezikshme* me pyetjen:

- Cilat do të ishin disa nga masat e duhura për luftimin e ekstremizmit dhe të terrorizmit?

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për mendimet e dhëna dhe për gjykimet e arsyeshme, për komentimin dhe analizimin e ngjarjeve përmes listës së kontrollit.

Detyrë:

Të plotësojë në fletoren e punës për temën *Dukuritë e dëmshme dhe të rrezikshme*.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 24

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi
Lënda: Edukatë qytetare
Shkalla e kurrikulës: 3 **Klasa:** VII
Tema: Vlerat shoqërore, humane dhe qytetare

Rezultatet e të nxënit të temës:

Shpjegon rëndësinë e raportimit të veprimeve të dhunshme dhe aktiviteteve të paligjshme, si: trafikimi i lëndëve narkotike, qenieve njerëzore, detyrimit në punë të rënda, trajtimit johuman të të pambrojturve dhe viktimave të trafikimit të personat dhe institucionet përgjegjëse.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 3, 4, 7, 8; IV. 1, 2, 3, 4, 7; VI. 1, 2, 3, 4, 6, 7.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 4.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Dukuritë e dëmshme: korrupsioni

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Shpjegon çka është korrupsioni;
- Tregon kush është përgjegjës për parandalimin e korrupsionit;
- Identifikon sferat shoqërore ku është i përhapur korrupsioni më shumë;
- Vlerëson mënyrën e veprimit të qytetarëve të cilët mund të ndihmojnë në luftimin e korrupsionit.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen së bashku me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fletë A4, fotografi, burime nga interneti.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë shqipe, Histori, Matematikë.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënësit

Di

- Çka është korrupsioni?
- Me çka ka të bëjë korrupsioni?



DUKURITË E DËMSHME: KORRUPSIONI

Mësimi 18.

Fjalët kyçe: Korrupsion, trajtim i barabartë, shpërdorim, përfitim, personal, mito, rryshet, para publike.

Korrupsioni është dukuri e dëmshme dhe e kundërligjshme, por fatkeqsisht e pranishme. Është dukuri e dëmshme, sepse pengon funksionimin e drejtë dhe efikas të institucioneve, si dhe pengon zhvillimin e përgjithshëm shoqëror dhe mirëqenien e qytetarëve; kurse është e kundërligjshme, sepse është në kundërshtim me ligjin dhe me të drejtat e qytetarëve për trajtim të barabartë. Kjo dukuri, në rend të parë, ka të bëjë me shpërdorimin e pushtetit me qëllim të përfitimit personal. Pra, një formë e korrupsionit është sjellja e kundërligjshme e zyrtarëve në raport me qytetarët, si: detyrimi për të paguar mito ose ndonjë vlerë materiale, detyrimi për të ofruar dhuratat ose favore të tjera të paligjshme. Korrupsioni ka të bëjë edhe me përvetësimin e pasurisë së përbashkët shtetërore, me qëllim të pasurimit të shpejtë, pastaj keqmenaxhimin me qëllim të dëmtimit të pronës publike, përvetësimin të pasurisë publike etj. Përgjegjës kryesorë për luftimin dhe parandalimin e korrupsionit janë qeveria, aktivistët e shoqërisë civile, të cilët raportojnë tek organet e drejtësisë për veprimet e hasura korruptive, si dhe gjithë qytetarët.

Janë të njohura dy lloje të korrupsionit: korrupsioni i madh dhe ai i vogël. I pari ka të bëjë kryesisht me zyrtarët e lartë shtetërorë, biznesmenët dhe personalitete të tjera me ndikim, të cilët abuzojnë me postet, pushtetin, pronën ose paratë publike, për interesa personale, si: pasurimi i shpejtë, përfitimi, ndikimi në vendimmarrje etj.

47

Zyrtarët e korruptuar shpërdorojnë fonde, kërkojnë para ose favore të tjera që kanë të bëjnë ose me pasurinën e shpejtë apo avancimin në karrierë, ose të mirra të tjera materiale dhe sociale. Korrupsion i vogël konsiderohet initoja ose rryshfeti që qytetarët i japin ndonjë zyrtari për kryerjen e ndonjë shërbimi, si rregullimi i ndonjë çështjeje ligjore, juridike, administrative etj. Të dyja këto lloje të korrupsionit janë të dëmshme dhe të kundërligjshme, prandaj duhet të luftohen dhe parandalohen. Përpos mekanizmave të ndryshëm institucionalë, si prokuroria, policia etj., Republika e Kosovës e ka edhe një institucion të veçantë për luftën ndaj korrupsionit, që quhet: "Agjencia Kundër Korrupsionit". Përpos kësaj agjencie, ekzistojnë edhe platforma të shoqërisë civile dhe medieve, në të cilat, po ashtu, qytetarët mund t'i raportojnë veprimet korruptive kur i hasin.

Edhe pse korrupsioni është i ndaluar dhe i ndëshkueshëm sipas ligjit, ai ndodh për shkak se persona të caktuar nuk e respektojnë ligjin. P.sh., nëse paratë e dedikuara për zhvillimin e vendit në aspekte të ndryshme keqpërdoren nga zyrtarë përgjegjës, kemi të bëjmë me një rast të korrupsionit dhe, rrjedhimisht, me shkelje të ligjit.

Një kontribut i qytetarëve në luftimin e korrupsionit është, në rend të parë, që të mos japin inito për shërbimet e veta. Institucionet janë të obliguara t'i kryejnë shërbimet, kurse dhënia e mitos është e ndaluar me ligj - ajo është edhe e panevojshme, sepse zyrtari përgjegjës është i obliguar ta kryejë punën e vet me përgjegjësi. Edhe në rast se zyrtari nuk e kryen punën e vet siç duhet, qytetari nuk duhet të japë inito për një shërbim, sepse kjo do të thotë që edhe ai nuk po e respekton ligjin dhe po kontribuon në rritjen e korrupsionit. Prandaj themi se kryen vepër penale e cila dënohet me ligj. Kontribut i qytetarit në luftimin e korrupsionit konsiderohet edhe lajmërimi i organeve të drejtësisë për rastet kur zyrtari apo ndonjë ndërnjetësues i caktuar kërkon shumë parash ose shërbime të tjera, si kompensim për kryerjen e ndonjë shërbimi.



PYETJE:

1. Argumento pse është i dëmshëm korrupsioni.
2. Analizo mënyrat dhe rolin e qytetarëve në luftimin e korrupsionit.



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:

Dua të di

Nxënësit shkruajnë në fletë A4 pyetjet për të cilat ata dëshirojnë të kenë më shumë informacione. Në tekst ata do t'i gjejnë informatat e kërkuara, do të hulumtohet në internet për më shumë informacione të cilat do të paraqiten në projektor dhe do të analizohen pjesët e caktuara.



Përforcimi:

Konsolidim dhe zbatimi i të nxënit

Mësova

Di	Dua të di	Mësova
Korrupsioni është një antivlerë. Ka të bëjë me keqpërdorimin që zyrtarët i bëjnë nëpër postet e veta, për përfitimet materiale ose favore të tjera.	Sa lloje të korrupsionit kemi? Kush është përgjegjës për luftimin e korrupsionit?	Korrupsioni i madh dhe i vogël. Në rend të parë është qeveria e pastaj qytetarët.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen përmes pyetjeve dhe diskutimit, angazhimit individual dhe në grup, informatave kthyesë.

Detyrë:

T'i plotësojë në fletoren e punës ushtrimet për këtë njësi.

Reflektim për veprimet e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi
Lënda: Edukatë qytetare
Shkalla e kurrikulës: 3 **Klasa:** VII
Tema: Vlerat shoqërore, humane dhe qytetare

Rezultatet e të nxënit të temës:

Shpjegon rëndësinë e respektimit të vlerave humane për funksionimin e një shoqërie të qëndrueshme, si p.sh. paqja, liria, barazia, respektimi i drejtave të njeriut, solidariteti, toleranca, bamirësia, vullnetarizmi, falja, pajtimi, ndihma, empatia, shpëtimi etj., dhe i praktikon këto në jetën e përditshme.

Kontributi në rezultatet për kompetencat

kryesore të shkallës: I. 3, 4, 7, 8; II. 1, 2, 5, 6, 7, 8; III. 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8; .IV. 1, 4, 5, 6, 7; V. 3, 4; VI. 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 3.1.3.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Dukuritë e dëmshme (Përsëritje)

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Sqaron pse liria është kusht i jetës njerëzore dhe i krijimit të të gjitha mundësive për jetën më të mirë;
- Analizon vlerën e tolerancës dhe mungesën e saj te disa persona;
- Dallon llojet e paragjyqimeve dhe kupton rëndësinë e çlirimit prej tyre.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen së bashku me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fletë A4.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë shqipe, Histori.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:
Përgatitja për të nxënë

Pyeten nxënësit:

1. Çfarë rëndësie ka paqja mes popujve dhe shteteve?
2. Cilat janë tiparet e demokracisë?



DUKURITË E DËMSHME: KORRUPSIONI

Mësimi 18.

Fjalët kyçe: Korrupsion, trajtim i barabartë, shpërdorim, përfitim, personal, mito, rryshet, para publike.

Korrupsioni është dukuri e dëmshme dhe e kundërligjshme, por fatkeqsisht e pranishme. Është dukuri e dëmshme, sepse pengon funksionimin e drejtë dhe efikas të institucioneve, si dhe pengon zhvillimin e përgjithshëm shoqëror dhe mirëqenien qytetare; kurse është e kundërligjshme, sepse është në kundërshtim me ligjin dhe me të drejtat e qytetarëve për trajtim të barabartë. Kjo dukuri, në rend të parë, ka të bëjë me shpërdorimin e pushtetit me qëllim të përfitimit personal. Pra, një formë e korrupsionit është sjellja e kundërligjshme e zyrtarëve në raport me qytetarët, si: detyrimi për të paguar mito ose ndonjë vlerë materiale, detyrimi për të ofruar dhurata ose favore të tjera të paligjshme. Korrupsioni ka të bëjë edhe me përvetësimin e pasurisë së përbashkët shtetërore, me qëllim të pasurimit të shpejtë, pastaj keqmenaxhimin me qëllim të dëmtimit të pronës publike, përvetësimit të pasurisë publike etj. Përgjegjes kryesore për luftimin dhe parandalimin e korrupsionit janë qeveria, aktivistët e shoqërisë civile, të cilët raportojnë tek organet e drejtësisë për veprimet e hasura korruptive, si dhe gjithë qytetarët.

Janë të njohura dy lloje të korrupsionit: korrupsioni i madh dhe ai i vogël. I pari ka të bëjë kryesisht me zyrtarët e lartë shtetërorë, biznesmenët dhe personalitete të tjera me ndikim, të cilët abuzojnë me postet, pushtetin, pronën ose paratë publike, për interesa personale, si: pasurimi i shpejtë, përfitim, ndikimi në vendimmarrje etj.

47

Zyrtarët e korruptuar shpërdorojnë fonde, kërkojnë para ose favore të tjera që kanë të bëjnë ose me pasurinën e shpejtë apo avancimin në karrierë, ose të mirra të tjera materiale dhe sociale. Korrupsion i vogël konsiderohet mitorja ose rryshfeti që qytetarët i japin ndonjë zyrtari për kryerjen e ndonjë shërbimi, si rregullimi i ndonjë çështjeje ligjore, juridike, administrative etj. Të dyja këto lloje të korrupsionit janë të dëmshme dhe të kundërligjshme, prandaj duhet të luftohen dhe parandalohen. Përpos mekanizmave të ndryshin institucionale, si prokuroria, policia etj., Republika e Kosovës e ka edhe një institucion të veçantë për luftën ndaj korrupsionit, që quhet: "Agjencia Kundër Korrupsionit". Përpos kësaj agjencie, ekzistojnë edhe platforma të shoqërisë civile dhe medieve, në të cilat, po ashtu, qytetarët mund t'i raportojnë veprimet korruptive kur i hasin.

Edhe pse korrupsioni është i ndaluar dhe i ndëshkueshëm sipas ligjit, ai ndodh për shkak se persona të caktuar nuk e respektojnë ligjin. P.sh., nëse paratë e dedikuara për zhvillimin e vendit në aspekte të ndryshme keqpërdoren nga zyrtarë përgjegjës, kërni të bëjmë me një rast të korrupsionit dhe, rrjedhimisht, me shkelje të ligjit.

Një kontribut i qytetarëve në luftimin e korrupsionit është, në rend të parë, që të mos japin mitorja për shërbimet e veta. Institucionet janë të obliguara t'i kryejnë shërbimet, kurse dhënia e mitorja është e ndaluar me ligj - ajo është edhe e panevojshme, sepse zyrtari përgjegjës është i obliguar ta kryejë punën e vet me përgjegjësi. Edhe në rast se zyrtari nuk e kryen punën e vet siç duhet, qytetari nuk duhet të japë mitorja për një shërbim, sepse kjo do të thotë që edhe ai nuk po e respekton ligjin dhe po kontribuon në rritjen e korrupsionit. Prandaj themi se kryen vepër penale e cila dënohet me ligj. Kontribut i qytetarit në luftimin e korrupsionit konsiderohet edhe lajmërimi i organeve të drejtësisë për rastet kur zyrtari apo ndonjë ndërnjetësues i caktuar kërkon shumira parash ose shërbime të tjera, si kompensim për kryerjen e ndonjë shërbimi.

? PYETJE:
 1. Argumento pse është i dëmshëm korrupsioni.
 2. Analizo mënyrat dhe rolin e qytetarëve në luftimin e korrupsionit.

3. Çfarë rëndësie kanë vlerat në shoqëri?
4. Pse është e rëndësishme të kultivohen paqja dhe harmonia me njëri-tjetrin?
5. Çka është paragjykimi, diskriminimi, përjashtimi social?
6. Çka është ekstremizmi, radikalizmi, terrorizmi?
7. Çka është korrupsioni?



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:

Nxënësit tregojnë rëndësinë e vlerave dhe antivlerave.

Vlera	Antivlera



**Përforcimi:
 Konsolidim dhe zbatimi i të nxënit**

Në mënyrë individuale lexohen mendimet e nxënësve në fletoren e punës. Nxënësit e tjerë mund të drejtohen me pyetje për informacion shtesë.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen përmes pyetjeve dhe diskutimit, angazhimit individual dhe në grup, informatë kthyesë.

Detyrë:

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 26

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi
Lënda: Edukatë qytetare
Shkalla e kurrikulës: 3 **Klasa:** VII
Tema: Pjesëmarrja në vendimmarrjen institucionale

Rezultatet e të nxënit të temës:

Dallon rolin e institucioneve lokale dhe atyre qendrore në vendimmarrje, për rregullimin e jetës së qytetarëve në nivel lokal dhe shtetëror.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: IV. 1, 2, 3, 4, 7; V. 5, 6, 8.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 4.1, 4.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Përgjegjësitë dhe vendimmarrja (në nivelin lokal dhe atë qendror)

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Dallon detyrat dhe përgjegjësitë në vendimmarrje në nivelin lokal dhe qendror;
- Analizon atë se çfarë duhet të dinë qytetarët para se të votojnë dhe të marrin vendime të rëndësishme.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen së bashku me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fletë A4.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Histori.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënët
Stuhi mendimesh

Nxënësve u parashtrihen pyetje:

- Si ndahet pushteti sipas fushave?
- Si ndahet pushteti sipas niveleve?
- Kush bën pjesë në nivelin lokal dhe atë qendror?

Mësimdhënësi/ja dëgjon dhe shkruan në tabelë mendimet e nxënësve pa i pohuar apo mohuar ato, në mënyrë që nxënësit në fund të bëjnë vetëvlerësimin e njohurive paraprake.



PËRGJEGJËSITË DHE VENDIMMARRJA (NË NIVELIN LOKAL DHE ATË QENDROR)

Mësimi E2

Fjalë kyçe: Përgjegjësi vendimmarrje, legjislacion, ekzekutiv, gjyqësor, pushtet lokal, pushtet qendror.

Përgjegjësitë e pushtetit janë të ndara sipas fushave, por edhe sipas niveleve. Më herët e kemi shpjeguar që, sipas fushave, pushteti ndahet në legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor. Por, sipas niveleve, ai ndahet në nivel lokal dhe qendror. Në nivelin lokal bën pjesë kornuna, kurse në atë qendror bëjnë pjesë qeveria, kuvendi dhe gjyqësori. Sikurse sipas fushave, ashtu edhe sipas nivelit të pushtetit, ndahen edhe përgjegjësitë.

Për shembull, në nivelin lokal ose komunal kryhen shërbime për qytetarët, rregullohet infrastruktura lokale, enërtohen rrugët dhe lagjet, funksionojnë zyrat civile ku regjistrohen lindjet dhe vdekjet, lidhen kurorat martesore, por edhe bëhen divorcet. Në komunë regjistrohen pronat, shpërblehet e patundshëritë, inblidhen tatimet etj. Komuna merr vendime për të gjitha bashkësitë lokale, për lagjet dhe për fshatrat që bëjnë pjesë në territorin e komunës.

Në mësimet paraprake kemi mësuar se komuna përbëhet nga shumë drejtori dhe nga asambleja komunale. Nese drejtuesit e këtyre drejtorive janë të përgjegjshëm në vendimmarrje dhe përbushje të nevojave e kërkesave të qytetarëve, atëherë jetesa e tyre përmirësohet. Komuna dhe drejtuesit e saj mbajnë takime dhe debate me qytetarë, në mënyrë që të kuptojnë kërkesat dhe shqetësimet e tyre për së afërmi. Ata duhet të kujdesen dhe të marrin vendime për lagjet e qytetit dhe infrastrukturën e tyre, rrugët, parqet, furnizimin me ujë, menaxhimin e mbeturinave, ndotjen e ajrit, trafikun urban, çerdhet, shkollat dhe kështu kryhen të gjitha shërbimet e nevojshme për gjithë komunën.

49

Më lart shpjeguam se ç'janë përgjegjësitë dhe paramendoni nëse të gjitha këto do të vareshin nga persona zyrtarë të papërgjegjshëm. Kjo do të thotë se shumë shërbime që kryen komuna për qytetarët e vet mbesin të bllokuara, shumë projekte të infrastrukturës mbesin të parelizuara. Kësisoj, pakënaqësitë e qytetarëve dhe presioni i tyre mbij pushtetin komunal rriten. Prandaj, qytetarët duhet të jenë shumë të përgjegjshëm gjatë kohës së votimit për zgjedhjet lokale. Këtu, pra, vjen në shprehje edhe përgjegjësia nga ana e vetë qytetarëve për zgjedhjen e njeriut të parë të komunës, i cili duhet, po ashtu, të jetë shumë i përgjegjshëm.

Kur flasim për përgjegjësitë e nivelit qendror, fjala është për përgjegjësitë e qeverisë së vendit. Vendimet që merren në nivel qendror janë të natyrës madhore dhe vlejne për të gjithë. Përgjegjësitë e qeverisë janë të shumta, por kryesoret janë: funksionimi i ligjit, zhvillimi i demokracisë, respektimi i të drejtave dhe i lirisve themelore të njeriut, zhvillimi i ekonomisë, arsimit, sistemit shëndetësor dhe atij juridik, pastaj ruajtja e rendit dhe ofrimi i sigurisë për të gjithë qytetarët, ruajtja e integritetit territorial dhe sovranitetit të vendit, bashkëpunimi ndërkombëtar etj. Për t'i kryer këto përgjegjësi, emërohen ose zgjidhen zyrtarë nëpër pozita dhe detyra të ndryshme. Secili zyrtar i caktuar në pozitën ose detyrën e vet duhet të punojë me përgjegjësi, si ata që kanë të bëjnë me politikën e brendshme, ashtu edhe ata të politikës së jashtme. Përzgjedhja dhe emërimi i zyrtarëve nëpër pozita shtetërore duhet të bëhet në mënyrë meritokratike, që do të thotë se duhet të emërohen profesionistë të përgjegjshëm dhe me nivel të duhur të edukimit, për t'i kryer punët siç duhet. Prandaj themi që qytetarët duhet të jenë shumë të vëmendshëm dhe të përgjegjshëm kur votojnë, sepse nga ta varet e ardhmja e shtetit.



PYETJE

1. Krahaso dallimet mes detyrave dhe përgjegjësive qytetare.
2. Vlerëso virtutet e njeriut të përgjegjshëm.
3. Identifiko gjërat që duhet të dije qytetari para se të votojë.



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:

Rrjet diskutimi

Duke lexuar dhe diskutuar tekstin e dhënë në libër, ata e kuptojnë rolin e pushtetit qendror dhe atij lokal.

- *Cili është roli i pushtetit qendror dhe atij lokal?*
- *Cilat vendime i merr niveli lokal ?*
- *Cilat janë përgjegjësitë e pushtetit qendror?*
- *Pse është e rëndësishme vota e qytetarëve?*

Së bashku me nxënësit nxjerrim të dhënat e sakta, duke i listuar sipas tabelës së dhënë.

NIVELI LOKAL	NIVELI QENDROR
Komunat	Kuvendi
Asambleistët	Deputetët



Përforcimi:

Konsolidim dhe zbatimi i të nxënit

Truri i Galerisë

Nxënësit në grupe do të paraqesin rëndësinë e zgjedhjeve nga votat e qytetarëve në nivelin lokal dhe atë qendror. Gjatë përshkrimit diskutohet edhe lidhshmëria mes tyre, të përbashkëtat etj.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit do të vlerësohen për njohuritë e treguara, bashkëpunimin dhe diskutimin gjatë analizës dhe aftësitë gjatë përshkrimit.

Detyrë:

Të plotësojë në fletore pune.

● *Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

Mësimi 27

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi
Lënda: Edukatë qytetare
Shkalla e kurrikulës: 3 **Klasa:** VII
Tema: Vlerat shoqërore, humane dhe qytetare

Rezultatet e të nxënit të temës:

Shpjegon rëndësinë e raportimit të veprimeve që janë në kundërshtim me vlerat e shoqërisë demokratike, si: paragjykimet racore ose etnike, diskriminimin gjinor, jotolerancën fetare, përjashtimin social, ekstremizmin, radikalizmin, korrupsionin etj., të personat dhe institucionet përgjegjëse.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: IV. 1, 2, 3, 4, 7; V. 5, 6, 8.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 3.1 3.2.



ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Projekt - prezantime

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Shpjegon veprimet që janë në kundërshtim me vlerat shoqërore;
- Identifikon disa veprime negative të ekstremizmit, terrorizmit dhe korrupsionit.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen së bashku me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fletë A4, projektor, fotografi, ngjyra, flipçart.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Histori, Edukimi për qytetari demokratike.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënësit

Diskutim dhe analizë

Nxënësve u drejtohen pyetjet të cilat ndërlidhen me përgjegjësitë e detyrave:

- *Cilat vlera janë në kundërshtim me vlerat humane?*
- *Çka është korrupsioni?*





Paragjykimi për të tjerët, diskriminimi, përjashtimi social, racizmi, ekstremizmi dhe terrorizmi janë në kundërshtim me vlerat humane.

Diskutohen hapat e realizimit të projekteve dhe ndarjes së detyrave.



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:

Puna në grupe

Nxënësit ndahen në grupe për të punuar nga 1-4 për grup. Secilit grup u ndahen përgjegjësitë, aktiviteti organizohet pa tekstin bazë.

Tema:

Grupi i parë: *Diskriminimi*

Grupi i dytë: *Paragjykimi*

Grupi i tretë: *Përjashtimi social*

Grupi i katërt: *Ekstremizmi dhe terrorizmi*

Grupi i pesët: *Korrupsioni*

Nxënësve u shpërndahen fletë A4, flipçart, hamera, laptop, projektor, ngjyra, fotografi dhe udhëzues se si të punohet aktiviteti.



Përforcimi:

Konsolidim dhe zbatimi i të nxënit

Rrjet diskutimi

Nxënësit prezantojnë punimet e tyre sipas grupeve, duke i vendosur në tabelë ose duke i prezantuar përmes projektorit.

Mësimdhënësi dhe nxënësit parashtrajnë pyetje. Projekti më i mirë vendoset në këndin e projekteve javore.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për përshkrimin e hapave të projektit, realizimit, përzgjedhjes së projektit më të mirë.

Detyrë:

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi
Lënda: Edukatë qytetare
Shkalla e kurrikulës: 3 **Klasa:** VII
Tema: Pjesëmarrja në vendimmarrje institucionale

Rezultatet e të nxënit të temës:

Demonstron njohuri dhe shkathtësi për pjesëmarrje në vendimmarrje në nivel klase, shkollë apo komuniteti që kanë të bëjnë me interesat e bashkëmoshatarëve.

Kontributi në rezultatet për kompetencat

kryesore të shkallës: I. 3, 4, 7, 8; IV.1, 4, 5, 6, 7; V. 1, 2, 3, 5, 6, 7.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 4.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Vendimmarrja në shkollë dhe për shkollën

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Shpjegon se çfarë institucioni është shkolla dhe çfarë roli ka;
- Tregon se kush e përbën shkollën;
- Vlerëson vendimmarrjen në shkollë dhe bashkëpunimin e shkollës me të gjithë akterët që janë pjesë e saj.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen së bashku me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fletë A4, fotografi, burime nga interneti.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë shqipe, Histori, Matematikë.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë

Rrjeti i diskutimit

Ftohet udhëheqësi i shkollës dhe stafi i këshillit të mësimdhënësve, këshilli i prindërve, po ashtu edhe ai i nxënësve. Ata duhet të jenë të përgatitur për këtë qëllim.

Ora mësimore fillon me prezantimin e panelit, ku secili tregon qëllimin dhe rëndësinë e vendimmarrjes në shkollë.



VENDIMMARRJA NË SHKOLLË DHE PËR SHKOLLËN

Fjalët kyçe: Vendimmarrja, shkollë, nxënës, arsimtar, komunitet prindëror

Mësimi 20

Shkolla është institucion që ka për detyrë të edukojë brezat e rinj për t'u bërë të aftë dhe të shkathtë në jetë, të jenë të aftë të kujdesen për vete, t'u ndihmojnë të tjerëve dhe të kontribuojnë në zhvillimin e shtetit. Përveç nxënësve dhe arsimtarëve, si dhe personelit drejtues, aktorë të tjerë të rëndësishëm të shkollës janë edhe prindërit ose komuniteti prindëror, i cili duhet të jetë pjesë e shkollës në mënyrë aktive. Prandaj përgjegjësit dhe angazhimet duhet të jenë të gjithë bashkërisht. Përveç drejtorisë dhe sekretarisë, shkolla ka edhe pedagogun, që është përgjegjës për mbarevajtjen e procesit edukativ dhe tejkalinin e vështirësive që kanë të bëjnë me procesin e mësimit. Shkolla ka edhe psikologun, i cili është përgjegjës për zgjidhjen e problemeve që kanë të bëjnë me sjelljet e nxënësve në shkollë dhe që reflektohen në procesin mësimor. Shkolla ka edhe punëtorët teknikë, të cilët janë përgjegjës për aspektet teknike dhe higjienike të shkollës, si: higjiena, përkatësisht mbajtja e pastërtisë nëpër ambientet shkollore, ngrohja, ajrosja, mirëmbajtja e pajisjeve, furnizimi me pajisje të reja etj.

Krahas personelit që i ka përgjegjësitë e veta, shkolla ka edhe këshillat e niveleve të ndryshme, si: Këshilli i Shkollës, Këshilli i Prindërve, Këshilli i Arsimtarëve dhe Këshilli i Nxënësve. Po ashtu, shkolla formon edhe komisione të ndryshme, si komisioni disiplinor, komisioni ndërmjetësues dhe komisione të tjera që formohen varësisht nga rrethanat, për të zgjidhur ndonjë çështje të rëndësishme.

Kur kësaj i shtojnë edhe klubet e ranguar në bazë të lëndëve, aktiviteteve dhe fushave profesionale, atëherë themi se çdo vendimmarrje arrihet nëpërmjet punës së

përbashkët të të gjithë aktoreve brenda shkollës dhe jashtë saj. Shkolla duhet të jetë e lidhur ngushtë edhe me komunitetin e, po ashtu, me institucione lokale, qendrore, me institucione kulturore, artistike, sportive, ekonomike, qoftë me organizata të shoqërisë civile.

Kush duhet të marrë vendime në shkollë dhe për shkollën? Vendimet që merren në shkollë kanë të bëjnë me përnirësimin e kushteve për mësim, domethënë, në radhë të parë, janë vendime për të mirën e nxënësve e pastaj edhe për të mirën e personelit arsimor e të tjerëve. Shkolla duhet të jetë urë lidhëse midis nxënësit, arsimtarit, prindit dhe komunitetit. Ajo merr përsipër obligimet që caktohen nga institucionet e pushtetit, bashkëpunon me organizata të ndryshme që ofrojnë trajnime për mësimdhënës, merr pjesë në aktivitete të ndryshme kulturore dhe artistike, në shënimin e përvjetorëve të ndryshëm, në bashkëpunimin me shkollat simotra, në gara sportive, organizime vullnetare etj.

Shkolla, gjithashtu, bashkëpunon me organizata të ndryshme dhe kujdeset për mirëmbajtjen e objektit, për ndriçimin, pajisjen me kompjutera, projektore, televizore, tabela të inençura etj. Pra, shkolla është përgjegjëse për furnizimin me inventar sa më bashkëkohor, që të krijojë standarde dhe kushte sa më të mira për nxënësit.

Nxënësit duhet të jenë pjesë e shumë këshillave. Për shembull, për organizimin e ekskursionit duhet të merret edhe mendimi i përfaqësuesve të klasave ose kryetarëve të tyre. Nxënësit, po ashtu, kanë këshillin e vet që i ngjan një parlamenti dhe aty mund të diskutohet dhe të merren vendime të rëndësishme me interes si për shkollën, ashtu edhe për vetë ata. Për pastrimin e objektit shkollor dhe oborrit të saj, mund të merren vendime nga vetë nxënësit vullnetarë. Po ashtu, ata mund të zgjedhin një grup përgjegjës, bashkë me arsimtarin/en e TIK-ut, për mirëmbajtjen e kompjuterave, të uebfaqes së shkollës, për prezantimin e projekteve dhe të ekspozitave në shkollë etj. Nxënësit kanë të drejtë të marrin vendime edhe për organizimin e ndonjë mbledhjeje shoqërore, ore letrare, aktiviteti sportiv etj.

Megjithatë, çdo aktivitet që ndërmarrin nxënësit duhet të jetë i mbikëqyrur, por edhe i përkrahur nga arsimtarët, sepse këta janë përgjegjës për t'u ndihmuar nxënësve, si në përvetësimin e dijeve të reja, përkatësisht zhvillimin e shkathtësive për jetë, ashtu edhe në zhvillimin e aktiviteteve sociale, artistike, sportive etj. Në të gjitha këto mund të marrin pjesë edhe prindërit.



PYETJE:

1. Krahase përgjegjësitë e organeve drejtuese të shkollës dhe vlerëso rëndësinë e punës së tyre.
2. Vlerëso rolin e bashkëpunimit të komunitetit prindëror me shkollën.
3. Çfarë mund të bëni për vendimmarrje më të mirë të nxënësve në shkollë?

52



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: *Marrëdhënie pyetje-përgjigje*

Nxënësit bëjnë pyetje, sidomos rreth vendimmarrjes. Po ashtu, më shumë ndalen te pyetjet rreth planit zhvillimor të shkollës. Nxënësit kanë të drejtë të dijnë për vizionin e shkollës sepse janë pjesë e saj. Zhvillohet një debat në mes panelit dhe audiencës, por gjithmonë nën krijimin e një rendi për diskutim.



Përforcimi: Konsolidim dhe zbatim i të nxënës *Bashkëbisedim*

Bisedohet për të gjitha paqartësitë që kanë nxënësit.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen përmes pyetjeve dhe diskutimit, angazhimit individual dhe në grup, informatë kthyese.

Detyrë:

T'i plotësojë në fletoren e punës ushtrimet për këtë njësi.

Reflektim përvojën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi
Lënda: Edukatë qytetare
Shkalla e kurrikulës: 3 **Klasa:** VII
Tema: Pjesëmarrja në vendimmarrje institucionale

Rezultatet e të nxënit të temës:
 Shpjegon rëndësinë e përfitimit të shoqërisë nga trajtimi i barabartë i të gjithë qytetarëve pa dallim përkatësie gjinore, moshe, sociale, etnike, fetare, racore etj., duke u bazuar në dokumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: V. 5, 6, 8; VI. 1, 2, 4, 7.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 4.1, 4.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Shoqëria civile dhe aktivizmi qytetar

- Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Analizon rolin e shoqërisë civile si pjesë e të drejtave të njeriut;
 - Shpjegon kuptimin e një qytetarie aktive;
 - Vlerëson kontributin e shoqërisë civile në luftimin e dukurive negative.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen së bashku me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fletë A4.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Histori.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi:
Përgatitja për të nxënësit
Parashikim me fjalë kyçe

Në tabelë vendosim fjalët kyçe. Nga nxënësit kërkohet që të formulojnë fjali me fjalët kyçe dhe që japin një fakt apo informacion lidhur me temën.





Shoqëria civile, përmes veprimtarive të ndryshme, shërben edhe si kritikuese e qeverisë, duke u angazhuar për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave dhe lirisë civile të qytetarëve.

Shoqëria bashkëkohore, sa më shumë që e ka të zhvilluar këtë sektor, aq më e organizuar konsiderohet. Shpesh kemi dëgjuar fjalën "qytetari aktive", që nënkupton se, në rast të shkeljes së ndonjë të drejte njerëzore, ose të ndonjë padrejtësie nga ana e qeveritarëve apo pushtetit, qytetarët, përmes organizatave dhe rrjeteve të tyre, mbledhen dhe protestojnë, shtrojnë kërkesa ose bëjnë peticione për ta zgjidhur problemin dhe për ta rikthyer drejtësinë në vend.

Për zhvillimin dhe funksionimin e shoqërisë civile, për mundësinë e përfshirjes dhe pjesëmarrjes së qytetarëve, sidomos të të rinjve në të, qeveria duhet të ndërtojë mekanizma ligjorë që t'ua mundësojë këtë të drejtë. Se pari, Kushtetuta dhe ligjet e saj duhet:

- të mbrojnë të drejtën dhe lirinë e angazhimeve në këtë sektor;
- të krijojnë mundësi që qytetarët të aplikojnë dhe të përfshihen në projekte vendore, rajonale dhe ndërkombëtare.

54



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:

Ditari dypjesësh

Udhëzohen nxënësit se si do ta zhvillojnë temën. Ata do të marrin citatin që do t'i caktohet dhe do ta komentojnë me fjalët e tyre.

Citati mund të ndahet me radhë ose sipas numrave të nxënësve në ditat.

Fillimisht komentet shkruhen në fletore, pastaj jepen komentet me gojë nga të gjithë nxënësit.

CITATI	KOMENTI
Aktivizmi qytetar	
Shoqëria civile	
Qytetari aktive	



Përforcimi:

Konsolidim dhe zbatim i të nxënit

Kartela dalëse

Nxënësve u shpërndahen fletë A4 dhe u kërkohet të shkruajnë mendimet e tyre rreth *Luftimit të dukurive negative përmes shoqërisë civile*, dhe mund të parashtrojnë ndonjë pyetje nëse kanë pasur diçka të paqartë.

Luftimi i dukurive negative përmes shoqërisë civile:

Pyetje _____

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit do të vlerësohen për angazhimin gjatë gjithë orës mësimore.

Detyrë:

Të përgjigjen në pyetjen *Pse çmohet qytetaria aktive në shoqërinë demokratike?*

• *Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

• _____

• _____

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi
Lënda: Edukatë qytetare
Shkalla e kurrikulës: 3 **Klasa:** VII
Tema: Pjesëmarrja në vendimmarrje institucionale

Rezultatet e të nxënit të temës:
 Shpjegon se si secili qytetar i moshës madhore mund të bëhet pjesë e institucioneve vendimmarrëse të nivelit lokal dhe qendror.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: V. 5, 6, 8; VI. 1, 2, 4, 7.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 4.1, 4.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Përfshirja në vendimmarrje

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Analizon raportin ndërmjet përgjegjësisë dhe vendimmarrjes;
- Vlerëson cilësitë e një vendimmarrësi të drejtë dhe përfitimet nga persona të tillë;
- Dallon llojet e vendimmarrjes dhe kompetencat që duhet pasur.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fletë A4, projektori.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
 Edukimi për qytetari demokratike, Histori.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:
Përgatitja për të nxënë
Stuhi mendimesh

Ora mësimore fillon duke përsëritur njësinë e kaluar në formë diskutimi me nxënësit. Për kohën sa është duke u zhvilluar diskutimi, synohet që të ndërlidhet me njësinë e re mësimore *Përfshirja në vendimmarrje*. Mendimet e nxënësve shënohen në tabelë dhe diskutohen së bashku.



PËRFSHIRJA NË VENDIMMARRJE

Fjalët kyçe: Përfshirja, progres, rregullorë, strategji, referendumi, kushtetutë, ligj, qeveri

Mësimi 22

Meqenëse jetojmë në një vend demokratik, çështja e përfshirjes në vendimmarrje është shumë e rëndësishme dhe duhet të diskutohet. Niveli i zhvillimit të demokracisë dhe progresi i një vendi pasqyrohet nga ajo se sa qytetarët, pa dallim gjinie, etnie, race e kulture, janë të përfshirë në vendimmarrje. Në sistemet demokratike, vendimmarrja është përgjegjësi shumënivlele institucionale. Me vendimet e tyre, zyrtarët shtetërorë nëpër pozita vendimmarrëse duhet të reflektojnë interesin, nevojat dhe vullnetin e qytetarëve të vendit. Këto vendime merren në përputhje me aktet ligjore në fuqi, nga Kushtetuta si akti më i lartë juridik i shtetit, e deri te ligjet, udhëzimet administrative, rregulloret e ndryshme, strategjitë etj. Është jetike për mirëfunksionim demokratik të vendit që qytetarët të përfshihen në vendimmarrje. Përfshirja mund të jetë e drejtpërdrejtë, siç është rasti me Referendumin (i cili në Republikën e Kosovës nuk është i lejuar me Kushtetutë) ose në nivele më të ulëta hierarkike të sistemit, ku pjesëtarët e komunitetit përfshihen në vendimmarrje konsensuale ose me votim, si për shembull, në shkollë, në bashkësi lokale, në lagje etj. Nëpër shkollë, për shembull, nxënësit, mësuesit, arsimtarët, pedagogët etj., nën menaxhimin e drejtorit, mund të përfshihen në vendimmarrje të drejtpërdrejtë. Edhe banorët e një lagjeje mund të organizohen dhe të marrin bashkërisht vendime për çështje me interes të përbashkët.

Pjesëmarrja jo e drejtpërdrejtë është më e theksuar në sistemet demokratike, thjesht për shkak se shoqëritë bashkëkohore janë më komplekse dhe përgjegjësitë e vendimmarrjes delegohen nëpër nivelet përkatëse të sistemit. Meqenëse, siç e përmendim më lart, vendimmarrja bëhet sipas akteve ligjore në fuqi, është thelbësore për një shoqëri demokratike që në hartimin e këtyre akteve të jenë të përfshirë qytetarët. Përfshirja bëhet në forma të ndryshme. Ligjet, për shembull, den sa të hyjnë në fuqi, kalojnë nëpër disa faza të hartimit. Rëndom, Qeveria sponsorizon ligje. Kjo do të thotë se ajo ndërmerr nisima ligjore duke krijuar grup punues që është përgjegjës për të hartuar një draft, i cili, më pas, u nënshtrohet dëgjimeve publike, të cilat i organizon ministria përkatëse. Dëgjimet publike organizohen edhe në Kuvend pasi projektligji i sponsorizuar nga Qeveria të dërgohet për procedim të mëtejshëm në Kuvend. Kështu që, dëgjimet publike janë mundësi.

56

përmes të cilave qytetarët në mënyrë jo të drejtpërdrejtë marrin pjesë në vendimarrje, duke qenë se behen hisedarë në krijimin e kornizës ligjore, në përputhje me të cilën merren vendimet përkatëse.

Pse qenka kaq i rëndësishëm procesi i vendimarrjes? Vendimet, shpeshherë, janë personale, por ka edhe që janë në nivel grupi ose institucioni, si për shembull shkollat, ku vendimarrja ka të bëjë me çështje të ndryshme, si pjesëmarrja në lojë, në gara sportive, në vlerësim, në kuize etj. Nëse, ta zërnë, juve ju besohet roli i arbitrit në ndonjë aktivitet sportiv, gofite futboll, gofite basketboll etj., atëherë ju duhet të përqendrohemi inritë dhe të merrni vendime të drejta për sjelljet e secilit lojtar dhe për rrjedhën e lojës në tërësi. Vendimet e drejta nënkuptojnë trajtimin e barabartë, fer dhe jodiskriminues për secilin/en. Kështu, pa marrë parasysh rezultatit, të gjithë mund të ndihen të kënaqur me trajtimin që u bëhet gjatë lojës. Ndodh që vendimet të jenë grupore, që do të thotë se janë kater ose pesë vete që duhet të marrin vendim, e jo vetëm një, siç është rasti me gjyqtarin në lojë. Për shembull, gjatë garës muzikore në këndim, është komisioni profesional që



merr vendim për një kandidat dhe prej vendimit të komisionit varet se kush do të vazhdojë në tutje garën e kush jo. Prandaj vendimet nuk janë asnjëherë të lehta, mirëpo, nëse jemi të drejtë në vlerësim dhe gjykim dhe nëse paraprakisht i kemi caktuar kriteret, mbi të cilat do të merren vendimet, atëherë kjo do ta lehtësojë vendimarrjen.

Kush ka të drejtë të përfshihet në vendimarrje e kush jo? Duhet të dimë se për një vendimarrje të drejtë dhe të përgjegjshme gjithmonë duhet të punohet me kujdes, profesionalizëm, korrektësi, drejtësi, përkushtim dhe me standarde të parapara me rregullore, ligj ose kushtetutë. Këto pra janë parakushtet që e karakterizojnë një vendimarrje të drejtë. Për fat të keq, jo të gjithë njerëzit i kanë këto cilësi, prandaj është me rëndësi të dihet se kush merr vendime dhe kush vlerëson, si për mirë, ashtu edhe për keq, mbi çfarë baze është marrë një vendim i caktuar, a ka qenë i drejtë apo i padrejtë ai vendim, çfarë efektesh ose pasojash sjell etj. Pra, vendimarrja mund të jetë e niveleve të ndryshme. Me këtë nënkuptojmë që ajo mund t'u takojë niveleve të ndryshme të pushtetit. Për disa çështje merret vendim në nivelin e pushtetit lokal, për disa të tjera në nivelin e pushtetit qendror. Por, për disa çështje të tjera, si për shembull për anëtarësimin e Kosovës në Bashkimin Evropian (BE), në Organizatën e Kombeve të Bashkuara (OKB), në UNESCO

57



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Lexim (përmbledhje në dyshe)

Udhëzohen nxënësit që të punojnë në dyshe. Njësia e re mësimore ndahet në paragrafë; njëri nga nxënësit i lexon paragrafët dhe i përmbledh, ndërsa tjetri bën pyetje.

Rëndësi u kushtohet përgjigjeve për pyetjet:

- Pse është kaq i rëndësishëm procesi i vendimarrjes?
- Çka nënkupton me vendimet e drejta?
- Kush ka të drejtë të përfshihet në vendimarrje e kush jo?



Përforcimi: Konsolidim dhe zbatimi i të nxënit Organizues grafik

Në formë përmbledhëse, nxënësit përmes organizuesit grafik shkruajnë atë që mësuam.



Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për mënyrën e shprehjes së mendimeve dhe për saktësinë e përgjigjeve.

Detyrë:

T'i identifikojë cilësitë e një vendimarrësi korrekt.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 31

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Edukatë qytetare

Shkalla e kurrikulës: 3 **Klasa:** VII

Tema: Pjesëmarrja në vendimmarrje institucionale

Rezultatet e të nxënit të temës:

Dallon rolin e institucioneve lokale dhe atyre qendrore në vendimmarrje për rregullimin e jetës së qytetarëve në nivel lokal dhe shtetëror.

Kontributi në rezultatet për kompetencat

kryesore të shkallës: I. 3, 4, 7, 8; IV.1, 4, 5, 6, 7; V. 3, 4; VI. 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7.

Kontributi në rezultatet e fushës së

kurrikulës: 4.1, 4.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Përfshirja në vendimmarrje (Përsëritje)

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Dallon detyrat dhe përgjegjësitë dhe rolin e tyre në vendimmarrje të nivelit lokal dhe qendror;
- Shpegon se çfarë institucioni është shkolla dhe kush e përbën atë si dhe roli i saj;
- Vlerëson për vendimarrjen në shkollë dhe për bashkëpunimin e shkollës me të gjithë akterët që janë pjesë e saj.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Video, fletë A4.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Histori.



PËRFSHIRJA NË VENDIMMARRJE

Fjalët kyçe: Përfshirja, progres, mequllorë, strategji, referendumi, kushtetutë, ligj, qeveri

Meqenëse jetojmë në një vend demokratik, çështja e përfshirjes në vendimmarrje është shumë e rëndësishme dhe duhet të diskutohet. Niveli i zhvillimit të demokracisë dhe progresi i një vendi pasqyrohet nga ajo se sa qytetarët, pa dallim gjinie, etnie, race e kulture, janë të përfshirë në vendimmarrje. Në sistemet demokratike, vendimmarrja është përgjegjësi shumënivlele institucionale. Me vendimet e tyre, zyrtarët shtetërorë nëpër pozita vendimmarrëse duhet të reflektojnë interesin, nevojat dhe vullnetin e qytetarëve të vendit. Këto vendime merren në përputhje me aktet ligjore në fuqi, nga Kushtetuta si akti më i lartë juridik i shtetit, e deri te ligjet, udhëzimet administrative, rregulloret e ndryshme, strategjitë etj. Është jetike për mirëfunksionim demokratik të vendit që qytetarët të përfshihen në vendimmarrje. Përfshirja mund të jetë e drejtpërdrejtë, siç është rasti me Referendumin (i cili në Republikën e Kosovës nuk është i lejuar me Kushtetutë) ose në nivele më të ulëta hierarkike të sistemit, ku pjesëtarët e komunitetit përfshihen në vendimmarrje konsensuale ose me votim, si për shembull, në shkollë, në bashkësi lokale, në lagje etj. Nëpër shkollë, për shembull, nxënësit, mësuesit, arsimtarët, pedagogët etj., nën menaxhimin e drejtorit, mund të përfshihen në vendimmarrje të drejtpërdrejtë. Edhe banorët e një lagjeje mund të organizohen dhe të marrin bashkërisht vendime për çështje me interes të përbashkët.

Pjesëmarrja jo e drejtpërdrejtë është më e theksuar në sistemet demokratike, thjesht për shkak se shoqëritë bashkëkohore janë më komplekse dhe përgjegjësitë e vendimmarrjes delegohen nëpër nivelet përkatëse të sistemit. Meqenëse, siç e përmendim më lart, vendimmarrja bëhet sipas akteve ligjore në fuqi, është thelbësore për një shoqëri demokratike që në hartimin e këtyre akteve të jenë të përfshirë qytetarët. Përfshirja bëhet në forma të ndryshme. Ligjet, për shembull, den sa të hyjnë në fuqi, kalojnë nëpër disa faza të hartimit. Rëndom, Qeveria sponsorizon ligje. Kjo do të thotë se ajo ndërmerr nisim ligjore duke krijuar grup punues që është përgjegjës për të hartuar një draft, i cili, më pas, u nënshtrohet dëgjimeve publike, të cilat i organizon ministria përkatëse. Dëgjimet publike organizohen edhe në Kuvend pasi projektligji i sponsorizuar nga Qeveria të dërgohet për procedim të mëtejshëm në Kuvend. Kështu që, dëgjimet publike janë mundësi,

56

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënësit

Diskutim për njohuritë paraprake

Nxënësit diskutojnë për njësinë e orës mësimore të kaluar.



përnes të cilave qytetarët në mënyrë jo të drejtpërdrejtë marrin pjesë në vendimarrje, duke qenë se behen pjesë të krijimit të komitëve ligjore, në përputhje me të cilën merren vendimet përkatëse.

Pse qenka kaq i rëndësishëm procesi i vendimarrjes? Vendimet, shpeshherë, janë personale, por ka edhe që janë në nivel grupi ose institucioni, si për shembull shkollat, ku vendimarrja ka të bëjë me çështje të ndryshme, si pjesëmarrja në lojë, në gara sportive, në vlerësim, në kuize etj. Nëse, ta zërnë, juve ju besohet roli i arbitrit në ndonjë aktivitet sportiv, gofë futboll, gofë basketboll etj., atëherë ju duhet të përqendrohni inrit dhe të merrni vendime të drejta për sjelljet e secilit lojtar dhe për rrjedhën e lojës në tërësi. Vendimet e drejta nënkuptojnë trajtimin e barabartë, fer dhe jodiskriminues për secilin/en. Kështu, pa marrë parasysh rezultatit, të gjithë mund të ndihen të kënaqur me trajtimin që u bëhet gjatë lojës. Ndodh që vendimet të jenë grupore, që do të thotë se janë kater ose pesë vetë që duhet të marrin vendim, e jo vetëm një, siç është rasti me gjyqtarin në lojë. Për shembull, gjatë garës muzikore në këndim, është komisioni profesional që



merr vendim për një kandidat dhe prej vendimit të komisionit varet se kush do të vazhdojë në tutje garën e kush jo. Prandaj vendimet nuk janë asnjëherë të lehta, mirëpo, nëse jemi të drejtë në vlerësim dhe gjykim dhe nëse paraprakisht i kemi caktuar kriteret, mbi të cilat do të merren vendimet, atëherë kjo do ta lehtësojë vendimarrjen.

Kush ka të drejtë të përfshihet në vendimarrje e kush jo? Duhet të dimë se për një vendimarrje të drejtë dhe të përgjegjshme gjithmonë duhet të punohet me kujdes, profesionalizëm, korrektesë, drejtësi, përkushtim dhe me standarde të parapara me rregullore, ligj ose kushtetutë. Këto pra janë parakushtet që e karakterizojnë një vendimarrje të drejtë. Për fat të keq, jo të gjithë njerëzit i kanë këto cilësi, prandaj është me rëndësi të dihet se kush merr vendime dhe kush vlerëson, si për mirë, ashtu edhe për keq, mbi çfarë baze është marrë një vendim i caktuar, a ka qenë i drejtë apo i padrejtë ai vendim, çfarë efektesh ose pasojash sjell etj. Pra, vendimarrja mund të jetë e niveleve të ndryshme. Me këtë nënkuptojmë që ajo mund t'u takojë niveleve të ndryshme të pushtetit. Për disa çështje merret vendim në nivelin e pushtetit lokal, për disa të tjera në nivelin e pushtetit qendror. Por, për disa çështje të tjera, si për shembull për anëtarësimin e Kosovës në Bashkimin Evropian (BE), në Organizatën e Kombeve të Bashkuara (OKB), në UNESCO

57



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Pyetja sjell pyetjen

1. Kush vendos dhe çfarë vendos?
2. Si mund të organizohet vendimarrja në mënyrë demokratike dhe efektive?
3. Cili është roli dhe përgjegjësia e drejtorit të shkollës?



Përforcimi: Konsolidim dhe zbatimi i të nxënët Shkrim i lirë

Në pjesën e tretë, nxënësit i lexojnë objektivat që i kanë zgjedhur sipas dëshirës dhe i komentojnë. Për shembull për varfërinë, pabarazinë, klimën, degradimin e mjedisit, prosperitetin, paqen, drejtësinë.

Kjo detyrë është e vazhdimit nga ora e kaluar, sepse orën e kaluar nuk kanë arritur të gjithë ta përfundojnë.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për mënyrën e shprehjes së mendimeve dhe për saktësinë e përgjigjeve.

Detyrë:

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Edukatë qytetare

Shkalla e kurrikulës: 3 **Klasa:** VII

Tema: Mjedisi dhe mirëqenia

Rezultatet e të nxënit të temës:

Shpjegon rëndësinë dhe demonstroi shkathhtësitë e kursimit të ujit, të energjisë elektrike, të ruajtjes së gjelbërimit, të riciklimit të mbeturinave, të kultivimit të bimëve, të mbrojtjes së kafshëve në aspektin dhe funksionin e mirëqenies ekonomike, shëndetësore dhe sociale.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 3, 4, 7, 8; IV. 1, 4, 6, 7; V. 3, 4;

VI. 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 5.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: 17 objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Shpjegon rëndësinë e caktimit të objektivave për zhvillim të qëndrueshëm;
- Numëron disa prej sfidave aktuale me të cilat ballafaqohet njerëzimi;
- Vlerëson afatin e Kombeve të Bashkuara për realizimin e këtyre objektivave.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fletë A4, foto, burime nga interneti.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë shqipe, Histori.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënësit

Ditari dypjesësh

Në fillim të orës mësimore, nxënësit paralajmërohen që të përgatiten për shikimin e një videoje; gjatë shikimit të saj të mbajnë shënime.



17 OBJEKTIVAT E ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM

Mësimi 23

Fjalët kyçe: Objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm, Kombe të Bashkuara, qëndrueshmëri.

Kombet e Bashkuara kanë caktuar disa objektiva dhe një afat për realizimin e tyre në lidhje me zhvillimin e qëndrueshëm. Lidhur me këtë, ato thonë: "Objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm na shpiten drejt arritjes së një të ardhmeje më të mirë dhe më të qëndrueshme për të gjithë. Ata u përgjigjen sfidave botërore me të cilat po ballafaqohemi, sidomos atyre që lidhen me varfërinë, papabarazitë, klimën, degradimin e mjedisit, prosperitetin, paqen dhe drejtësinë. Objektivat janë të ndërlidhur mes vete dhe, pa përjashtim, secili prej tyre duhet të realizohet deri në vitin 2030."



59

Objektivat:

1. Eliminimi i varfërisë.
2. Eliminimi i urisë dhe ngritja e cilësisë së të ushqyerit.
3. Sigurimi i jetës së shëndetshme dhe mirëqenies së njerezve të të gjitha moshave.
4. Arsimi cilësor e gjithëpërfshirës dhe drejta e njerezve për të mesuar gjatë gjithë jetës.
5. Arritja e barazisë gjinore dhe fuqizimi i grave dhe i vajzave.
6. Sigurimi i pajisjes dhe administrimi i qëndrueshëm i ujësjellësve dhe kanalizimeve për të gjithë.
7. Sigurimi i energjisë së qëndrueshme e inoerne dhe inoernin të përballueshëm.
8. Nxitja e rritjes ekonomike të vazhdueshme përmes punësimit në kushte humane dhe të denja për të gjithë.
9. Ndërtimi i infrastrukturës së qëndrueshme, nxitja e industrializimit gjithëpërfshirës dhe nxitja e inovacionit.
10. Zvogëlimi i pabarazisë brenda vendeve dhe ndërmjet tyre.
11. Kthimi i qyteteve në vendbanime gjithëpërfshirëse, jo të rrezikshme, rezistuese dhe të qëndrueshme.
12. Sigurimi i modeleve të qëndrueshme të konsumit dhe të prodhimit.
13. Lufta kundër ndryshimit klimatik dhe efekteve të tij.
14. Ruajtja dhe përdorimi i qëndrueshëm i oqeanëve, i deteve dhe i burimeve detare.
15. Mbrojtja, restaurimi dhe nxitja e përdorimit të qëndrueshëm të ekosistemeve tokësore, administrimi i qëndrueshëm i pyjeve, lufta kundër kthimit të hapësirave të gjelbra në shkretëtirë, ndalimi i degradimit të tokës dhe humbjes së biodiversitetit.
16. Nxitja e shoqërive paqësore dhe gjithëpërfshirëse për zhvillimin e qëndrueshëm, duke ofruar drejtësi për të gjithë, përmes ngritjes së institucioneve efektive, llogaridhënëse dhe gjithëpërfshirëse, në të gjitha nivelet.
17. Fuqizimi i mënyrave të venies në zbatim dhe rigjallërimi i partneritetit botëror për zhvillim të qëndrueshëm.



PYETJE:

1. Pse është me rëndësi faktimi i objektivave për zhvillim të qëndrueshëm?
2. Përzgjidh dhe analizo disa nga sfidat me të cilat ballafaqohet njerëzimi sot.
3. A mendon që mund të realizohen të gjithë objektivat brenda afatit që është caktuar? Argumento.

60

<https://www.un.org/sustainabledevelopment/fr/objectifs-de-developpement-durable/>

Pasi ta shikojnë videon, nxënësit japin mesazhin përcjellës që del nga kjo mbledhje e Kombeve të Bashkuara.



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:
Realizimi i ditarit

Ditari përmban 17 pika, përveç këtyre pikave nxënësit shfrytëzojnë edhe materialin e Edukatës qytetare 7.



Përforcimi:
Konsolidim dhe zbatimi i të nxënit
Komentimi

Secili nxënës do të marrë nga dy objektiva, ku secili do të japë komentim për to.

Për shembull: për varfërinë, pabarazinë, klimën, degradimin e mjedisit, prosperitetit, paqen, drejtësinë etj.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për mënyrën e shprehjes së mendimeve dhe për saktësinë e përgjigjeve.

Detyrë:

Të plotësojë në fletoren e punës ushtrimet për këtë njësi.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Edukatë qytetare

Shkalla e kurrikulës: 3 **Klasa:** VII

Tema: Mjedisi dhe mirëqenia

Rezultatet e të nxënit të temës:

Identifikon dhe analizon masat mbrojtëse të organizatave dhe institucioneve përkatëse për mjedisin, që vepron në komunë dhe në nivel vendi, si: parandalimin e ndotjes së ujit, ajrit, tokës, pastaj kufizimin e gjuetisë, keqtrajtimit e kafshëve etj.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:

I. 3, 4, 7, 8; IV. 1, 4, 5, 6, 7; V. 3, 4; VI. 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:

5.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Ekoqytetaria

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Shpjegon se çka është ekoqytetaria dhe si të bëhemi ekoqytetarë;
- Vlerëson shprehitë, sjelljet dhe veprimet e jetës së përditshme të një ekoqytetari;
- Analizon disa veprime që i takojnë ekoqytetarisë e që janë prioritare për natyrën dhe shëndetin.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Gjuhë shqipe, Histori, Gjeografi, Biologji.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë

Organizues grafik

Fillimisht nxënësit do të njoftohen me temën *Ekoqytetaria*.

Më pas, nxënësit do të ndahen në tri grupe. Secili grup e lexon nga një pjesë të njësisë mësimore. Grupeve të nxënësve u jepet i printuar në fletë një model i organizuesit grafik, i cili do të plotësohet në bazë të pjesës së lexuar nga nxënësi.

EKOQYTETARIA

Fjalët kyçe: Ekoqytetari, bashkupitja, kompostimi, riciklimi, kopsht, SR

Ekoqytetaria është bindje, pikëpamje ose botëkuptim, por edhe praktikë njerëzore, sipas së cilës njerëzit, në vendbanimin, shtetin apo kontinentin ku jetojnë, duhet të jenë ekoqytetarë e jo vetëm qytetarë. Të jesh ekoqytetar do të thotë që jo vetëm se duhet të jesh kundër veprimeve të dëmshme ndaj mjedisit e të mos jesh indiferent ndaj veprimeve shkatërruese ndaj tij, por edhe të jesh proaktiv në veprimet në ruajtjen e tij. Ndër të tjera, do të thotë të jesh i vetëdijshëm se çfarë dëmsh mund t'i shkaktojë mjedisit në nivel lokal, rajonal dhe global me veprimet e tua. Megjithatë, nuk mjafton vetëm të jesh i vetëdijshëm, por edhe i gatshëm dhe i vullnetshëm që veprimet e dëmshme t'i zëvendësosh me ato më pak të dëmshme, nëse nuk ka alternativa të tjera, ose me veprime krejtësisht të mira për mjedisin. Pra, ekoqytetar nuk të bëjnë vetëm vetëdija dhe njohuria për veprimet e tua të përditshme, por edhe gatishmëria për t'i ndërruar ato - për t'i zëvendësuar me veprime të mira.



Lista e mëposhtme paraqet një listë veprimesh që i takojnë ekoqytetarisë. Kini parasysh se ka edhe shumë veprime të tjera që i takojnë ekoqytetarisë, por këto janë më kryesoret:

1. Bëni kompostimin në shtëpi (kjo do të thotë t'i ndani materialet me bazë organike në një vend dhe t'i përdorni ato pastaj për ta plehëruar tokën në kopsht!)
2. Bëni riciklimin në shtëpi (kjo do të thotë t'i bëni disa modifikime të gjërave të vjetra për t'i ripërdorur ato për funksione të reja!)
3. Bëni kopsht në shtëpi, në shkollë ose komunitet!
4. Fikni dritat kur nuk ju duhen!
5. Kufizoni shpenzimet e ujit!
6. Praktikoni ecjen ose përdorni biçikletën a autobusin!
7. Mbani një shishe ujë me vete kur udhëtoni dhe rinbusheni atë në krrua kur të jetë e nevojshme!
8. Kur shkoni për të blerë diçka, ripërdorni qeset të cilat i keni blerë më herët!
9. Kur printoni, përdorni të dyja anët e letres!
10. Jepni si dhuratë rrobat e përdorura, videomaterialet, librat etj.!
11. Mbillni drurë!
12. Praktikoni 3R-në - reduktimi, ripërdorimi dhe riciklimi!
13. Lani rrobat me ujë të ftohtë!
14. Ricikloni celularët e vjetër dhe pajisjet elektronike!
15. Proveni t'i riparoni gjësendet para se t'i blini të reja!
16. Kujdesu gjithmonë për gjërat e tua!



PYETJE

1. Analizo se çka është ekoqytetaria.
2. Dëshmo praktikisht çka do të thotë të jesh ekoqytetar.
3. Identifiko disa veprime që i takojnë ekoqytetarisë.

62



Përforcimi: **Konsolidim dhe zbatim i të nxënësve** *Komentimi*

Secili nxënës do të marrë nga dy objektiva, ku secili do të japë komentimin për to.

Për shembull: për varfërinë, pabarazinë, klimën, degradimin e mjedisit, prosperitetit, paqen, drejtësinë etj.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për mënyrën e shprehjes së mendimeve dhe për saktësinë e përgjigjeve.

Detyrë:

Të plotësojnë në fletoren e punës ushtrimet për këtë njësi.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: *Ditari dypjesësh*

Nxënësit, të ndarë në grupe, do të lexojnë pjesët që u janë caktuar të njësisë mësimore, me ç'rast udhëzohen të mbajnë shënime gjatë leximit të tyre. Ndërkohë, derisa nxënësit i lexojnë pjesët e tyre, vizatohet një tabelë e ndarë në dy pjesë. Pas përfundimit të leximit, nxënësve u kërkohet të tregojnë pjesët që kanë zgjedhur dhe t'i lexojnë komentet e tyre lidhur me çështjet.

Ja një shembull se si mund të duket ditari dypjesësh, pas përgjigjeve të nxënësve:

Çështje	Përgjigje (koment)
Shkaqet e ndotjes	Natyrore Aktivitetet njerëzore etj.
Format e ndotjes:	Ndotja e ajrit; Ndotja e ujërave; Ndotja akustike; Ndotja e tokës.
Pasojat:	Dëmtimi i ekosistemeve dhe i gjallesave; Dëmtimi i shëndetit të njeriut; Trajtimi i dëmtimeve ka kosto ekonomike; Dëmtimi i mjedisit sjell probleme sociale.

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi
Lënda: Edukatë qytetare
Shkalla e kurrikulës: 3 **Klasa:** VII
Tema: Mjedisi dhe mirëqenia

Rezultatet e të nxënit të temës:

Identifikon dhe analizon masat mbrojtëse të organizatave dhe institucioneve përkatëse për mjedisin, që veprojnë në komunë dhe në nivel vendi, si: parandalimin e ndotjes së ujit, të ajrit, të tokës, pastaj kufizimin e gjuetisë, keqtrajtimin e kafshëve etj.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: V. 5, 6, 8; VI. 1, 2, 4, 7.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 5.1, 5.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Trajtimi human i kafshëve

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Shpreh ndjeshmërinë pse duhet të jemi më dashamirës ndaj kafshëve;
- Dallon mënyrat se si janë shfrytëzuar kafshët në të kaluarën e largët dhe vetëdijësimin në kohën e sotme;
- Arsyeton pse ka ligje dhe organizata që i mbrojnë të drejtat e kafshëve dhe mënyrat e kujdesit ndaj tyre.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fletë A4, projektor

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Edukimi për qytetari demokratike, Gjeografia.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:
Përgatitja për të nxënë
Stuhi mendimesh

Fillimisht nxënësit do të njoftohen me temën *Ekoqytetaria*.

Nxitet të menduarit e nxënësve duke parashtruar pyetjen: - *Si duhet t'i trajtojmë kafshët?*

Nxënësit mendojnë për pak minuta dhe përgjigjet e tyre i shkruajmë në tabelë.



TRAJTIMI HUMAN I KAFSHËVE

Mësimi 25

Fjalët kyçe: Kafshë, trajtim, human, hapësirë jetësore, ligje, të drejtat e kafshëve.

Të gjitha kafshët duhet t'i trajtojmë në mënyrë humane. Kjo do të thotë se duhet të jemi shumë dashamirës, shumë miqësorë dhe shumë humanë ndaj tyre. Pse? Sepse, së bashku me kafshët dhe bimët, ne e ndajmë hapësirën jetësore. Mund të bëhen krahasime dhe shumë dallime ndërmjet mënyrës si jetojnë njerëzit dhe si kafshët, por gjithashtu duhet të dimë se ne dhe kafshët e kemi një gjë të rëndësishme të përbashkët - hapësirën jetësore që na e ofron planeti Tokë.

Nuk është se e kemi të përbashkët vetëm hapësirën jetësore dhe natyrën, por kemi edhe shumë gjëra të tjera të përbashkëta me kafshët: ne lindim, rritemi, zhvillohemi, plakemi, vdesim dhe ne fund dekompozohemi. Përveç botës fizike dhe biologjike, të përbashkëta me kafshët i kemi edhe disa tipare psikologjike. Sikurse ne, edhe ato kanë ndjenja ose emocione. Edhe kafshët mund të ndihen të frikësuara, të shqetësuara, të uritura, të etura, të lodhura, të humbura e të vetnuara.

Të gjitha qeniet e gjalla janë njësoj të rëndësishme për ekosistemin, pjesë e të cilit jemi edhe ne, prandaj meritojnë trajtim dhe kujdes të mirë.



Por, a ndodh kështu gjithmonë?

Për fat të keq, njerëzit nuk janë treguar gjithmonë të kujdesshëm ndaj kafshëve, madje shpeshherë u kanë bërë edhe dëme të mëdha. Njerëzit, për interesa të vet ekonomike, ndodh që i shkatërrojnë habitatet ku jetojnë kafshët: i presin pyjet, i thajnë kënetat, devijojnë rrjedhën e lumenjve, ndotin tokën, ujën e ajrën etj. Nganjëherë disa njerëz, në kundërshtim me ligjin, por me qëllim përfitimi, dalin në gjueti dhe vrasin kafshët, inadje edhe ato që janë në rrezik për t'u zhdukur.

Për arsye që përmendëm, sot ekzistojnë ligjet për mbrojtjen e kafshëve. Vende të ndryshme të botës, përfshirë këtu edhe Republikën e Kosovës, kanë miratuar ligje të ndryshme mbi "Të drejtat e kafshëve". Po ashtu, në botë sot veprojnë edhe mijëra organizata kundër keqtrajtimit, shfrytëzimit, vrasjes apo dëmtimit të kafshëve, ku pjesë e tyre janë edhe personalitete të rëndësishme botërore.



PYETJE:

1. Analizo disa prej veprimeve të përditshme të njerëzve ndaj kafshëve.
2. Identifiko disa mënyra se si janë shfrytëzuar kafshët dikur.
3. Hulumto për rëndësinë e ligjeve dhe të organizatave që i mbrojnë të drejtat e kafshëve.

64

Ligji për mbrojtjen e kafshëve

Hapësirë jetësore

Kujdesi ndaj kafshëve



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:

Pyetja sjell pyetje

Kërkohet nga nxënësit të lexojnë njësinë e re mësimore dhe gjatë leximit të krijojnë pyetje që lidhen me trajtimin e kafshëve.

- Pse duhet të jemi shumë dashamirës dhe miqësor me kafshët dhe bimët?
- Sa kujdesen njerëzit për kafshët?
- A ekziston Ligji për Mbrojtjen e Kafshëve në Kosovë?

Nxënësit në mënyrë individuale përgjigjen rreth pyetjeve. Nëse kanë diçka të paqartë sqarohet nga mësimdhënësi/ja.



Në tabelë, mësimdhënësi sjell disa fotografi për mbrojtjen e kafshëve duke parandaluar vrasjen, keqtrajtimin, dëmtimin e kafshëve.



Përforcimi:

Konsolidim dhe zbatimi i të nxënit

Shkrim i lirë

Udhëzohen nxënësit të punojnë në fletoren e punës në temën *Trajtimi human i kafshëve*, dhe më pas diskutohet me nxënësit në klasë.

Vlerësimi i nxënëseve:

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrje në aktivitetet dhe angazhim gjatë orës mësimore.

Detyrë:

Të hulumtojnë për rëndësinë e ligjeve dhe të organizatave që i mbrojnë të drejtat e kafshëve.

● *Reflektim për rojedhën e orës mësimore:*

Mësimi 35

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Edukatë qytetare

Shkalla e kurrikulës: 3 **Klasa:** VII

Tema: Mjedisi dhe mirëqenia

Rezultatet e të nxënit të temës:

Bashkëpunon me të tjerët, organizata apo institucione përkatëse për realizimin e aktivitete të ndryshme lidhur me shënimin e festave mjedisore, si: Dita Botërore e Mjedisit, Dita e Tokës, Dita e Ujit, Dita e Biodiversitetit etj

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: V. 5, 6, 8; VI. 1, 2, 4, 7.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 5.1, 5.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Aktivitet për shënimin e festave të mjedisit

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Krijon projekt për aktivitete mjedisore;
- Tregon bashkëpunim për realizimin e aktiviteteve mjedisore.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fletë A4, hamer, flipçart, gazeta, plastikë, ngjyra etj.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjeografi.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënësit

Diskutim dhe analizë


Nxënësit angazhohen në aktivitete të shumta sipas klubeve të ndara në shkollë, në ditët e shënuara sipas kalendarit të festave.

22 Mars - Dita Botërore e Ujit

22 Prill - Dita e Tokës

05 Qershor - Dita Botërore e Mjedisit

22 Maj - Dita Ndërkombëtare e Biodiversitetit





Klubi i mjedisit angazhohet në organizimin e aktiviteteve të ndryshme përmes përdorimit të teknologjisë, fotografive, video-prezantimeve, punime dore me mjete ricikluese dhe pajisjeve të tjera për të zhvilluar sa më mirë aktivitetin.

Nxënësit diskutojnë për idetë e tyre në këtë angazhim.



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:

Puna në grupe

Nxënësit ndahen në grupe për të punuar nga 1-4 për grup. Secilit grup u ndahen përgjegjësitë; aktiviteti organizohet pa tekstin bazë.

Grupi i parë: Hulumto për mbrojtja e ujrave.

Grupi i dytë: Flisni për Ditën Ndërkombëtare të Tokës.

Grupi i tretë: Si ta mbrojmë mjedisin?

Grupi i katërt: Tregoni shkaktarët që rrezikojnë mjedisin jetësor.

Grupi i pestë: Diversiteti

Mësimdhënësi shpërndan te nxënësit materialin shtesë si hamera, fotografi, ngjyra, flipçart, plastikë dhe udhëzues si të punohet gjatë aktivitetit



Përforcimi:

Konsolidim dhe zbatimi i të nxënit

Rrjet diskutimi

Nxënësit prezantojnë punimet e tyre sipas grupeve dhe në fund të prezantimit parashtrohen pyetje nga mësimdhënësi ose nxënësit.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për shkathtësitë në bashkëpunim, prezantim të ideve në grupe.

Detyrë:

Të shkruajë ese me temë *Mjedisi dhe njeriu*.

○ *Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

Mësimi 36

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Edukatë qytetare

Shkalla e kurrikulës: 3 **Klasa:** VII

Tema: Mjedisi dhe mirëqenia

Rezultatet e të nxënit të temës:

Shpjegon rëndësinë dhe demonstroi shkathhtësitë e kursimit të ujit, energjisë, ruajtjes së gjelbërimit, riciklimit të mbeturinave, kultivimit të bimëve, mbrojtjes së kafshëve, në aspektin dhe funksionin e mirëqenies ekonomike, shëndetësore dhe sociale.

Kontributi në rezultatet për kompetencat

kryesore të shkallës: I. 3, 4, 7, 8; IV. 1, 4, 5, 6, 7; V. 3, 4; VI. 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7.

Kontributi në rezultatet e fushës së

kurrikulës: 5.1, 5.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Vlerësim me shkrim – ESE

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fletë A4, fotografi, burime nga interneti.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Gjuhë shqipe, Histori.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënësit

Diskutim dhe analizë

Nxënësit parapërgatiten për këtë qëllim.

I caktoni rregullat e shkrimit të esesë. I shkruani këto rregulla:

1. Të shkruhet jo më shumë se një faqe A4 ose dy faqe të fletores së vogël;
2. Të përdoren paragrafe;
3. Të shkruhet rrjedhshëm dhe pa gabime etj.





Pas vendosjes së kriterëve u jepni kohë të mjaftueshme për përfundimin e esesë.



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:

Puna në grupe

Përveç librit bazë, ju mund t'u sillni nxënësve edhe materiale ndihmëse dhe ata kanë të drejtë t'i përdorin ato.

Meqenëse nxënësit kanë njohuri paraprake lidhur me këtë temë, sepse çështja është diskutuar edhe më parë, duhet pranuar fakti se janë plotësuar kushtet për shkrimin e esesë. Qëllimi është që nxënësit të dijnë ta përdorin materialin duke mos kopjuar, edhe pse kanë afër vetes material të bollshëm. Gjithashtu duhet t'i respektojnë kriteret e shkrimit, të cilat i keni shkruar në tabelë.



Përforcimi:

Konsolidim dhe zbatimi i të nxënit

Në pjesën e fundit të orës, filloni t'i nënshkruani esetë një nga një. I paralajmëroni nxënësit se orën e ardhshme do t'i lexojnë vetë punimet. Në këtë rast do të matet edhe leximi, shkrimi, respektimi i rregullave si dhe përformanca.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësimi bëhet në bazë të kriterëve.

Detyrë:

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:
